

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

NGJARJET E ASHURES

SIPAS SEJID ALI KHAMENEIT

Tiranë, 2025

Titulli: Ngjarjet e Ashures, sipas këndvështrimit të Sejid Ali Khameneit

Autori: Imam Sejid Ali KHAMENEI

Përktheu nga arabishtja: Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

Redaktoi: Jerida KULLA

Korrekttoi: Ma. Isra MERJA

Përgatiti për shtyp & Kopertina: Sabrie FEZA

Botoi: Shoqata “Flladi” - Tiranë, 2025

DY FJALË

Historia islame, që nga fillimi i shpalljes profetike, ka qenë dëshmitare e shumë raundeve të konfliktit. Të parat prej tyre ishin betejat që i zhvilloi i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familje e tij!*) kundër politeistëve dhe hebrenjve, të cilët refuzuan të pranonin fenë e Allahut dhe mesazhin e Tij. Pastaj erdhën betejat që i zhvilloi Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), kundër forcave të shtrembërimit, të udhëhequra nga Muavija, në Sham (Siri), i cili i interpretonte dispozitat islame në një drejtim të kundërt me atë që ishte dashur, duke i shtrembëruar hadithet e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familje e tij!*) dhe rrëfimet islame, në favor të Benu Umejes dhe qendrës së tyre të pushtetit.

Kjo u bë e qartë në betejën e Sifinit, kur u vra Amar ibn Jasiri (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) dhe myslimanët u kujtuan për fjalën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familje e tij!*) drejtuar atij: “Do të të vrasë pala zullumqare”. Banorët e Shamit nxituan të japin një interpretim të çuditshëm për këtë hadith, i cili ishte i njohur dhe i pranuar gjerësisht, duke thënë: “Ai që e vrau, është ai që i nxori në betejë”, duke nënkuptuar kështu Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*).

Një tjetër raund ishte ai që udhëhoqi Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili përballej me një situatë të përkeqësuar dhe të

mjerueshme të umetit islam, që ishte në të vërtetë pasojë e periudhës që i parapriu. Kështu, shpatat që dikur i kishte ngritur i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familje e tij!*) dhe myslimanët e parë kundër mosbesimit dhe politeizmit, tani u drejtuan kundër Ehli Bejt, trashëgimtarëve të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familje e tij!*). Ndërkohë, minberët që duhej të ishin shkolla udhëzimi dhe drejtimi, u shndërruan në tribuna të predikuesve të pushtetit, të cilët shtrembëronin mësimet islame dhe parimet themelore që kishte sjellë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familje e tij!*), si pasojë e sundimit të lakmisë për pushtet dhe shpirtit të nënshtrimit që kishte pushtuar umetin.

Qëndrimet ndaj lëvizjes së Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) kanë qenë të shumta e të ndryshme. Disa ishin kundërshtarë që e dënonin këtë lëvizje, të tronditur nga gjaku që do të derdhej, jetët që do të humbnin dhe përçarja që do ta godiste umetin. Të tjerë qëndronin neutralë, duke pretenduar se kjo ishte një përplasje mes dy palëve që po garonin për pushtet – një vazhdim i konfliktit historik mes fisit Hashimi dhe fisit Emevi. Por ishte edhe një grup të vogël, që u rreshtua përkrah Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) me gjithë qenien e tyre, sepse panë tek ai legjitimitetin dhe detyrimin për t’iu bindur atij.

Ky dallim në qëndrime është një tregues i qartë i gjendjes së rëndë dhe të degraduar që e kishte kapluar umetin në atë kohë. Përndryshe, Hyseni nuk ishte një figurë e paqartë, as një person për të cilin mund të kishte dyshime mbi sjelljen apo cilësitë e tij morale, që të ndaheshin njerëzit në mendime rreth tij, sidomos në

një kohë kaq të afërt me të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familje e tij!*), kur ende ishin të freskëta kujtimet dhe pamjet e mrekullueshme të dashurisë dhe përkujdesjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familje e tij!*) ndaj nipit të tij, Hysenit.

Është e pamundur që Ebu Abdullahu, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), të ndërmernte një hap që binte ndesh me parimet e gjyshit të tij apo që mund të shkatërronte atë që ai kishte ndërtuar. Po aq e pamundur që Jezidi të ishte mbrojtës i të drejtës dhe ruajtës i Islamit dhe parimeve të tij, kur dihet se ai ishte pasardhës i atyre që nuk e kishin pranuar Islamin, veçse pasi shpata e Aliut kishte rënë disa herë mbi kokat e tyre e pa përmendur fare sjelljet e tij që ishin në kundërshtim me shpirtin e fesë.

Pra, kushdo që ndjek rrugëtimin e Islamit, do të vërejë se ndërtimi madhështor që e kishte themeluar Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familje e tij!*), për shkak të kalimit të tij nëpër faza dhe etapa të ndryshme, pësoi një çarje të madhe, që rrezikoi të zhdukte thelbin e tij, të shkatërronte të vërtetat e tij dhe ta shndërronte në një mbështjellës të zbrazët, pa kuptim. Prandaj, detyra e Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte ta ndalte këtë çarje të madhe dhe t'i rikthente themelet e ndërtimit në gjendjen e tyre të mëparshme. Nëse Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familje e tij!*) e ndërtoi Islamin dhe vuri themelet e tij, atëherë Hyseni e rinovoi dhe e ringjalli atë.

Shumë libra dhe studime janë mbushur me analiza të gjera dhe të thelluara për këtë kryengritje dhe udhëheqësin e saj. Pikëpamjet e teoritë për të kanë qenë të larmishme. Megjithatë, ajo që ka mbetur në përmasat e saj, është një mister, që nuk mund të

zbulohet me hamendje dhe një det i stuhishëm, që nuk guxojnë ta përshkojnë as zhytësit më të thellë në detet e dijes.

Ky libër është një përmbledhje fjalimesh, në të cilat udhëheqësi i Revolucionit Islamik, i nderuari, Imami luftëtar, Sejid Ali Khamenei, trajton çështjen e Ashures nga një këndvështrim i rëndësishëm, mësimet dhe mesazhet që nxirren nga kjo ngjarje.

Në të vërtetë, ai (*Allahu e ruajttë!*) ka synuar të godasë në thelbin e të vërtetës dhe në zemrën e çështjes, si dhe të paralajmërojë kundër rënies në të njëjtat sëmundje që goditën shoqërinë islame, pas Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familje e tij!*). Ai e thotë me zë të lartë: “Përderisa ekzistojnë e drejta dhe e padrejta, në çdo kohë dhe epokë, atëherë ekziston Hyseni dhe Jezidi. Është detyrë e umetit të tregojë zgjuarsin dhe mençurinë për të zgjedhur qëndrimin e duhur”.

Ashurja vazhdon ende të mbajë brenda vetes shumë nga ato që Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) donte t’ia thoshte njerëzimit dhe qëllimet madhore të revolucionit të tij. Thirrja e tij: “Për Allahun, nuk do t’jua dorëzoj dorën time si i nënshtruar e as nuk do t’ju nënshtrohem si skllav”, vazhdon të jehojë në qiellin e myslimanëve, madje të të gjithë njerëzimit, për t’i udhëhequr drejt dinjitetit dhe krenarisë.

Maxhid el Khakanij (përkthyesi i librit nga persishtja në arabisht)

13 Jumada El Ulà, 1420

Parathënie

Çdo ditë është Ashure dhe çdo tokë është Qerbala

Kryengritja hyseniane nuk ishte një ngjarje kalimtare, që kufizohet me një çast në kohë apo në një vend në hapësirë, as një lëvizje si të tjerat me ndikime dhe rezultate të ngushta materiale. Përkundrazi, ajo është një kulturë hyjnore dhe një histori me shumë kapituj e përbërës, që ka dhënë fryte dhe rezultate të tilla, saqë është bërë e pamundur të mohohet përgjatë shekujve dhe në të gjitha anët e botës.

Sundimtarët tiranë, që u ulën padrejtësisht në fronet e pushtetit dhe morën në dorë fatet e popujve në vendet islame, kanë bërë përpjekje për të shuar shkëlqimin e këtij kandili ose për ta kufizuar atë, me qëllim që të ruajnë regjimet e tyre jolegjitime, larg ndikimeve të kryengritjes së Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Që nga koha kur Perëndimi agresor vuri këmbët në tokat islame, veçanërisht në qendrën e Shi'izmit, në Iran dhe pas studimeve të shumta që zhvilloi, ai arriti të zbulojë rrënjët nga të cilat nisi ngjarja e Ashures dhe ndikimet që ajo ka tek umeti, si dhe dashurinë dhe lidhjen e thellë që ky umet ndjen për Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), si emër dhe si kujtim. Kështu, ai bëri përpjekje të mëdha për ta shtrembëruar këtë ngjarje ose për ta ulur rëndësinë e saj.

Çdo tiran, sundimtar arrogant apo pushtues nuk duron dot që emri dhe kujtimi i një ngjarjeje si Ashurja të vlojë dhe të ndizet në mesin e popujve, duke sjellë me vete një gjendje zgjimi, refuzimi ndaj armiqve, vetëdije fetare, dashuri për udhëheqjen hyjnore, si dhe guxim, sakrificë e altruizëm. Në një atmosferë të tillë lulëzojnë mijëra pishtarë udhëzimi dhe drite.

Përballë tyre qëndrojnë Imamët e udhëzimit, reformatorët, dijetarët e mëdhenj dhe thirrësit e Islamit, që përpiqen për lumturinë e njeriut. Ata kanë bërë përpjekje të mëdha për ta ruajtur këtë kryengritje dhe për ta mbajtur të gjallë kujtimin e saj. Vlerat, dritat, përsosmëritë dhe nderet që i kanë mbetur njerëzimit dhe i kanë dhënë historisë së tij të errët një kuptim dhe e kanë bërë të denjë për vazhdimësi, janë ndër begatitë e ngjarjes së Ashures dhe aromave të tokës së Qerbelasë.

Në kohën tonë, Reza Khani (mbreti i parë i dinastisë Pahlavi në Iran) mori përsipër ta zhdukte mbajtjen e ceremonive të zisë për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), Pishtarin e dëshmorëve. Fillimisht, ai përpiqej ta mashtronte popullin, duke organizuar procesione zie brenda kazermave ushtarake dhe duke

nxjerrë ushtarët në rrugë të veshur si pjesëmarrës në këto ceremoni, për të nxitur përkushtim ndaj Islamit dhe Ehli Bejtit.

Por, sapo e forcoi pushtetin, filloi të realizojë qëllimin e tij kryesor: ndaloj mbajtjen e këtyre ceremonive dhe nuk u mjaftua me kaq. Ai nisi një sulm të ashpër, edhe kundër qendrave të studimeve fetare dhe dijetarëve, sepse i shihte si bartës të flamurit të Ashures dhe ndjekës së rrugës së saj. Studentët e fesë detyroheshin të shkonin në shkretëtirë për të studiuar larg syve të spiunëve të Reza Khanit dhe ktheheshin në shtëpitë e tyre në mbrëmje.

Imami i ndjerë, Ajatullah Khomeini (*Allahu e mëshiroftë!*), i cili në atë kohë ishte i angazhuar në studimet e tij në hauza¹, ka rrëfyer kujtime të hidhura për shtypjet e Reza Khanit. Për të dhënë një përshkrim të saktë të historisë bashkëkohore të Iranit dhe rolit që luajtën të huajt në hartimin e saj, ai ka zbuluar aspekte të errëta nga tirania e Reza Khanit.

Plani dhe misioni që kishte ndërmarrë Reza Khani, vazhdoi edhe gjatë sundimit të djalit të tij, Mohamad Reza Pahlavi, i cili përdori mashtrimin dhe gënjeshtren, duke u mbështetur në mjetet e fuqishme të propagandës që kishte nën kontrollin e tij.

Ndërkohë, populli iranian, përmes ndjekjes së dijetarëve të vetëdijshëm, dëshmoi përkushtimin e tij ndaj trashëgimisë së çmuar, në veçanti përmes mbajtjes së ceremonive të zisë për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), Pishtarin e dëshmorëve. Imam Khomeini (*Allahu e mëshiroftë!*), duke përfituar nga rrezatimi

¹ Huaza janë shkolla fetare Shiite.

edukativ, entuziast dhe politik i ngjarjes së Qerbalasë dhe epopesë së Hysenit, e nxiti shpirtin e guximit në mesin e popullit, veçanërisht te të rinjtë dhe ia doli të vendoste themelet e kryengritjes më të madhe të shekujve të fundit: përmbysjen e sistemit tiranik Pahlavi, pavarësisht nga mbështetja ndërkombëtare që gëzonte ai dhe themelimin e një sistemi fetar, të bazuar në mësimet e ndritshme islame.

Imami Khomeini (*Allahu e mëshiroftë!*) ia doli të udhëheqë Revolucionin Islamik në Iran dhe ta ndërtojë këtë ndërtesë madhështore, duke u mbështetur fuqimisht në mësimet dhe mesazhin e Ashures, duke tronditur kështu themelet e arrogancës botërore.

Të rinjtë kanë trashëguar mësimet dhe thirrjet e Ashures përmes procesioneve të zisë dhe ceremonive për Pishtarin e dëshmorëve, Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), të organizuara nga ligjëruesit dhe këngëtarët fetarë, të cilët forconin dashurinë e tyre për Ehli Bejtin dhe i bënë më të vetëdijshëm ndaj padrejtësive të tiranëve të kohës, duke ndezur tek ta shpirtin e flijimit dhe të altruizmit.

Rëndësinë e këtyre ceremonive e dëshmojnë porositë dhe udhëzimet e udhëheqësit të Revolucionit Islamik, e Imam Khomeinit të ndjerë, të cilat theksojnë domosdoshmërinë e mbajtjes së tyre në mënyrën tradicionale dhe larg praktikave që mund të shtrembërojnë imazhin e Islamit, siç është vetëdëmtimi (tatbir- goditje e vetes me shpatë apo me zinxhirë apo gjëra të tjera).

Rikujtimi i Ashures dhe sakrificave të atij grushti të vogël heronjsh në Qerbala përfaqëson ringjalljen e Islamit të Muhamedit, pasi kryengritja e Imam Hysenit e mbrojti dhe e ringjalli Islamin. Për këtë arsye, përkujtimi i Ashures do të ketë të njëjtin ndikim.

Me forcimin e ofensivës kulturore që ndërmorën armiqtë e Islamit, udhëheqësi i Revolucionit Islamik bëri një studim, me titull **“Mësimet e Ashures”**. Krahës analizës së tij të saktë për ngjarjen e Ashures, e cila ka një ndikim të jashtëzakonshëm në nxitjen për ndërtimin e vetes dhe të shoqërisë, ai paraqiti një qasje të re për këtë ngjarje, që përfaqëson një shembull të vërtetë të konceptit që përmban parulla *“Çdo ditë është Ashure dhe çdo tokë është Qerbela”*.

Ai analizoi dhe studioi faktorët që çuan në këtë fatkeqësi të dhimbshme që i ndodhi umetit islam, duke e titulluar këtë analizë, si: *“Mësimet e Ashures”*.

Sot, kur përgjegjësia e udhëheqjes i është besuar qeverisë islame në Iran, e cila ka marrë përsipër udhëheqjen e umetit, veçanërisht të brezit të ri dhe ndërtimin e qytetërimit të ri islam, e gjithë kjo është frymëzuar nga mësimet e përfituara nga epopeja e Qerbalasë dhe qëndrueshmëria e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Prandaj, ajo që duhet të merret seriozisht në konsideratë, janë mësimet e Ashures, të cilave rrallëherë u është kushtuar kujdes gjatë epokave të sundimit të tiranëve. Marrja e mësimëve të drejta dhe të plota nga Ashurja, është ajo që mund ta ruajë

sistemin islam nga fatkeqësi të ngjashme dhe të parandalojë përsëritjen e një ngjarjeje si ajo e Qerbelasë.

Duke u rikthyer në fjalimet dhe mësimet e udhëheqësit të myslimanëve (Udhëheqësit Suprem), mund të përftojmë këto vërejtje të rëndësishme, në lidhje me mësimet e Ashures:

Roli i elitës (të veçantëve) në përcaktimin e fatit të shoqërisë islame dhe në ndodhjen e tragjedisë së Ashures dhe ngjarjeve të tjera të ngjashme.

Roli i vlerave të larta islame dhe përkushtimi i vetëdijshëm dhe i fortë ndaj tyre në përparimin dhe përsosjen e shoqërisë; përkundrazi, ndikimi negativ i shpërfilljes së vlerave dhe dobësisë në përkushtim në rrënimin e shoqërisë dhe përfundimin në një tragjedi, si ajo e Qerbalasë.

Faktorët dhe shkaqet që çuan në dobësimin e besimit dhe përhapjen e korrupsionit dhe vesit në shoqëri.

Dashuria për botën (materializmi) dhe ndikimi i saj në devijimin e elitës, që ishin mbështetës të së vërtetës.

Njerëzit e thjeshtë (masa) dhe mungesa e kuptimit të duhur të kohës dhe vendit, si dhe ndjekja e tyre e pavetëdijshme e elitës.

Më pas, ai (Udhëheqësi Suprem) përshkruan shoqërinë që ndërtoi i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), mbështetur mbi katër shtylla themelore:

1- Njohuri e pastër dhe e qartë, pa mjegullim;

- 2- Drejtësi absolute;
- 3- Adhurim i singertë, i liruar nga idhujtaria;
- 4- Dashuri dhe ndjenja të fuqishme.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e theksoi domosdoshmërinë për vazhdimin e këtij ndërtimi përmes caktimit të Imamit Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), si udhëheqës pas tij. Por kjo nuk u realizua, për shkak të komplotit të Sakifes.

Duke sqaruar pozitën që kishte Hyseni në kohën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe gjatë pesëdhjetë viteve pas ndarjes së tij nga jeta, ai thekson tronditjen dhe rëndësinë e madhe të tragjedisë së Qerbelasë, në mënyrë që të qartësohet edhe më shumë domosdoshmëria e reflektimit dhe analizës së thellë të shkaqeve që çuan në këtë fatkeqësi dhe që ajo të kuptohet drejt.

Udhëheqësi i nderuar, Ajatollah Khamenei, në studimin e tij të ri ka bërë referenca për disa sahabë dhe persona të dalluar (elita) që, megjithëse fillimisht qëndruan në anën e të vërtetës, me kalimin e kohës, u bënë robër të dashurisë për këtë botë dhe u larguan nga rruga e drejtë, madje u vunë kundër saj. Ai jep disa paralajmërime në lidhje me elitën, ndër të cilat janë:

1- Sprova e elitës me botën materiale dhe ndjekja e zbukurimeve të saj, si: pasuria, fama, dëshirat, pozita dhe pushteti ka filluar që nga koha, kur disa sahabë që morën pjesë në fushat e xhihadit, filluan të përfitojnë privilegje, pas devijimit që ndodhi në kalifatin islam.

Ajo që ka rëndësi të madhe, në këtë kontekst, është njohja e natyrës së kësaj bote dhe mënyra e të jetuarit në të, pa u ngjitur dhe pa qenë i varur pas saj, në mënyrë që të shmanget përfundimi i njëjtë me ata të dalluar që rrëshqitën nga rruga. Gjithashtu, duhet të kemi aftësinë për t'u shkëputur nga pasionet dhe lidhjet tokësore, dhe të jemi të gatshëm të mbështesim të vërtetën në kohën e duhur.

2- Domosdoshmëria që elita të marrë vendime të drejta dhe të veprojë në mënyrën e duhur, për ruajtjen e vlerave fetare dhe sistemit hyjnor në shoqëri. Ka prej atyre drejtues që duhej të ishin të pranishëm në fushë, por munguan, për shkak të disa analizave të gabuara. Kur e kuptuan gabimin e tyre, iu bashkuan lëvizjes, por, me gjithë sakrificat që bënë, ato **nuk patën ndikimin e dëshiruar për përmirësimin e shoqërisë** dhe përjetësimin e lëvizjes së tyre.

Përmes përmendjes së disa lëvizjeve të dështuara, udhëheqësi tërheq vëmendjen e elitës ndaj rëndësisë së madhe të përgjegjësisë që mbajnë.

3- Ruajtja e shpirtit parimor, parullave dhe qëndrimeve të bazuara në besim, si dhe vazhdimi i zellit të lartë dhe ndjenjës fetare, është thelbësore. Çdo indiferencë apo dobësi në këtë drejtim, do të sjellë pasoja të rënda për shoqërinë islame.

Prandaj, elita, të dalluarit, duhet ta kuptojnë se masa e popullit i ndjek ata, për shkak të veçorive që kanë. Pa dyshim, sjellja, veprimet, fjalët, ndjenjat dhe qëndrimet e elitës janë ato që i drejtojnë masat. Prandaj, dobësimi i vlerave, manipulimi me to dhe largimi nga parimet, është pasojë e veprimeve të elitës. Nuk

ka dyshim se veprimet e popullit i japin elitës një përgjegjësi të madhe.

Krahas trajtimit të *mësimeve të Ashures* dhe theksimit të çështjes së elitës dhe ndikimit të tyre në përcaktimin e fatit të shoqërisë dhe përgatitjen për ndodhinë e Ashures, udhëheqësi shqyrton edhe dy tema të rëndësishme dhe të ndërlidhura: e para, është çështja e iluministëve dhe historia e tyre; e dyta, është liria dhe shtypi, të cilat po kurdiseshin nga armiqtë.

Ndoshta, duke vënë këto tema krah njëra-tjetrës, mund të themi se iluministët, të cilët ende jetojnë në atmosferën para fitores së Revolucionit Islamik dhe ëndërrojnë kthimin tek gabimet e të kaluarës, po përpiqen, përmes mbështetjes në lirinë e shtypit, të tronditin besimin e popullit ndaj parimeve, vlerave islame dhe sistemit islamik, bazuar në udhëheqje.

Në këtë situatë, elitës së revolucionit i takon të dallojë mikun nga armiku, si dhe armët që përdorin armiqtë, dhe më pas të ndërmarrë veprimet e duhura, për të parandaluar dobësimin e ndjenjave të popullit, zbehjen e vlerave dhe lëkundjen e besimit të brezit të ri, si pasojë e përhapjes së korrupsionit, devijimit dhe të këqijave.

Interesimi i tepërt për dynjanë, materializmin, pozitën dhe pushtetin, konfliktet dhe përplasjet ndërmjet grupeve të ndryshme, ndikimi nga intrigat politike dhe lëvdata ndaj të huajve për qëndrimet e tyre pozitive ndaj sistemit islam, të gjitha këto ia bëjnë të pamundur elitës njohjen e mashtrimeve dhe oportunitizmin e armikut. Në këtë gjendje, e mira humbet shkëlqimin e saj, ndërsa të këqijat marrin rrënjë; mëkatet, veset

dhe dyshimet fillojnë të ndikojnë fuqishëm në dobësimin e besimit të masave. Në atë moment, përsëritja e tragjedisë së Ashures bëhet një çështje e pashmangshme dhe viktimat e parë është vetë elita.

Iluministët, gjatë gjithë historisë së tyre, deri në fitoren e Revolucionit Islamik, kanë dëshmuar dështimin e tyre, për të marrë përgjegjësinë e udhëheqjes së umetit, në të gjitha fushat: politike, kulturore, sociale dhe në çështjet e tjera të vendit. Ata shpesh kanë rënë pre e mashtrimeve të të huajve dhe kanë shkatërruar interesat jetike të kombit, duke nënshkruar marrëveshje të dëmshme. Edhe më keq, ata e kthyen fenë dhe kulturën e këtij kombi në një fushë të hapur për dyshimet dhe idetë shkatërruese perëndimore.

Edhe pse revolucioni arriti të sjellë një ndryshim të madh në këtë drejtim dhe i zëvendësoi ata me intelektualë të devotshëm, armiku po përpiket, me gjithë forcën, që t'i rikthejë ata në pozitën e mëparshme, bashkë me sëmundjet e tyre të vjetra, duke përdorur qindra metoda dhe mashtrime.

Shkëputja nga masa, braktisja e fesë, kundërshtimi i mësimave hyjnore, shërbimi ndaj të huajve dhe nënshtrimi ndaj tyre, janë shenjat e një sëmundjeje kronike, për të cilën Revolucioni Islamik përpiket të gjejë një kurë të suksesshme. Sot, në universitete vërehet një lëvizje e furishme drejt gjithçkaje të Perëndimit; në shoqëri dhe në media ndihen përpjekjet e simboleve të Perëndimit dhe "patriotëve" të trembur, madje edhe të tradhtarëve, për ta rindërtuar situatën sipas ideve të tyre.

Çfarë do të ndodhte, nëse umeti do ta merrte historinë, dijen dhe interesat e tij nga ajo që thonë këta njerëz? Çfarë dyshimesh dhe pasigurish do të mbillte shtypi i shitur në thelbin e besimeve të umetit, veçanërisht te të rinjtë dhe studentët dhe në besimin e tyre tek themelet e sistemit islamik, kur ai paraqet individët e dalluar për shërbimin ndaj armiqve të umetit, si të ishin intelektualë dhe të lirë? Çfarë pasojash do të sjellë kjo?

Ekziston një komplot i qartë, që synon shkatërrimin e besimit të umetit, veçanërisht të gjeneratës së re, e cila është burim i vrullit, i emocioneve të zjarra, i pjesëmarrjes politike, i flijimit, i xhihadit, i pastërtisë, i devotshmërisë, i besnikërisë dhe themel i pavarësisë.

Në këtë kontekst, udhëheqësi i revolucionit i drejtohet me një paralajmërim të ndjeshëm ndërgjegjes së gjalla të tri shtresave të shoqërisë:

- 1- Elitës (të veçantëve), duke theksuar nevojën që ata të luajnë rolin e tyre vendimtar përballë këtij komploti.
- 2- Rinisë dhe studentëve, të cilëve u tërheq vëmendjen, që të jenë të kujdesshëm ndaj kësaj sëmundjeje të rrezikshme, që është Perëndimi, shërbimi ndaj të huajve dhe tërheqja nga rruga e drejtë e umetit.
- 3- Zyrtarëve, duke i paralajmëruar ndaj botimeve dhe medieve që drejtohen nga duar të ndyra, me të kaluar të errët politike dhe ideologjike, që veprojnë në emër të një lirie, sipas modelit perëndimor, një liri që bazohet në kolonializëm, shtazëri dhe është burim i prishjes, mëkateve dhe shthurjes morale.

Koka e sulmit në agresionin kulturor, që synon besimin e masave, veçanërisht të rinisë, janë “të ndriturit” mercenarë dhe të sëmurët shpirtërisht, të cilët zbatojnë urdhrat e arrogancës perëndimore, duke përfituar nga mjetet arsimore në dispozicion, klima mbizotëruese në universitete, shtypin dhe mjetet e komunikimit masiv. Ata kapen pas parullës së lirisë, për të realizuar qëllimet e tyre të mbrapshta.

Të gjitha shtresat e shoqërisë dhe veçanërisht përgjegjësit, janë të drejtuar nga këto paralajmërime të mençura, të lëshuara nga udhëheqësi i Revolucionit Islamik. Të gjithë janë të ngarkuar me përmbushjen e përgjegjësiave që u janë besuar. Çdo indiferencë në këtë drejtim, do të sjellë pendim dhe tallje nga armiqtë. Nëse do të përsëritej ngjarja e Qerbalasë, në një “Qerbala të Iranit”, ata do të ndiqeshin nga mallkimi i brezave dhe do t’i përfshinte dënimi i dhimbshëm hyjnor.

Duke qenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë dhe në vazhdim të përpjekjeve tona për të përgatitur dhe për të redaktuar libra që trajtojnë rolin e elitës dhe periudhat e ndjeshme historike, si dhe mësimet e përfituara nga Ashurja, në bashkëpunim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun, pranë Zyrës së Udhëheqësit të Revolucionit Islamik, kemi ndërmarrë mbledhjen dhe organizimin e fjalimeve të tij në këtë temë, të ndara në tre kapituj:

1- Natyra e ngjarjes së Qerbalasë dhe motivet e Imam Hysenit për kryengritje

2- Mësimet e Ashures dhe mesazhi i saj

3- Mësimet e nxjerra nga Ashurja

Shpresojmë që ky libër të jetë hapi i parë drejt arritjes së vizionit dhe ndërgjegjësimit të domosdoshëm për përballimin e komplotit, me ndihmën e Allahut të Lartësuar.

Nuk na mbetet veçse të shprehim mirënjohjen e thellë ndaj Zyrës për Marrëdhënie me Publikun, pranë Zyrës së Udhëheqësit të Revolucionit Islamik, për ndihmën e tyre në redaktimin, shqyrtimin dhe korrigjimin e këtij libri.

Instituti Kulturor “Kadrul Uilajeh”

KAPITULLI I PARË

PERSONALITETI I IMAM HYSENIT DHE

NGJARJA E ASHURES

Imam Hyseni, magnet i zemrave²

Imam Hyseni, emri dhe ndikimi

Të dashurit e mi! Emri i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) është një emër i çuditshëm. Nëse e shohim nga një kënd emocional, do të vërejmë se ai emër ka një tërheqje magnetike të veçantë mes myslimanëve. Është e vërtetë që midis myslimanëve ka edhe nga ata që nuk e përjetojnë këtë ndjenjë, por, në realitet, ata janë të privuar nga njohja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Edhe pse ka njerëz që nuk janë nga ithtarët e kësaj shtëpie (Ehli Bejtit), megjithatë shumë prej tyre derdhin lot dhe u rreh zemra nga mallëngjimi, kur përmendet emri i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Allahu i Madhërishëm ka vendosur në emrin e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) një ndikim të veçantë, i cili ngjall një gjendje shpirtërore në zemrat dhe shpirtin e popullit iranian dhe të kombeve të tjera, sa herë që përmendet ai. Ky është manifestimi emocional i atij personaliteti të shenjtë.

Një vend të tillë ai kishte edhe te njerëzit e mençur, nga sahabët (shokët e Profetit), në shtëpinë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si dhe në shtëpinë e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Siç mund të kuptohet

² Takimi i udhëheqësit të Revolucionit Islamik, me komandantët dhe pjesëtarët e Gardës së Revolucionit Islamik dhe Forcave të Sigurisë së Brendshme, me rastin e Ditës së Gardës së Revolucionit, më 3 Shaban 1416 hixhri.

nga transmetimet dhe ngjarjet historike, kjo ekzistencë e nderuar kishte një veçanti të posaçme, ishte i dashur dhe i respektuar. Kështu ka mbetur deri në ditët tona.

Gjendja e tij ishte, gjithashtu, e tillë edhe nga ana shkencore. Ndër njohuritë më të larta dhe temat më të thella të irfanit (mistikës islame) janë ato që gjenden në fjalët e këtij personaliteti të madh, veçanërisht në lutjen e tij, në Ditën e Arafatit. Nëse i hedhim një vështrim të kujdesshëm, do ta shohim atë të ngjashme si me “Zeburin e Ehli Bejtit”, të mbushur me himne të ëmbla, plot dashuri dhe ndjenja të thella shpirtërore.

Nëse dikush thellohet në disa prej lutjeve të transmetuara nga Imami Sexhadi (Zejnul Abedini) dhe i krahason ato me këtë lutje (e Imam Hysenit në Arafat), do të vërejë se lutja e djalit nuk është gjë tjetër veçse një shpjegim i lutjes së babait, pra, ky është burimi dhe ajo tjetra është degëzimi i saj.

Lutja e Ditës së Arafatit dhe fjalët e këtij të madhërishmi në Ditën e Ashures e më tej, mbartin kuptime dhe frymë të mrekullueshme. Ato përfaqësojnë një det të pafund të njohurive të larta, të ndjeshme dhe të realiteteve shpirtërore hyjnore, për të cilat vështirë se gjejmë të ngjashme përveçse në trashëgiminë e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Imam Hyseni, shembull për të gjithë njerëzit³

Imitimi i të mëdhenjve dhe lidhja me të afërmit e Zotit është vepër e të mençurve të botës. Çdo njeri kërkon një model për t'u ndjekur, por jo të gjithë janë të suksesshëm në ndjekjen e rrugës së drejtë, kur zgjedhin shembullin e tyre.

Po të pyesësh disa njerëz në këtë botë, për personalitetin që ka tërhequr vëmendjen e tyre dhe i ka tërhequr pas vetes, do t'i gjesh duke ndjekur individë të ulët dhe të pavlerë, që e kanë kaluar jetën në adhurimin e epshit dhe nuk dinë tjetër veçse të mashtrojnë të paditurit me gjëra që nuk janë më shumë se zbavitje për naivët dhe të pakujdesshmit. Kështu, personazhe të tilla bëhen modele për njerëzit e zakonshëm të kësaj bote.

Disa ndjekin figura politike ose historike dhe i marrin ata për shembull në jetë. Por, më të mençurit janë ata që marrin për model të dashurit e Zotit, sepse një nga cilësitë më të dukshme të tyre, është se ata janë aq trima, të fortë dhe të fuqishëm, sa janë bërë zotë të vetvetes, jo skllevër të përulur të saj.

Përmendet se një nga filozofët dhe të urtët e lashtë i tha Aleksandrit të Madh: "Ti je skllav i skllavit tim". Aleksandri u habit dhe u zemërua nga kjo fjalë. Filozofi i tha: "Mos u zemëro. Ti je skllav i epshit dhe i zemërimit tënd. Kur dëshiron diçka ose kur zemërohesh, tronditesh dhe nuk duron dot. Kjo është

³ Ky tekst është marrë nga një fjalim i Liderit Suprem të Revolucionit Islamik, gjatë një takimi me anëtarët e Gardës së Revolucionit Islamik, me rastin e Ditës së Gardës së Revolucionit më 24.9.1375 hixhri (dhjetor 1996).

skllavëri ndaj epshit dhe zemërimit. Ndërsa unë i kam nënshtuar ato, saqë janë bërë dy skllavër të mi”.

Kjo histori edhe mund të jetë e vërtetë, edhe s’mund të jetë, megjithatë, ajo është e saktë në kuptimin që u përket të dashurve të Zotit (euliya’ullah) dhe profetëve, si dhe udhërrëfyesve të udhës hyjnore për njerëzimin. Një shembull për këtë, janë: Jusufi, Ibrahim i dhe Musai. Ka shumë shembuj të tillë, edhe në jetën e të dashurve të Zotit.

Njeriu më i mençur është ai që merr për shembull këta të mëdhenj dhe këto personalitete të guximshme dhe të fuqishme, dhe nëpërmjet kësaj rruge fiton për veten e tij fuqinë, madhësinë e brendshme dhe shpirtërore.

Ndër këta të dashur të Zotit, ekzistojnë figura të dalluara. Pa dyshim që Ebu Abdillahu, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është një nga më të spikaturit prej tyre. Me të vërtetë, duhet thënë se drita e Hysenit, i biri i Aliut, shkëlqen si dielli, jo vetëm mbi ne, njerëzit e vegjël tokësorë, por edhe mbi të gjitha botët e ekzistencës, mbi shpirtrat e të dashurve të Zotit dhe të mëdhenjve, mbi engjëjt e afërt dhe mbi të gjitha botët e ndërthurura mes tyre, qofshin ato të njohura apo të panjohura për ne. Kushdo që ecën në udhëzimin e dritës së këtij dielli, ka bërë vërtet një vepër të madhe e të lartë.

E shihni se Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), megjithëse ishte nipi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), i biri i Ali ibn ebu Talibit dhe Fatime Zehrasë, dhe këto janë veçanti të mëdha, në vetvete, që e ngrenë shumë njeriun. Përveç kësaj, ai ishte rritur në atë shtëpi, ishte edukuar në

prehrin e tyre dhe ishte formuar në atë atmosferë shpirtërore dhe lumturie hyjnore. Por ai nuk u mjaftua me kaq.

Kur ndërroi jetë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), Hyseni ishte djalos, rreth tetë ose nëntë vjeç. Kur u martirizua Imam Aliu, Hyseni (*Paqja qoftë mbi ta!*) ishte tridhjetë e shtatë ose tridhjetë e tetë vjeç. Gjatë kohës së Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), kohë sprovash, përpjekjesh dhe pune të palodhur, ky thesar, i gatshëm për t'u edukuar, mori mësim përmes veprave madhështore, u formua vazhdimisht nga babai i tij, derisa u bë një personalitet i fuqishëm, i ndriçuar dhe i lulëzuar.

Nëse ambicia e njeriut është si e jona, ai thotë: "Kaq më mjafton. Kjo është e gjitha që dua dhe me këtë do ta takoj Zotin tim". Por kjo nuk është ambicia e Hysenit.

Gjatë jetës së vëllait të tij të bekuar, kur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte në pozitën e pasuesit (memum) dhe vëllai i tij, Hasani, ishte imam, ai vazhdoi lëvizjen e tij madhështore, duke ecur përpara dhe duke përmbushur detyrimet e tij përkrah vëllait, në bindje të plotë ndaj Imamet të kohës së tij. Shikoni jetën e tij, çast pas çasti.

Përballja me shtrembërimin

Pastaj ai përjetoi martirizimin e vëllait të tij. Jeta e tij e bekuar vazhdoi, edhe pas këtij ngjarjeje për dhjetë vjet. Kaluan më shumë se dhjetë vjet nga dëshmimi i Imam Hasanit (*Paqja qoftë mbi të!*), deri në momentin e dëshmimit të tij. Vëzhgoni çfarë bënte Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) gjatë këtyre dhjetë viteve, që i paraprinë ngjarjes së Qerbelasë.

Adhurimi, lutjet, kërkitimi i ndihmës hyjnore, qëndrimi në vetmi në varrin e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familje e tij!*), , ushtrimet shpirtërore dhe hyjnore ishin një aspekt i jetës së tij. Ndërsa aspekti tjetër ishte përpjekja e tij e vazhdueshme për përhapjen e dijes dhe njohurisë dhe përballja me shtrembërimin.

Në atë kohë, shtrembërimi ishte sfida më e madhe shpirtërore që kërcënonte Islamin. Ai përhapej si një përmytje rrënuese e korrupsionit dhe si ujë i ndenjur që zinte vend në mendjet e njerëzve të shoqërisë islame. Ishte një epokë, kur në territoret, vendet dhe kombet islame, theksohej mallkimi ndaj personalitetit më të madh të historisë islame dhe përndiqeshin ata që shfaqnin dashuri ndaj Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe besonin në udhëheqjen e tij. Në atë kohë kishte “vrasje për dyshim dhe ndalim për shkak të akuzës”.

Në rrethana të tilla, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) qëndroi si një mal i palëkundur dhe e grisi perden e shtrembërimit. Historitë që kanë mbetur nga ai dhe fjalët që u

drejtonte dijetarëve, dëshmojnë për veprën e madhe që ai bënte në këtë fushë.

Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja

Çështja përmbante edhe një aspekt tjetër: ndalimin nga e keqja dhe urdhërimi për të mirë, në formën më të lartë të tij, gjë që është përmendur në letrën e tij, drejtuar Muavijes. Kjo letër, sa mbaj mend, është transmetuar nga historianë të Ehli Sunetit dhe nuk besoj se është transmetuar nga shi'itët, domethënë nuk e kam hasur në burime shi'ite. Nëse është përmendur nga ata, atëherë e kanë marrë nga burime të tyre (sunite).

Ky stil letrar dhe praktika e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja vazhdoi deri në daljen e tij nga Medina, gjatë qeverisjes së Jezidit. Edhe kjo hyn në kuadrin e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja, kur ai tha: *“Unë nuk kam dalë tjetër përveçse për të urdhëruar për të mirë dhe për të ndaluar nga e keqja”*.

E shihni këtë njeri që ndërmerr lëvizje madhështore në fushën e edukimit dhe të disiplinimit të vetvetes. Në aspektin kulturor, ai iu përkushtua luftimit të shtrembërimit, përhapjes së dispozitave hyjnore dhe edukimit të nxënësve dhe figurave të mëdha. Ndërsa në aspektin politik, ai e praktikonte urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja.

Pastaj erdhi edhe lufta e tij madhështore, e cila ka lidhje me rolin e tij, në aspektin politik. Pra, ai ishte i angazhuar me edukimin dhe ngritjen e vetes në të tri këto drejtime.

Të dashur, ai është shembull dhe udhërrëfyes. E gjitha kjo ka të bëjë me periudhën para ngjarjes së Qerbelasë. Nuk duhet të ndalemi për asnjë çast; duhet të ecim përpara vazhdimisht, sepse armiku është në pritje të një çarjeje, që të futet. Ai pret nga ju ndonjë ngecje, që të sulmojë. Mënyra më e mirë për të parandaluar sulmin e armikut dhe për të asgjësuar përgatitjet e tij, është që ta sulmoni ju atë. Ecja juaj përpara është e lidhur me sulmin ndaj armikut.

Sulmi ndaj armikut është ndër veprat më të mëdha

Disa mendojnë se sulmi ndaj armikut do të thotë patjetër të marrësh pushkën dhe topin dhe të shkosh në ndonjë vend, ose të bësh thirrje politike. Po, kjo është e domosdoshme në disa rrethana, duhet që njeriu të bërtasë politikisht, por disa nuk duhet të mendojnë se, kur përmendim çështjen e kulturës, ne nënkuptojmë vetëm një thirrje politike kundër armikut.

Sigurisht që kjo është e nevojshme në vendin dhe kohën e vet, por nuk duhet të ndalemi vetëm në këtë. Një nga veprat më të mëdha, është ndërtimi i njeriut, për veten e tij, për fëmijët e tij, për ata që janë nën përgjegjësinë e tij dhe për kombin islam.

Armiku gjithmonë përpiqet ta dobësojë këtë digë të fuqishme, ta lëkundë apo ta bëjë të depërtueshme.

Armiku, me tërë madhështinë e tij të jashtme boshe, që është imperializmi perëndimor me kulturën e tij të degjeneruar, arrogante dhe sunduese, i cili është shfaqur dhe ka mbizotëruar të

gjitha kanalet e botës, ka sunduar mbi pasuritë ekonomike, kulturore, njerëzore dhe politike për shekuj me radhë, sot përballët me një sfidë të madhe nga Islami i vërtetë, jo Islami i reklamuar.

Ka prej atyre që pretendojnë se janë myslimanë, ata janë myslimanë vetëm në emër, por ulen në sofrën e armikut, sillen rreth boshtit të tij dhe i puthin duart. Është e natyrshme që ai (armiku) nuk ka frikë nga ky lloj Islami.

Diga e vërtetë vjen nga **Islami i vërtetë**, Islami i Kur'anit, Islami që thotë: **"Allahu nuk do t'u japë jobesimtarëve një rrugë kundër besimtarëve".**⁴ Nëse e ngushtojmë më shumë rrethin dhe afrohemi më shumë qendrës, themi se është Islami që thotë: **"Allahu ka blerë nga besimtarët jetët dhe pasuritë e tyre për shkëmbim me Xhenetin".**⁵ Është Islami juaj, trupat e të cilëve janë të mbushur me copa predhash; në trupin tuaj, nga koka deri te thembra, janë shenjat e luftës në rrugën e Allahut; ata që janë si ju, nga ata të përkushtuarit, familjet e dëshmorëve apo ata që morën pjesë në luftë dhe u kthyen të sigurt, përkundër dëshirës së armikut, kjo është diga kryesore dhe pengesa reale.

⁴ Sure "En Nisa", ajeti 141.

⁵ Sure "Et Teube", ajeti 111.

Duhet të përballemi me armikun

Armiku nuk është i pavetëdijshëm ndaj kësaj pengese, përkundrazi, ai gjithmonë përpiqet ta anashkalojë, të ngulë thonjtë në të dhe të përdorë mashtrimet e tij. Ne duhet të përballemi me të gjitha këto, t'i rezistojmë dhe t'i kundërvihemi.

Lëvizja dhe përpjekja janë gjithmonë të domosdoshme për pastrimin e vetes dhe ndërtimin e personalitetit. Kjo vjen para çdo gjëje tjetër, ashtu siç veproi Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), që është zotëria dhe udhëheqësi juaj.

Po ashtu, edhe në aspektin politik, kërkohet: veprim, urdhërim për të mirë dhe ndalim nga e keqja, pjesëmarrje politike dhe, në vendet e nevojshme, shpallje e qëndrimeve politike përballë botës arrogante (shteteve arrogante).

Gjithashtu, edhe në fushën e xhihadit kulturor, domethënë: ndërtimi i njeriut, përmirësimi i vetes, edukimi dhe pastrimi i mendimit personal, përhapja e dijes dhe e kulturës. Kjo është një detyrë për çdo person që merr Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) si shembull dhe udhërrëfyes.

Është për t'u gëzuar që i gjithë populli ynë e sheh Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) me respekt dhe nderim të madh. Kjo është, gjithashtu, ndjenjë e shumë jomyslimanëve.

Hyseni përballet me të gjithë botën

Tani arrijmë te Qerbelaja, e cila ka një rëndësi të madhe, për një arsye tjetër: ajo është një mësim për ata që duan ta marrin këtë Imam si shembull.

Shihni, të dashurit e mi, se ngjarja e Qerbelasë zgjati vetëm një ditë ose pak më shumë. Në të u martirizuan 72 veta, ndoshta më shumë ose më pak, ndërsa në botë ka shumë njerëz që janë vrarë dhe vazhdojnë të vriten. Por ju shihni madhështinë dhe lartësinë e ngjarjes së Qerbelasë. Ajo e meriton këtë lartësi dhe madhështi, madje është më e lartë dhe më madhështore, sepse ndikimi dhe bekimet e saj kanë depërtuar thellë në qenien njerëzore. Nuk është fjala për përmasat trupore të kësaj ngjarjeje, sepse fëmijë janë vrarë gjithkund në botë. Në Qerbela u vra një foshnjë gjashtëmuajshe. Edhe në vende të tjera janë vrarë qindra fëmijë. Pra, rëndësia nuk qëndron në aspektin material të saj, por në shpirtin dhe kuptimin që mbart.

Shpirti i kësaj ngjarjeje është se Imami Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk po përballej vetëm me një ushtri të madhe apo me një grup të shumtë, edhe sikur numri i tyre të ishte njëqind herë më i madh, por ai po përballej me një botë të tërë të errësirës dhe të shmangies. Kjo është thelbësore.

Në atë kohë, bota e errësirës kishte gjithçka: pasuri, ar, forcë, libra, poetë, tregimtarë, oratorë, një pozitë aq e tmerrshme, saqë trupi i njeriut do të dridhej nga frika. Por zemra e Imamit Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk u drodh, as hapat e tij nuk u lëkundën. Ai nuk ndjeu dobësi dhe as hezitim. Ai doli në fushë i

vetëm dhe i vendosur. Madhështia e kësaj ngjarjeje qëndron në faktin se ajo ishte për Allahun.

Mund të krahasohet pozicioni i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) me atë të gjyshit të tij, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në kohën e shpalljes së profetësisë. Ashtu si Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) përballej me një botë të tërë, ashtu edhe Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) qëndroi në Qerbela përballë një bote të tërë. Ashtu siç nuk u frikësua Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), edhe Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) qëndroi i vendosur dhe i patundur.

Këtu shfaqet kuptimi i fjalës: “*Hyseni është prej meje dhe unë jam prej Hysenit*”. Kjo është madhështia e qëndrimit të Imamit Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Kur ai tha natën e Ashures: “*Shkoni, ju jeni të lirë nga unë. Kjo natë ju ka mbuluar, merreni atë si mbulesë dhe secili prej jush të marrë një nga të afërmit e mi me vete, sepse këta njerëz më kërkojnë vetëm mua...*”, ai nuk po bënte shaka. Edhe sikur ata të kishin pranuar dhe ta kishin lënë vetëm apo të mbeteshin me të vetëm dhjetë vetë, a do të zvogëlohej madhështia e veprës së tij? Jo, kurrsesi.

Nëse përreth tij nuk do të ishin 72 vetë, por 72 mijë, a do të shtohet apo do të zvogëlohet madhështia? Jo, ajo mbetet po aq madhështore. Ai nuk hezitoi përballë presionit të kësaj bote.

Madhështia e qëndrimit të tij qëndron në qetësinë dhe vendosmërinë me të cilën ai përballej me një botë që e kundërshtonte atë dhe pretendonte të drejtën kundër tij, pa u lëkundur. Ndërkohë, në një situatë të tillë, shumica e njerëzve, madje edhe më të shquarit, do të dridheshin.

Siç e kam theksuar shpesh, personalitete si Abdullah ibn Abasi, i njohur dhe me reputacion, si dhe të gjithë prijësit e kurejshëve, ishin të zhgënjyer dhe të tronditur nga situata. Po kështu, edhe Abdullah ibn Zubejri, Abdullah ibn Umeri, Abdurrahman ibn Ebu Bekri, bijtë e sahabëve të mëdhenj dhe vetë disa sahabë.

Në Medinë kishte shumë sahabë. Ata ishin burra me nder dhe guxim. Ata nuk ishin frikacakë. Madje ata u përballën me Muslim ibn Akabahin në betejën e El Harretusë, kur ai sulmoi Medinën dhe kreu masakra atje, vetëm një vit pas Qerbelasë. Pra, ata nuk ishin burra pa nder, por trimëria, për të dalë në një betejë është një gjë, ndërsa trimëria për t'u përballuar me një botë të tërë, është një gjë tjetër. Kjo ishte ajo që bëri Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*). Prandaj unë e quaj lëvizje të pastër hyseniane.

Qëndrimi i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte një frymë e pastër nga ajo lëvizje hyjnore. Disa mund të thonë: "Hyseni u vra i etur në shkretëtirën e Qerbelasë, ndërsa udhëheqësi ynë jetoi me nder dhe u përcoll nga turma". Por ky nuk është thelbi i çështjes. Thelbi është se të dy u përballën me një përbindësh të madh, bosh në përmbajtje, por të armatosur me çdo gjë. E kemi përmendur më parë se çfarë zotëronin armiqtë e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*): pasuri, forcë, kalorës, oratorë dhe propagandistë.

Të dashurit e mi, situata juaj sot i ngjan asaj situate. Qerbelaja është e shtrirë në gjithë kohërat, nuk është e kufizuar në një hapësirë prej disa qindra metrash. Sot historia po përsëritet. Bota e shtypjes dhe e arrogancës, bota e tiranisë globale, po qëndron përballë Republikës Islamike.

KAPITULLI I DYTË

MËSIME NGA NGJARJET E ASHURES

Qëllimi i Hysenit: Ringjallja e sistemit dhe e shoqërisë islame⁶

Me rastin e ditës së Ashures, sot do të flas për revoltën e Hysenit. Është diçka e çuditshme, sepse jeta jonë është e mbushur me përmendjen e Hysenit, falënderimi i qoftë Allahut. Shumë është thënë për këtë lëvizje të këtij njeriu të madh, por sa më shumë që njeriu të thellohet dhe të reflektojë mbi këtë çështje, aq më shumë i hapen horizontet për mendim, kërkim dhe lexim. Ende ka shumë gjëra që nuk janë thënë për këtë ngjarje madhështore dhe të jashtëzakonshme, e cila nuk ka të ngjashme. Prandaj duhet të reflektojmë dhe të meditojmë për të, pastaj t'ua përcjellim të tjerëve.

Më shumë se njëqind mësimë nga një lëvizje që zgjati vetëm disa muaj

Nëse ndjekim ngjarjen që nga momenti kur Ebu Abdullahu, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u nis nga Medina drejt Mekës, e deri sa ra dëshmor në Qerbela, mund të themi se një njeri mund të përmbledhë njëqind mësimë të rëndësishme nga

⁶ Ligjëratë e udhëheqësit të Revolucionit Islam gjatë faljes së xhumasë, në ditën e dhjetë Muharrem, 1416 hixhri.

kjo lëvizje, që zgjati vetëm disa muaj. Nuk dua të them mijëra mësim, megjithëse edhe kjo është e mundur, sepse çdo gjest i këtij njeriu të madh është vetë një mësim. Por, kur themi “njëqind mësim”, kjo do të thotë se, nëse analizojmë veprimet e tij, mund të nxjerrim njëqind tema dhe kapituj të ndryshëm. Secili prej tyre është një mësim për një komb, një histori, një vend, për edukimin e vetes, për menaxhimin e shoqërisë dhe për afrimin me Zotin.

I tillë është Hyseni, i biri i Aliut. Emri dhe përmendja e tij janë si dielli ndriçues ndërmjet shenjtorëve. Nëse profetët, imamët, dëshmorët dhe të drejtët janë si hëna dhe yjet, atëherë Hyseni është si dielli që ndriçon mbi ta. E gjithë kjo është për shkak të këtyre çështjeve madhore.

Mësimi kryesor... Pse u ngrit Hyseni?

Përveç atyre njëqind mësimëve, ka një mësim kryesor në këtë lëvizje, që do të përpiqem ta sqaroj për ju: Pse u ngrit Hyseni? Pse u ngrite, o Hysen, ti që ishe një figurë e respektuar në Mekë dhe Medinë, dhe kishe përkrahësit e tu në Jemen? Shko në një vend, ku nuk ke të bësh me Jezidin dhe Jezidi nuk ka të bëjë me ty, ku mund të jetosh, të adhurosh Zotin dhe të përcjellësh mesazhin tënd.

Kjo është pyetja dhe mësimi kryesor. Nuk pretendojmë se askush nuk e ka përmendur këtë çështje më parë. Shumë kanë bërë kërkime dhe kanë folur gjerësisht për këtë temë. Ajo që dëshirojmë të themi sot, sipas mendimit tim, është një përfundim gjithëpërfshirës dhe një qasje e re ndaj kësaj çështjeje.

A u ngrit Hyseni për të themeluar një qeveri?

Disa kënaqen duke thënë: Qëllimi i revolucionit të Ebu Abdullahut, Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte rrëzimi i qeverisë së Jezidit të korruptuar dhe krijimi i një qeverie tjetër në vend të saj. Kjo thënie është pjesërisht e saktë, por jo krejtësisht e gabuar, nëse qëllimi është të thuhet se Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u ngrit për të themeluar një qeveri, por, kur pa se kjo nuk ishte e mundur, tha: “Nuk arrita, le të kthehem”.

Ai që ngrihet për të themeluar një qeveri, vazhdon përpjekjen e tij për aq kohë sa sheh një mundësi për ta realizuar atë. Por, nëse e vëren se është e pamundur ose nuk ekziston as një mundësi e arsyeshme për sukses, atëherë ai kthehet mbrapsht. Pra, të thuash se qëllimi i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) nga kjo lëvizje ishte krijimi i një qeverie të drejtë alevite, si ajo e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), nuk është e saktë, sepse tërësia e kësaj lëvizjeje nuk tregon këtë qëllim. Këtë do ta shpjegoj më vonë.

Përkundrazi, disa të tjerë kanë thënë: Çfarë qeverie? Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) e dinte se nuk do të mund të themelonte një qeveri. Ai erdhi për t’u vrarë dhe për të rënë dëshmor. Kjo ide është përhapur shumë për një periudhë të gjatë dhe disa e shprehën atë me fjalë të bukura e tërheqëse. Më pas pashë se edhe disa dijetarë të mëdhenj kishin mbajtur këtë qëndrim. Pra, kjo nuk është një ide e re. Ajo thotë se Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u ngrit për të rënë dëshmor, sepse e pa që nuk mund të bënte asgjë duke qëndruar në heshtje, prandaj tha: “Duhet të bëj diçka përmes dëshmisë”.

A u ngrit Hyseni për të rënë dëshmor?

Edhe kjo pikëpamje nuk ka mbështetje në burimet juridike islame. Nuk ekziston ndonjë argument që e lejon njeriun të hidhet vetë në zjarrin e vdekjes. Martirizimi që ne e njohim në ligjin e shenjtë islam, në ajetet e Kur'anit dhe hadithet, nënkupton që njeriu të veprojë, të lëvizë dhe të përballet me vdekjen për një qëllim të shenjtë, të detyrueshëm ose të lavdëruar. Ky është martirizimi i vërtetë në Islam. Por të niset njeriu vetëm për t'u vrarë, jo, ky nuk është martirizimi që promovon feja. Pra, edhe pse kjo ide përmban një pjesë të së vërtetës, nuk ishte qëllimi i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Prandaj, për ta përmbledhur shkurt: Nuk mund të themi se Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u ngrit për të krijuar një qeveri, por jo që u ngrit për të rënë dëshmor.

Qeveria dhe martirizimi janë dy rezultate dhe jo dy qëllime

Unë mendoj se ata që thonë se qëllimi ishte qeveria ose martirizimi, kanë ngatërruar qëllimin me rezultatin. Qëllimi nuk ishte as kjo, as ajo. Hyseni kishte një qëllim tjetër, të cilin donte ta arrinte përmes një rruge dhe një lëvizjeje që mund të përfundonte në njërën nga këto dy pasoja: ose themelimi i një qeverie të drejtë, ose rënia dëshmor.

Qeveria apo martirizimi, të dyja ishin të mundshme. Imami ishte i përgatitur për të dyja: si për themelimin e qeverisë, ashtu edhe për rënien dëshmor. Ai kishte përgatitur kushtet për qeverisje dhe, po ashtu, për sakrifikimin, rënien dëshmor. Po të realizohej ndonjëra prej tyre, ajo do të ishte e vlefshme. Por asnjëra prej tyre nuk ishte qëllimi vetë, ato ishin rezultate, jo qëllime.

Qëllimi i përmbushjes së detyrës së paplotësuar

Atëherë, cili ishte qëllimi? Po e them shkurtimisht, pastaj do ta sqaroj pak më tepër: Nëse duam të shprehim qëllimin e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), duhet të themi se qëllimi i këtij madhështori ishte të përmbushte një detyrë të madhe fetare, që nuk ishte përmbushur ende nga askush para tij, as nga Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), as nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), as nga Imam Hasan El Muxhteba (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo ishte një detyrë që zë një vend shumë të rëndësishëm në ndërtimin e përgjithshëm të sistemit mendues, etik dhe praktik të Islamit.

Por, pse kjo detyrë, me gjithë rëndësinë dhe autenticitetin e saj, nuk ishte përmbushur deri në kohën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*)? Sepse duhej që, pikërisht, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ta përmbushte këtë detyrë, në mënyrë që të bëhej një mësim i gjallë dhe praktik përmes historisë, ashtu siç u bë themelimi i qeverisë nga Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) një mësim për historinë islame,

ashtu siç u bë lufta e tij në rrugën e Zotit një mësim për të gjithë historinë e njerëzimit.

Po kështu, duhej që Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ta përmbushte këtë detyrë, në mënyrë që të mbetej si një shembull i përhershëm praktik për myslimanët në të gjitha kohërat.

Në kohën e Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të!) u krijua terreni për përmbushjen e kësaj detyre

Pse e kreu Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) këtë detyrë? Ai e kreu këtë detyrë, sepse terreni dhe kushtet ishin bërë të përshtatshme në kohën e tij. Po të mos ishin krijuar këto kushte në kohën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), por të ishin krijuar, për shembull, në kohën e Imam Ali el Hadit (*Paqja qoftë mbi të!*), atëherë do të ishte ai që do ta përmbushte këtë detyrë dhe do të ishte bërë ai “therorja e madhe për Islamin”. Nëse kjo do të kishte ndodhur në kohën e Imam Hasan El Muxhtebasë (*Paqja qoftë mbi të!*), ai do të kishte vepruar. Nëse do të kishte ndodhur në kohën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), atëherë edhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) do të kishte vepruar.

Por një mundësi e tillë nuk u krijua në kohën e asnjë imami tjetër deri në kohën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe për këtë arsye, pikërisht ai e përmbushi këtë detyrë madhore.

Pra, qëllimi ishte përmbushja e kësaj detyre. Në këtë rast, rezultati i përmbushjes së detyrës do të ishte një nga dy mundësitë: ose arritja e pushtetit dhe e qeverisjes, përmes së cilës

shoqëria do të kthehej në gjendjen që ishte në kohën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ose arritja e martirizimit. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte i përgatitur edhe për këtë.

Allahu i Lartësuar e krijoi Hysenin në atë mënyrë që të mund të përballonte barrën e madhe të dëshmisë, për hir të kësaj detyre. Ai vërtet e përballoi. Ndërsa historia e tragjeditë të Qerbelasë është një tregim tjetër, me madhështinë dhe peshën e saj të veçantë.

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) erdhi me mësimet islame

Tani do të sqarojmë pak këtë çështje: Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si edhe çdo profet tjetër, kur është dërguar, ka ardhur me një grup mësimesh. Disa prej tyre janë individuale për përmirësimin e individit, disa të tjera shoqërore, për ndërtimin e shoqërive dhe administrimin e jetës njerëzore. Ky grup rregullash quhet sistemi islam.

Kur Islami zbriti në zemrën e shenjtë të Profetit të Nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), solli me vete namazin, agjërimin, zekatin, dhënien në rrugë të Allahut, Haxhin, dispozitat islame dhe marrëdhëniet individuale. Pastaj solli xhihadin në rrugë të Allahut, vendosjen e qeverisjes, sistemin ekonomik dhe marrëdhëniet mes sunduesit dhe të sunduarve, si dhe detyrimet e popullit ndaj udhëheqësit.

Këtë grup rregullash Islami ia paraqiti njerëzimit dhe Profeti i Nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i shpjegoi duke thënë: “Nuk ka asgjë që t’ju afrojë në Xhenet dhe t’ju largojë nga Zjarri, veçse ju kam urdhëruar për të”.⁷

Profeti i Nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk bëri vetëm sqarimin e gjithçkaje që e bën njeriun dhe shoqërinë njerëzore të lumtur, por ai edhe i zbatoi ato në praktikë. Ai vendosi qeverisjen islame, ndërtoi shoqërinë islame, zbatoi ekonominë islame, e vendosi xhihadin, mbledhi zekatin dhe kështu ndërtoi një sistem islam. Ishte vetë Profeti i nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe pasardhësi i tij, arkitekti dhe udhëheqësi i këtij sistemi.

Rruga ishte e qartë dhe e ndriçuar, prandaj për individin dhe shoqërinë islame ishte detyrë që të ecnin në këtë rrugë dhe të ndiqnin këtë drejtim. Nëse do të ndodhte kështu, njerëzit do të arrinin përsosmërinë, do të bëheshin të mirë si engjëjt dhe nga ata do të largohej padrejtësia, e keqja, korrupsioni, përçarja, varfëria dhe injoranca, dhe do të arrinin lumturinë e plotë, duke u bërë robër të përsosur të Allahut.

⁷ “Biharul Enuar”, vëll. 2, f. 170.

Cila është detyra, nëse shoqëria islame largohet nga rruga e duhur?

Mirë, mbetet këtu një pyetje: Çfarë ndodh, nëse një dorë apo një ngjarje e largon nga rruga e tij atë tren që vuri në lëvizje Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)? Cila është detyra, atëherë? Nëse shoqëria islame devijon dhe ky devijim arrin një shkallë të tillë, saqë lind frika për devijimin e vetë **thelbit të Islamit dhe parimeve islame**, atëherë duhet ta dimë se devijimi është i dy llojeve:

1- Herë devijojnë njerëzit, kjo ndodh shpesh, por rregullat dhe ligjet e Islamit mbeten të shëndosha.

2- Herë tjetër devijojnë njerëzit, por bashkë me ta edhe sundimtarët, dijetarët dhe përçuesit e fesë, të cilët e shtrembërojnë Kur'anin dhe të vërtetat, i kthejnë të mirat në të këqija dhe të këqijat në të mira, e quajnë të drejtën të padrejtë dhe të padrejtën të drejtë, dhe e shtrembërojnë Islamin 180 gradë.

Cila është detyra në atë kohë, nëse sistemi dhe shoqëria islame sprovohen me një gjë të tillë?

Detyra është e qartë, por kushtet për zbatimin nuk ishin të përgatitura

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ka sqaruar detyrën dhe Kur'ani e ka përcaktuar me fjalën e Tij: **“O ju njerëz! Kushdo që largohet nga feja e tij,**

Allahu do të sjellë një popull që Ai i do dhe ata e duan Atë; janë të përulur ndaj besimtarëve, krenarë ndaj jobesimtarëve, luftojnë në rrugë të Allahut dhe nuk frikësohen nga qortimi i askujt”.⁸ Për këtë ka shumë ajete dhe transmetime të tjera.

Por, a kishte mundësi Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të vepronte sipas kësaj dispozite hyjnore? Jo, sepse zbatimi i kësaj urdhërese islame është i mundur vetëm në një epokë ku shoqëria islame devijon aq shumë, saqë bëhet e frikshme humbja e vetë besimtarëve dhe e shoqërisë islame.

Shoqëria islame nuk kishte devijuar në kohën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), as në kohën e Imam Aliut, në atë formë ekstreme. Po ashtu, as në kohën e Imam Hasanit, kur Muavija ishte në krye të pushtetit, edhe pse u shfaqën shumë shenja të atij devijimi, por nuk arriti në atë pikë ku të frikësohej për vetë thelbin e Islamit.

Po, ndoshta mund të thuhet se në një periudhë të caktuar kohore devijimi kishte arritur atë shkallë, por atëherë nuk ishte e mundur ndërmarrja e një lëvizjeje të tillë dhe nuk ishte koha e përshtatshme për ta realizuar këtë çështje.

⁸ Sure “El Maide”, ajeti 54.

Domosdoshmëria e rikthimit në rrugën e drejtë e shoqërisë së larguar

Kjo dispozitë, e cila konsiderohet nga dispozitat islame, nuk është më pak e rëndësishme se vetë qeverisja, sepse qeverisja nënkupton administrimin e shoqërisë. Nëse shoqëria devijon e priset, atëherë edhe legjislacioni i Allahut pezullohet dhe nuk do të kemi një urdhër për domosdoshmërinë e ndryshimit të kësaj gjendjeje dhe rinovimin e jetës, ose siç quhet sot, “revolucion”, atëherë çfarë vlere do të kishte qeverisja në Islam?

Pra, urdhri që lidhet me kthimin në rrugën e drejtë të shoqërisë së larguar nuk është më pak i rëndësishëm se vetë qeveria. Madje, mund të thuhet se ai është më i rëndësishëm se xhihadi kundër jobesimtarëve dhe urdhërimi për të mirë e ndalimi nga e keqja, në raport me shoqërinë islame. Ai madje është më i rëndësishëm se edhe adhurimet më të mëdha, si Haxhi.

Pse? Sepse kjo dispozitë, në të vërtetë, siguron ringjalljen e Islamit, pasi ai është pranë vdekjes, ose ka vdekur e është zhdukur.

Mirë, kush është ai që duhet ta zbatojë këtë dispozitë dhe ta përmbushë këtë detyrë? Ai është pasuesi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili jeton në një kohë kur ndodh kjo shmangie, me kusht që të jetë e pranishme koha e përshtatshme për ta realizuar këtë mision, sepse Allahu nuk urdhëron për diçka nga e cila nuk ka dobi.

Sigurisht, qëllimi me “kohë e përshtatshme” nuk është mungesa e rrezikut, jo, nuk është kjo që synohet, por njeriu të jetë

i sigurt se ky veprim do të sjellë rezultat, d.m.th. mesazhi do të arrijë te njerëzit, ata do të kuptojnë dhe nuk do të vazhdojnë të jetojnë në gabim.

Shmangia ndodhi në kohën e Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të!) dhe u krijua terreni i përshtatshëm për revolucion

Islami ishte larguar nga rruga e duhur në kohën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe koha ishte e përshtatshme, prandaj ishte detyrë që ai të ngrihej në revolucion. Personi që mori pushtetin, pas Muavijas, nuk i respektoi as shenjat e jashtme të Islamit. Ai ishte i zhytur në alkool, shthurje, tallte Kur'anin dhe promovonte poezi të ndaluara nga Islami.

Ai shkelte haptas parimet e Islamit, por, për shkak se ishte udhëheqës i myslimanëve, nuk e shpalli ndarjen e tij nga Islami. Ai as nuk punonte për Islamin, as nuk kujdesej për të. Me veprat e tij ishte si një burim i ndotur uji që ndot gjithë rrethinën përreth.

I tillë është ndikimi i një sundimtari të korruptuar: pasi ai ndodhet në një pozitë të lartë, çdo gjë që del prej tij, nuk mbetet e kufizuar te vetja, por përhapet dhe ndikon në të gjithë shoqërinë. Kjo është ndryshe nga njerëzit e zakonshëm, sepse devijimi i tyre mbetet i kufizuar në vetvete ose ndoshta ndikon te disa përreth tyre.

Sigurisht, sa më i lartë të jetë pozicioni dhe funksioni i dikujt në shoqërinë islame, aq më i madh është dëmi nga shmangia e tij. Por, nëse korruptohet ai që ndodhet në krye të

pushtetit, atëherë shmangia përhapet në të gjithë tokën. Dhe, nëse ai është i drejtë dhe i mirë, mirësia e tij përhapet, gjithashtu, në të gjitha anët.

Një person i tillë, me gjithë atë shthurje, erdhi pas Muavijas, si udhëheqës i myslimanëve dhe u shpall si “zëvendësi i Profetit” (kalifi i të Dërguarit të Allahut). A ka shmangie më të madhe se kjo? Pra, u krijua terreni i përshtatshëm për revolucion.

Por, çfarë nënkuptohet me “krijimin e terrenit”?

A do të thotë se nuk ka rrezik? Jo, rreziku ishte i pranishëm. Nuk ka kuptim të priste që ai që është në krye të pushtetit, të rrinte në heshtje përballë kundërshtarëve të tij dhe të mos u shkaktonte atyre rreziqe. Përkundrazi, ishte e natyrshme që ai t’i godiste kundërshtarët e tij.

Pozita e imamëve është e njëjtë

Kur themi se koha ishte e përshtatshme, nënkuptojmë që rrethanat në shoqërinë islame ishin të tilla që e lejonin Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) ta përcillte thirrjen e tij jo vetëm tek njerëzit e atij brezi, por edhe në gjithë historinë.

Nëse do të kishte dashur të bënte revolucion në kohën e Muavijas, thirrja e tij nuk do të dëgjohej, sepse pushteti dhe politikat në atë kohë nuk lejonin që njerëzit të dëgjonin fjalën e të vërtetës.

Prandaj, edhe pse ai ishte imam për dhjetë vjet gjatë sundimit të Muavijas, nuk ndërmori asnjë veprim revolucionar, ashtu si nuk e ndërmori as Imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*) në kohën e Muavijas, sepse rrethanat nuk ishin të përshtatshme. Jo, sepse Imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ishte i denjë për një kryengritje të tillë, nuk ka asnjë ndryshim mes Imam Hasanit dhe Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi ta!*), po ashtu as mes Imam Hysenit dhe Imam Zejnul Abidinit (Sexhadit), as mes Imam Hysenit dhe Imam Hadit apo Imam Hasan El Askeri (*Paqja qoftë mbi ta!*). Sigurisht, pozita e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) është më e lartë, për shkak se ai e kreu këtë lloj xhihadi, por të gjithë imamët janë të barabartë në postin e imamtit.

Po të ndodhte kjo ngjarje (devijimi i madh) në kohën e cilitdo prej tyre, edhe ai Imam do të ngrihej dhe do të arrinte të njëjtën gjë që bëri Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*).

Përmbushja e këtij detyrimi është e rrezikshme

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u përball me një shmangie të tillë dhe rrethanat ishin të përshtatshme, prandaj nuk kishte rrugëdalje tjetër, përveçse ta përmbushte këtë detyrë hyjnore. Kur Abdullah ibn Xhaferri, Muhamed ibn El Hanefije dhe Abdullah ibn Abasi, të gjithë nga dijetarët dhe njohësit e thellë të fesë, i thanë se lëvizja jote është rrethuar me rreziqe, prandaj ‘mos shko’, ata kishin për qëllim të thoshin: “Ky detyrim ka rënë për shkak të rrezikut”. Por ata nuk e kuptuan se ky nuk ishte një detyrim që bie, kur ka rrezik, sepse ky lloj detyrimi është gjithmonë i shoqëruar me rreziqe.

Si është e mundur që një njeri të ngrihet kundër një pushteti tiranik e të fuqishëm, pa u përballur me rrezik? Ky është pikërisht ai detyrim që përmbushi edhe Imam Khomeini, të cilit i thanë: “Ti po e hedh veten në rrezik, duke u përballur me Shahun!”

Vallë, a nuk ishte Imam Khomeini i vetëdijshëm për rrezikun? A nuk e dinte ai që shërbimi i sigurisë i regjimit të Pahlavit do ta arrestonte, do ta vriste, do ta torturonte dhe do të internonte edhe shokët më të afërt të njeriut?

Po, ajo që ndodhi në kohën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ndodhi edhe në kohën e Imam Khomeinit, por në një formë më të vogël. I vetmi dallim ishte se në Qerbela çështja përfundoi me martirizim, ndërsa këtu (në Iran) me themelimin e qeverisë.

Qëllimi i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i udhëheqësit tonë të madh, Imam Khomeinit, ishte i përbashkët. Ky është vetë burimi i njohurive hyseniane, të cilat përbëjnë një aspekt të rëndësishëm të dijes shi’ite dhe janë një shtyllë themelore e Islamit.

Qëllimi ishte, rikthimi i shoqërisë islame në rrugën e drejtë

Pra, qëllimi ishte, rikthimi i Islamit dhe i shoqërisë islame në rrugën e drejtë (siratul mustakim), pasi ajo ishte larguar nga rruga e saj, për shkak të paditurisë së disa njerëzve, padrejtësisë, tiranisë dhe tradhtisë së tyre.

U krijua një terren i përshtatshëm. Është e qartë se etapat e historisë nuk janë të njëjta, mund të jenë të favorshme në një kohë, por jo në një tjetër.

Ato ishin të favorshme në kohën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe po ashtu janë krijuar edhe në kohën tonë. Kështu, Imam Khomeini ndërmoi të njëjtën veprimtari, por me një dallim: revolucionin kundër pushtetit të padrejtë në kohën tonë përfundoi me themelimin e një qeverie islame, falë Zotit, ndërsa rezultati i revolucionit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte martirizimi.

A nënkupton kjo që revolucionin, në rastin e dytë, nuk është detyrë? A është i pavlefshëm, nëse përfundon me rënien dëshmor? Jo, revolucionin është i detyrueshëm, edhe nëse përfundon me martirizim. Nuk ka dallim, nëse përfundon me qeverisje apo me martirizim, sepse të dyja kanë një lloj përfitimi dhe vlere. Prandaj, duhet të ndërmerret veprim dhe të ketë lëvizje.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte i pari që përmbushi këtë detyrë

Kjo ishte ajo që ndërmori Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*). Ai ishte i pari që ndërmori një veprim të tillë. Askush para tij nuk e kishte bërë këtë, sepse nuk kishte ndodhur një shmangie e tillë, as në kohën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), as në kohën e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Edhe nëse kishte pasur ndonjë shmangie në disa aspekte, rrethanat nuk ishin të përshtatshme për një lëvizje të tillë, ndërsa në kohën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) u bashkuan të dy kushtet, shmangia dhe mundësia për veprim. Ky është vetë thelbi i çështjes në lëvizjen e tij.

Pra, mund ta përmbledhim çështjen kështu: Revolucioni i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte për të përmbushur një detyrë të madhe: rikthimin e Islamit dhe të shoqërisë islame apo përballjen me shmangiet e rrezikshme që goditën shoqërinë islame. Kjo nuk mund të bëhej përveçse me revolucion dhe përmes urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja. Madje, kjo lëvizje ishte mishërimi më i madh i urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja.

Siç u tha, rezultati mund të jetë themelimi i një qeverie ose martirizimi. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte i përgatitur për të dyja rezultatet.

Rreziku që i kanosej Islamit në kohën e Jezidit

Dëshmia ime për këtë është ajo që kam zgjedhur nga vetë fjalët e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Kam përzgjedhur disa prej thënieve të Ebu Abdullahut, Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Të gjitha tregojnë për këtë kuptim:

Kur mëkëmbësi i Medinës, Velidi, e ftoi Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) natën dhe e informoi për vdekjen e Muavijas, i kërkoi që të japë besën e besnikërisë për Jezidin. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Le të agojmë dhe të agoni, të shohim dhe të shihni, kush është më i denjë për udhëheqjen (kalifatin)”.⁹

Kur Mervani e takoi në mëngjes dhe i kërkoi që të japë besën për Jezidin, që të mos vritet, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha: “Ne jemi të Allahut dhe te Ai do të kthehemi. *Paqja qoftë mbi Islamin, nëse umeti është sprovuar me një udhëheqës si Jezidi!*”¹⁰

Pra, çështja nuk është vetë Jezidi, si person, por çdokush që është si ai, me të njëjtat tipare. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) dëshironte të thoshte: “Kemi duruar gjithçka deri tani, por tani, vetë thelbi i fesë, i Islamit dhe i sistemit islam, është në rrezik”. Kjo tregon se shmangia ishte një rrezik serioz, pra, çështja ishte rreziku që kërcënonte vetë esencën e Islamit.

Në testamentin drejtuar vëllait të tij, Muhamed ibn el Hanefije, gjatë largimit të tij nga Meka, sepse ai ia kishte dhënë vëllait të tij testamentin dy herë: herën e parë, kur doli nga

⁹ Burimi: “Biharul Enuar”, vëll. 44, f. 325.

¹⁰ Burimi: “Biharul Enuar”, vëll. 44, f. 325.

Medina dhe herën e dytë, kur doli nga Meka, mendoj se kjo porosi i takon momentit të largimit nga Meka në muajin Dhul Hixhxe.

Pas dëshmisë për njësinë e Allahut, Profetësinë e Muhamedit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe të tjera, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: “Unë nuk kam dalë as për ambicie, as për krenari, as për përçarje apo padrejtësi. Unë kam dalë vetëm për të kërkuar reformë në umetin e gjyshit tim”.¹¹ Pra, qëllimi i tij nuk ishte domosdoshmërisht pushteti apo martirizimi, por reformimi i shoqërisë. Reformimi nuk është diçka e lehtë, ndonjëherë rrethanat e bëjnë të mundur të arrish pushtetin, ndonjëherë jo dhe përfundon në martirizim.

Në të dyja rastet, revolucioni është për hir të reformës. Pastaj thotë: “Dua të urdhëroj për të mirë dhe të ndaloj nga e keqja, dhe të veproj sipas rrugës së gjyshit tim”.¹² Reformimi realizohet vetëm përmes kësaj rruge dhe, siç thamë më herët, ky është vetë thelbi i urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja.

Kur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte në Mekë, ai dërgoi dy letra: të parën, drejtuesve të Basrës dhe të dytën, krerëve të Kufës. Në letrën që u dërgoi krerëve të Basrës, shkruante:

“Kam dërguar të dërguarin tim te ju me këtë letër. Ju ftoj në Librin e Allahut dhe në Sunetin e Profetit të Tij. Me të vërtetë, suneti është shuar dhe bidati është gjallëruar. Nëse e dëgjoni fjalën time, do t’ju udhëzoj drejt rrugës së udhëzimit”. Pra, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) dëshironte të përmbushte atë detyrë madhështore, që është

¹¹ Burimi: “Biharul Enuar”, vëll. 44, f. 329.

¹² Burimi: “Biharul Enuar”, vëll. 44, f. 329.

gjallërimi i Islamit dhe i Sunetit të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Ndërsa në letrën që u dërgoi krerëve të Kufës, shkruante: *"Pasha jetën time! Imami nuk është tjetër veçse ai që vepron sipas Librit (të Allahut), vepron me drejtësi, qëndron në të drejtën dhe sakrifikon veten për hir të Allahut! Selam..."*¹³

Me këtë, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) tregoi qartë qëllimin e tij për rebelimin.

Ai u fliste njerëzve në çdo vend që ndalej gjatë rrugës, pas largimit nga Meka, duke përdorur forma të ndryshme. Kur u përball me ushtrinë e Hurrit dhe më pas u ndanë në dy grupe, që udhëtonin paralelisht, deri sa arritën në vendin e quajtur Bejda, ai iu drejtua shokëve të Hurrit: *"O njerëz! I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: 'Kushdo që sheh një sundues tiran, që e lejon të ndalohet ajo që Allahu e ka bërë të ndaluar, që shkel besën e Allahut, që kundërshton Sunetin e të Dërguarit të Tij, që sillet me robërit e Allahut me mëkat e padrejtësi, dhe nuk e kundërshton atë me fjalë apo me vepra, është detyrë e Allahut ta fusë atë në të njëjtin përfundim me të (tiranin)'".*¹⁴ Pra, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka sqaruar se çfarë duhet bërë, kur sistemi islam devijon. Imam Hyseni u mbështet në këtë thënie të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

¹³ Burimi: "Biharul Enuar, vëll. 44, f. 325.

¹⁴ Burimi: "Biharul Enuar", vëll. 44, f. 382.

Pra, detyra është: ta ndryshosh atë me fjalë ose me vepra. Nëse dikush përballet me këtë devijim dhe rrethanat janë të favorshme, siç thamë më herët, atëherë ai duhet të ngrihet, edhe nëse përfundimi i tij është vrasja, mbijetesa, sukcesi apo jo.

Çdo mysliman ka për detyrë të ngrihet kundër këtij realiteti. Kjo është një detyrë e shpallur nga vetë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Pastaj Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Unë jam më i denjë se kushdo tjetër,” sepse ai është nipi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Nëse Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ua ka bërë këtë detyrë të gjithë myslimanëve një për një, atëherë nipi i tij, trashëgimtari i diturisë dhe i urtësisë së tij, Hysen ibn Aliu, është më se i denjë për t’u ngritur.

Imami Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Unë u ngrita për këtë çështje”. Pra, ai e shpall qartë shkakun dhe qëllimin e revoltës së tij: ndryshimi, që do të thotë revolucion kundër gjendjes së korruptuar.

Kur zbriti në Ezijd, atij iu bashkuan katër veta. Ai u tha atyre: “Pasha Allahun! Unë shpresoj që të jetë më e mira që Allahu dëshiron prej nesh. Nuk ka dallim, qoftë fitorja apo vrasja, detyra duhet përmbushur”.

Në fjalimin e tij të parë në Qerbela, ai tha: “Ka ndodhur me ne ajo që po e shihni... A nuk e shihni se e vërteta nuk zbatohet dhe ndaj të kotës nuk po merren masa? Prandaj, besimtari le të dëshirojë takimin me Allahun, me të drejtë...”

Pra, revolucion i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte për të përmbushur një detyrë: detyrën që çdo mysliman ka, që, nëse shih përhapjen e korrupsionit në rrënjët e shoqërisë islame dhe rrezikohet një ndryshim i plotë në dispozitat e Islamit, atëherë duhet të ngrihet.

Në atë kohë rrethanat ishin të favorshme dhe Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) e dinte se ky revolucion do të kishte rezultat, edhe nëse nuk është e domosdoshme të mbijetosh, të mos vritesh, të mos përjetosh dhunë apo torturë.

Imami Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u ngrit dhe e përmbushi këtë detyrë në mënyrë praktike, në mënyrë që të jetë një mësim për të gjithë. Mund të krijohen rrethana të përshtatshme për çdo person, në çdo kohë të historisë, që të ndër marrë një veprim të tillë. Natyrisht, në kohën e imamëve, pas Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), rrethanat nuk ishin të përshtatshme. Kjo ka një shpjegim: Ekzistonin detyra të tjera të rëndësishme, që duhej të përmbusheshin, prandaj ato rrethana ende nuk ishin pjekur në atë shoqëri islame deri në fundin e epokës së imamëve dhe fillimin e epokës së fshehjes.

Megjithatë, mund të ndodhë që rrethana të tilla të shfaqen herë pas here në vendet islame gjatë historisë. Ndoshta në disa vende të botës islame, tani, ekziston një terren i përshtatshëm për t'u ngritur myslimanët.

Nëse ata ngrihen me vendosmëri, ata do ta ruajnë Islamin dhe do të sigurojnë vazhdimësinë e tij. Mund të ndodhë që një apo dy persona të përballen me dështim, por, kur kjo lëvizje, ky

revolucion dhe kjo përpjekje reformuese të përsëritet, atëherë do të bëhet e mundur çrrënjësja e korrupsionit dhe devijimi.

Imami Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) i dha historisë islame një mësim të madh praktik. Me këtë siguroi vazhdimësinë e Islamit, si në kohën e tij, ashtu edhe në epokat që pasuan.

Pse duhet të ringjallet përkujtimi i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i Qerbelasë?

Kudo që gjendet një shkatërrim i tillë, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është i gjallë dhe i pranishëm. Na mëson me mënyrën dhe veprimin e tij se çfarë duhet të bëjmë. Prandaj, emri i Hysenit dhe përkujtimi i Qerbelasë duhet të mbetet i gjallë, sepse kjo ngjarje e mban këtë mësim praktik para syve tanë.

Fatkeqësisht, mësimi i Ashures nuk është njohur siç duhet në shumicën e vendeve islame, ndërsa në vendin tonë ai është i njohur dhe njerëzit e njohin Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe fryma hyseniane është mbizotëruese, prandaj nuk ishte e çuditshme, kur Imam Khomeini tha: “Muharremi është muaji i fitores së gjakut mbi shpatën”. Kjo është e vërteta, sepse gjakut i doli përballë shpatës dhe fitoi.

Unë i kam thënë këto fjalë në një mbledhje, afërsisht 25 vjet para fitores së revolucionit. Iu drejtova vëllezërve dhe motrave të pranishëm me fjalët: “Të dashur, me çfarë gjuhe tjetër duhet të na tregojë Hyseni se cili është detyrimi ynë?”

Imami Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) e sqaroi detyrën

Rrethanat janë po ato rrethana, jeta është po ajo jetë dhe Islami është po ai Islam. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka treguar praktikisht përgjegjësinë e të gjitha brezave. Edhe nëse nuk do të na ishte transmetuar asnjë fjalë e vetme nga Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), përsëri do të ishte detyra jonë ta kuptonim përgjegjësinë tonë.

Një popull i prangosur me zinxhirë dhe i rrënuar nga prishjet e sundimtarëve të tij, një popull mbi të cilin kanë vënë dorë armiqtë e fesë dhe që kanë gllabëruar pushtetin, duhet ta kuptojë detyrën e vet, sepse nipi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe imami i pagabueshëm na ka mësuar çfarë duhet të bëjmë në këto rrethana.

Këtë gjë nuk mund ta përçosh vetëm me fjalë. Edhe sikur ta kishte thënë atë me qindra gjuhë dhe të mos kishte ngritur krye vetë, thirrja e tij nuk do të kishte depërtuar në thellësitë e historisë. Nuk janë vetëm këshillat dhe fjalët ato që ndikojnë përgjatë historisë, duhet një akt i madh dhe i vështirë, një sakrificë e madhe dhe e dhimbshme, si ajo që bëri Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në të vërtetë, ajo që shohim të mishëruar para syve tanë nga ngjarja e Ashures, është e pashembullt në mesin e të gjitha ngjarjeve dhe fatkeqësive njerëzore. Në lidhje me akt, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Imam Aliu dhe Imam Hasani (*Paqja qoftë mbi ta!*), sipas

transmetimeve, kanë thënë: “Nuk ka ditë si dita jote, o Aba Abdillahi (o Hysen)!”¹⁵

Dallimi i detyrës kryesore nga detyrat dytësore¹⁶

Të qenit përpara dhe përcaktimi i detyrës kryesore

Ka shumë çështje të lidhura me ngjarjen e Ashures që, nëse bota islame, e veçanërisht mendimtarët e saj, do të merrnin nismën për ta studiuar këtë ngjarje, nga të gjitha aspektet, përfshirë përgatitjet dhe pasojat e saj, do të bëheshin të qarta rrugët e jetës islame dhe do të përcaktohej detyra e brezave myslimanë, në çdo rrethanë.

Një nga këto mësimë të rëndësishme është se Hysen ibn Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), në një moment jashtëzakonisht kritik të historisë islame, arriti të dallojë detyrën e tij kryesore nga detyrat e tjera, të cilat kishin, gjithashtu, rëndësi, por në nivele të ndryshme. Ai e përmbushi atë detyrë pa u ngatërruar aspak në njohjen e asaj që i duhej më së shumti botës islame në atë kohë.

Kjo është pikërisht pika e dobët që myslimanët kanë vuajtur gjatë gjithë historisë së tyre, d.m.th., gabimi që bëjnë

¹⁵ Burimi “Biharul Enuar”, vëll. 44, f. 218.

¹⁶ Takimi i Udhëheqësit të Revolucionit Islam me dijetarët dhe studentët e hauzeve fetare, më 5.7.1371 hixhri.

pjesëtarët e umetit, elitat e tyre dhe pararendësit e botës islame në përcaktimin e detyrës reale në një periudhë të caktuar historike. Ata nuk e kuptojnë dot se cila është çështja më e rëndësishme, për të cilën duhet të veprojnë dhe të sakrifikojnë gjithçka tjetër, sado e rëndësishme të jetë ajo. Po ashtu, nuk e kuptojnë cilat janë çështjet anësore dhe dytësore, për të cilat mjafton një përkushtim më i vogël.

Në thelb, çdo veprim apo nismë duhet t'i jepet vlera e duhur sipas nevojës së saj reale dhe për atë duhet të angazhohemi në përmasën që meriton.

Të prapambeturit nga detyra e vërtetë

Në kohën kur u ngrit Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), kishte njerëz që, nëse do të flitej me ta rreth domosdoshmërisë së veprimit dhe atyre do t'u bëhej e qartë se pasojat e këtij veprimi do të ishin vështirësi dhe sprovë, do të kapeshin pas detyrimeve dytësore, ashtu siç u vu re tek disa, dhe do të shmangeshin nga ajo që ishte më e rëndësishme.

Nga ata që nuk e ndihmuan Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) në lëvizjen e tij, kishte edhe njerëz të devotshëm dhe besimtarë, jo të gjithë ishin të lidhur me botën materiale.

Në atë kohë, ndër figurat dhe personalitetet e botës islame kishte besimtarë që dëshironin të vepronin sipas detyrës së tyre, por nuk e kuptonin dot se cili ishte detyrimi i kohës, nuk e njihnin situatën e kohës, as armikun e vërtetë dhe i ngatërronin detyrimet

kryesore me ato që ishin të dorës së dytë apo të tretë. Kjo vetë përbën një sprovë të vazhdueshme dhe të madhe për botën islame.

Njohja e detyrës themelore në jetën e shoqërisë

Edhe ne sot mund të biem pre e të njëjtit gabim, duke mos dalluar qartë atë që është më e rëndësishme dhe atë që ka më pak rëndësi. Prandaj, është e domosdoshme të studiohet dhe të zbulohet detyra themelore, ajo nga e cila varet qëndrueshmëria dhe jeta e shoqërisë.

Në një kohë kur përballja ishte me kolonializmin, tiraninë dhe aparatin e padrejtë të pabesimit, disa nuk arrinin ta identifikonin detyrën kryesore dhe merreshin me punë të tjera. Ndoshta kishin leksione për të dhënë, libra për të shkruar apo drejtonin një qendër të vogël arsimore e fetare, ose mbanin përgjegjësinë për udhëzimin e një grupi të vogël njerëzish. Mendonin se po të përfshiheshin në përballje të tilla, këto punë do të ndërpriteshin, ndaj linin pas dore xhihadin, me gjithë madhështinë dhe rëndësinë e tij, vetëm që të mos ndërpriteshin ato punë dytësore.

Ky është pikërisht gabimi në njohjen e detyrës më të rëndësishme përballë asaj që është vetëm e rëndësishme.

Detyra më e rëndësishme: Përballja me tiranët

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) e bëri të qartë për të gjithë, me fjalët e tij, se detyra më e rëndësishme për botën islame në ato rrethana, ishte përballja me qendrën e forcës tiranike dhe nisma për ta shpëtuar umetin nga pushteti i tij djallëzor. Është e qartë se, kur ai vendosi të shkojë drejt Irakut për të shkruar epopenë e Ashures, do të privohej nga qëndrimi në Medinë, nga përhapja e dispozitave të Allahut në mesin e njerëzve, nga mësimdhënia e dijes së Ehli Bejtit dhe edukimi i myslimanëve. Ai nuk do të kishte më mundësi t'u mësonte njerëzve se si të falnin apo të përcillte hadithet e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në mënyrë të natyrshme, seminari i tij do të ndalej, përhapja e dijes do të ndërpritej dhe do të privohej nga ndihma që jepte për jetimët, të varfrit dhe nevojtarët në Medinë. Të gjitha këto ishin detyra që i përmbushte para se të nisej për në Irak, por ai i flijoi të gjitha këto për hir të një detyre më të madhe.

Madje, siç e kanë transmetuar oratorët dhe predikuesit, ai hoqi dorë edhe nga Haxhi, për të përmbushur këtë detyrë të rëndësishme, në një kohë kur të tjerët po vërshonin për të kryer ritualet e Haxhit. Çfarë ishte ajo detyrë?

Imam Hyseni (Paqja qoftë mbi të!) e përcakttoi me qartësi detyrën e tij

Detyra, siç tha vetë ai, ishte përballja me regjimin sundues, burimin e korrupsionit, ku u shpreh: “*Dua të urdhëroj për të mirë*

dhe të ndaloj nga e keqja; të ndjek rrugën e gjyshit tim". Kjo ishte detyra. Ashtu siç tha në një hytbe tjetër gjatë rrugës: "O njerëz, i Dërguari i Allahut ka thënë: 'Kush sheh një sundimtar tiran që lejon të ndaluarat e Allahut, që e thyen besën e Allahut... dhe nuk reagon ndaj tij as me fjalë e as me vepër, është detyrë ndaj Allahut, që ta fusë atë në vendin ku do të përfundojë ai (sundimtari tiran)'".

Detyra është ndërrimi i sundimit të padrejtësisë dhe tiranisë

Detyra përbëhet nga ndërrimi i sundimit të padrejtësisë dhe pushtetit që përhap korrupsion në tokë dhe e çon njerëzimin drejt shkatërrimit dhe zhdukjes, si materialisht, ashtu edhe shpirtërisht. Kjo është filozofia e lëvizjes së Hysenit, birit të Aliut, e cila përfaqëson një shembull real të urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja. Këtyre pikave duhet t'u kushtohet vëmendje, kur bëhet fjalë për urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja. Prandaj, ai u nis në bazë të detyrës më të rëndësishme dhe sakrifikoi detyra të tjera për hir të saj. Ai e identifikoi saktë detyrën që kërkohej në kohën e tij.

Nuk lejohet të gabojmë në identifikimin e armikut dhe drejtimit të duhur

Në çdo kohë ekziston një lëvizje në shoqërinë islame dhe në çdo epokë ka një armik dhe një front që kërcënon Islamin dhe myslimanët. Ky armik duhet të njihet. Nëse gabohet në identifikimin e armikut dhe burimit nga ku Islami po sulmohet,

atëherë do të pësosh një humbje të madhe, që është e vështirë të rikuperohet. Nëse jemi indiferentë ndaj kësaj çështjeje, do të humbasim shumë mundësi. Ne jemi të ngarkuar me detyrën për të krijuar një ndjeshmëri të lartë, vigjilencë dhe për të përcaktuar qartë armiqtë dhe detyrat që i takojnë popullit tonë dhe botës islame.

Sot, me ngritjen e një qeverie islame dhe flamurit të ngritur të Islamit, gjë që nuk ka pasur precedent në historinë islame, që nga periudha e parë, myslimanët kanë mundësi të shumta. Prandaj, nuk kemi më të drejtë të jemi të pakujdesshëm ndaj njohjes së armikut apo të gabojmë në identifikimin e burimit të rrezikut.

Imperializmi botëror, rreziku më i madh për Islamin

Që nga fitorja e Revolucionit Islamik e deri më sot, përpjekja më e madhe e udhëheqësit tonë të dashur dhe e përkrahësve të tij në këtë lëvizje, në të gjitha nivelet dhe kapacitetet, ka qenë përcaktimi i rrezikut më të madh dhe armikut më të rrezikshëm për myslimanët dhe për shoqërinë islame në Iran, si dhe për themelet e drejtësisë dhe të së vërtetës në botën tonë moderne.

Edhe sot, si në të kaluarën, sulmi më i madh dhe rreziku i vazhdueshëm vjen nga hegjemonia globale dhe fuqitë jomyslimane dhe arrogante (imperializmi botëror). Ky është rreziku më i madh që kërcënon ekzistencën e myslimanëve. Është e vërtetë se dobësia e brendshme e shoqërisë e bën të mundur

sulmin e armikut, por kjo dobësi është e shkaktuar nga vetë armiku përmes mjeteve dhe mekanizmave që ai zotëron, të cilat i imponon mbi një shoqëri të shëndoshë, prandaj, nuk duhet të bëjmë gabime.

Prandaj, drejtimi i shoqërisë islame duhet të jetë gjithmonë në kundërshtim me imperializmin dhe hegjemoninë globale, që sot sundon mbi botën islame.

Zgjimi islam dhe burimi i armiqësisë amerikane

Fuqitë e mëdha janë armiq të Islamit dhe të zgjimit islam. Ata luftojnë Iranin islam, për shkak të besimit islam të tij. Të gjitha përpjekjet e tyre synojnë shuarjen e lëvizjes islame në botë. Natyrisht, Amerika arrogante dhe pushtuese qëndron në krye të armiqve tanë. Pas saj rreshtohen të gjitha fuqitë e tjera, të mëdha e të vogla, që për shkak të tronditjes së interesave të tyre ose frikës nga Islami, mbajnë një urrejtje të fshehtë ndaj tij.

Armiqësia e tyre ndaj Iranit vjen nga fakti që zgjimi islam ka nisur pikërisht nga ky vend. Të gjithë popujt myslimanë, në çdo cep të globit, e marrin frymëzimin e tyre nga kjo lëvizje dhe nga ky revolucion fitimtar, dhe ecin përpara me hapa të sigurt. Nëse armiqët do të arrijnë t'i shkaktojnë disfatë Islamit, në këtë pikë të botës, atëherë ata, përballjen me valën e zgjimit islam në nivel global, do ta konsiderojnë si fitoren e tyre më të madhe.

Kjo është një e vërtetë e prekshme sot, prandaj nuk duhet të gabojmë në identifikimin e armikut dhe nuk duhet të mendojmë

se ai është tërhequr nga armiqësia e tij ndaj Islamit dhe myslimanëve.

Mësimi i Arbaenit¹⁷

Gjallërimi i kujtimit dhe realitetit të dëshmisë

Rëndësia e Arbaenit qëndron kryesisht në faktin se kujtimi i kryengritjes së Hysenit është përjetësuar përgjithmonë dhe është ngulitur thellë në këtë ditë, falë një planifikimi hyjnor dhe urtësisë së Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*). Nëse familjet e dëshmorëve dhe heronjve, në ngjarje të ndryshme, siç është rasti me martirizimin e Hysenit, birit të Aliut, në Qerbela, do të kishin neglizhuar ruajtjen e kujtimit të dëshmisë dhe pasojave të saj, atëherë brezat e ardhshëm nuk do të përfitonin nga frytet e dëshmisë.

Është e vërtetë që Allahu i Madhëruar ka siguruar gjallërimin e dëshmorëve në Botën Tjetër dhe dëshmori mbetet i paharruar në mendjet e njerëzve përgjatë historisë, por Zoti e ka bërë këtë vepër një mjet natyror, si të gjitha veprat e tjera që varen nga vullneti dhe zgjedhja jonë. Pra, ne jemi ata që mund të gjallërojmë kujtimin e dëshmorëve dhe kuptimin e dëshmisë përmes vendimeve të drejta dhe të përshtatshme.

Përjetësimi i ngjarjes së Ashures

Po të mos ishte e Madhja Zejneb, Imam Sexhadi, Zejnul Abidini (*Paqja qoftë mbi ta!*), të cilët ndërmorën veprim në ditët e

¹⁷ "Hadithul Uialajeti", vëll. 2, f. 141-143.

robërisë, qoftë në pasditen e Ashures, në Qerbela apo gjatë rrugës drejt Kufes e Shamit, në Sham dhe më pas gjatë kthimit të tyre përmes Qerbelasë në Medinë, dhe, gjithashtu, në vitet që mbetën gjallë, për të luftuar, për të zbuluar të vërtetat dhe për të shpjeguar filozofinë e Ashures dhe qëllimin e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) në kryengritjen e tij dhe mizoritë e armiqve, atëherë ngjarja e Ashures nuk do të kishte mbetur e gjallë, aktive dhe e ndriçuar deri më sot.

Pse Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë, siç është transmetuar në hadithe: “Nuk ka askush që të thotë poezi për Hysenin dhe të mos qajë për të, pa ia bërë Zoti të detyrueshme Xhenetin dhe pa ia falur mëkatet”? Sepse të gjitha mjetet e propagandës ishin vënë në shërbim të izolimit të çështjes së Ashures dhe të familjes së Profetit Muhamedit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në përgjithësi, për ta mbuluar me errësirë këtë realitet dhe për ta penguar popullin, që të mësonte çfarë kishte ndodhur. Kjo është propaganda. Fuqitë tiranike dhe shtypëse, si atëherë, ashtu edhe sot, kanë përdorur në maksimum mediet e rreme, të njëanshme dhe djallëzore.

A mund të kishte mbetur gjallë një ngjarje kaq madhështore, që ndodhi në një kënd të izoluar të botës islame, në një atmosferë të tillë? Po të mos ishin ato përpjekje, është i qartë, që fati i saj do të ishte harrimi.

Ajo që e ka mbajtur gjallë këtë ngjarje, janë përpjekjet që ka bërë familja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Ata u përballën me pengesa të mëdha. Kjo ka qenë e vështirë, po aq sa ishte i vështirë vetë xihadi që bëri Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), kur ngriti flamurin e xihadit. Në këtë shkallë, ishte i vështirë edhe

xhiahadi i Zejnebit, i Imam Sexhadi (Paqja qoftë mbi ta!) dhe i të gjithë imamëve të tjerë të pastër. Sigurisht, fusha e tyre nuk ishte ushtarake, por mediatike dhe kulturore. Ne duhet t'i kushtojmë vëmendje të veçantë këtij aspekti.

Mësimi i Erbainit

Mësimi që na jep dita e Erbainit, është nevoja për të gjallëruar kujtimin dhe realitetin e dëshmisë, duke u përballur me valën e madhe të propagandës armiqësore. Ju sigurisht e keni vënë re madhështinë e masës së medieve armiqësore ndaj revolucionit, Imami, Islamit dhe këtij populli, që nga fitorja e Revolucionit Islamik deri më sot.

Mediat janë angazhuar për të luftuar kundër nesh në atë luftë që ne kemi bërë për mbrojtjen e Islamit, atdheut, dinjitetit dhe nderit të popullit tonë. Vëreni veprimet direkte dhe indirekte të armiqve kundër dëshmorëve tanë të shtrenjtë, të cilët vranë më të shtrenjtën gjë që kishin, shpirtin e tyre, duke u flijuar në rrugë të Allahut. Kjo u bë përmes transmetimeve të tyre, gazetave, revistave, librave që nxorën dhe fjalimeve që mbushën mendjet e njerëzve të thjeshtë në botë.

Në një moment, edhe disa nga të paarmatosurit, të papërgjegjshmit dhe të pashkolluarit, por edhe disa individë të njohur ose të panjohur në vendin tonë, dolën me fjalë në kohë lufte, që tregojnë mungesë njohjeje dhe injorancë ndaj realiteteve, duke shkaktuar dhimbje tek Imami ynë i shtrenjtë dhe duke e shtyrë atë të ngrejë britmat e tij hyjnore dhe të zbulojë të vërtetat

me sinqeritet të plotë. Po të mos ishte për përballjen me këtë propagandë, me një media të bazuar në të vërtetën dhe po të mos ishte ndërgjegjja që populli iranian ka treguar përmes predikuesve, shkrimtarëve dhe artistëve që kanë kushtuar përpjekjet e tyre për të shërbyer të vërtetën në këtë vend, fitues do të kishte qenë armiku në fushën e medias, e cila është një fushë shumë e madhe dhe shumë e rrezikshme.

Sigurisht, shumica e popullit tonë është e mbrojtur dhe e ruajtur nga mediet armiqësore dhe kjo falë ndërgjegjes që ka sjellë Revolucioni. Pas gënjeshtreve të shpërndara nga armiku dhe përmbysjes së fakteve që populli ynë i sheh me sytë e tij, kombi ynë humbi besimin në ato që thotë armiku dhe në mashtrimet që bëhen nga media botërore.

Përpjekjet e sistemit tiranik të Jezidit, përmes medias së tij, kanë qenë që të dënojnë Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), birin e Aliut dhe ta paraqesin atë si rebel kundër sistemit të drejtë islamik, dhe dalja e tij ishte vetëm për fitime materiale. Disa i besuan ato gënjeshtër të medieve të rreme. Kur Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), i biri i Aliut u martirizua, në Qerbela, situata e dhimbshme dhe e pazakontë që u krijua nga mizorët, u paraqit si një fitore dhe triumf, por media e drejtë e Imamatit kundërshtoi dhe e përmbysi tërë atë gënjeshtër. Kjo është e vërteta, në vetvete.

Filozofia e lëvizjes së Ashures¹⁸

Në njërën nga vizitat (zjaretet) që bëhet për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) në ditën e Erbainit, ekziston një frazë me një kuptim shumë të thellë dhe domethënës: “...dhe Ai e flijoi shpirtin e tij për Ty, për të shpëtuar robtë e Tu nga padituria dhe hutia e humbjes”. Në këtë frazë është përmbledhur filozofia e sakrificës që ndërmori Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), i biri i Aliut. Meditoni mbi këtë frazë dhe mbi kuptimin e saj të lartë dhe të përparuar.

Kush është ai që mund të shpëtojë njerëzimin?

Çështja qëndron në faktin se njerëzimi është gjithmonë i ekspozuar ndaj mashtrimeve të djajve. Të mëdhenjtë dhe të vegjlit, prej tyre, gjithmonë kanë sakrifikuar kombe dhe popuj, për të realizuar qëllimet e tyre. Ju e keni lexuar historinë dhe jeni njohur me gjendjen e sulltanëve, tiranëve dhe sunduesve despotikë dhe mënyrën se si janë sjellë me popujt. Dhe sot, ju jeni dëshmitarë të botës moderne dhe metodës që kanë ndjekur fuqitë e mëdha.

Njeriu bie pre e joshjeve dhe mashtrimeve të djajve, prandaj ka nevojë për ndihmë, për të ndihmuar robërit e Zotit, që

¹⁸ “Hadithul Uialajeti”, vëll. 2, f. 147-148.

të shpëtojnë veten e tyre nga padituria, nga humbja dhe nga shmangia e rrugës së drejtë.

Kush është i aftë ta ndihmojë njerëzimin?

Ata që janë robëruar nga lakmia, eposhet dhe dëshirat, nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë, sepse ata vetë janë të humbur. Ata që janë të zënë rob të egos dhe ëndrrave boshe, nuk mund ta shpëtojnë njerëzimin. Prandaj, është e domosdoshme të paraqitet dikush që do të marrë përsipër shpëtimin e tyre, ose të përfshihen nga mëshira hyjnore, në mënyrë që të forcohet vendosmëria dhe vullneti i tyre dhe të fillojnë të shpëtojnë vetveten.

Ai që është në gjendje të shpëtojë njerëzimin, është ai që ka shpirtin e flijimit dhe të vetësakrifikimit, në mënyrë që të mund të tejkalojë dëshirat, të shkëputet nga ëndrrat, egoizmi, lakmia, pasioni, smira, koprracia dhe të gjithë zinxhirët që zakonisht e mbërthejnë njeriun. Vetëm kështu ai mund të ndezë qiriun që ndriçon rrugën e çlirimit përpara njerëzimit.

Dielli i përjetshëm i Ashures¹⁹

Pavarësisht se sa shumë është folur rreth përfitimeve të mëdha të muajit Muharrem dhe ditës së Ashures, dhe rreth ndikimeve të kësaj ngjarjeje madhështore, sa më shumë kalon koha, aq më qartë dhe më fort shfaqet imazhi i përjetshëm i këtij dielli ndriçues, të cilin mund ta quajmë dielli i martirizimit, dielli i shtypjes dhe vetmia e luftës së shenjtë, që u ndez nga duart e Hysenit, i biri i Aliut dhe shokëve të tij.

Bekimet e Ashures u bënë më të qarta dita-ditës. Që nga dita e parë e ndodhisë së saj, ndikimet e thella dhe thelbësore të kësaj ngjarjeje filluan të shfaqen gradualisht. Që në ato ditë, disa njerëz e kuptuan detyrën e tyre, kështu lindi lëvizja e të penduarve (*hareketu et teuaabijn*) dhe ndodhën përballje të shumta dhe të gjata nga ana e Beni Hashimit dhe Beni Hasanit. Madje edhe revolucioni i abasitëve, të cilët u ngritën kundër Beni Umejes, në mes të shekullit të dytë hixhri dhe dërguan thirrës në skajet e botës islame të asaj kohe, veçanërisht në rajonet lindore të Persisë, si Horasani, krijuan terrenin për të rrëzuar shtetin shtypës, mendjemadh dhe racist të umajadëve. Kjo lëvizje nisi në emër të Hysenit, birit të Aliut.

Nëse studioni historinë, do të shihni se thirrësit e Beni Abasit, kur përhapeshin nëpër tokat islame, e merrnin gjakun e Hysenit dhe dëshmimin e tij, si dhe thirrjen për hakmarrje për

¹⁹ Takimi i udhëheqësit të Revolucionit Islam me dijetarët, studentët e hauzeve fetare, predikuesit dhe hoxhallarët, në prag të muajit të shenjtë Muharrem, 1416 hixhri.

nipin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe birit të Zehrasë, si material kryesor për revolucionin, me shpresën se do të kenë sukses në fushatat e tyre propagandistike.

Njerëzit u përgjigjeshin atyre, deri aty sa visheshin e të zeza, si shenjë zie, që Beni Abasitët e morën si simbol të tyre gjatë pesëqind viteve të sundimit të tyre. Ngjyra e zezë ishte zgjedhur si veshje zie për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*). Ata thoshin: “Kjo është zi për familjen e Muhamedit”.

Kështu e nisën Abasitët revolucionin e tyre dhe sollën këtë ndryshim, megjithëse, më pas edhe ata u larguan dhe ndoqën të njëjtën rrugë si Beni Umeja.

Pra, këto janë prej ndikimeve të Ashures dhe kështu ka qenë çështja nëpër rrjedhën e kohëve.

Ajo që ndodhi në kohën tonë, domethënë në kohën e mbizotërimit të padrejtësisë, mohimit dhe ateizmit mbi të gjithë botën, në një epokë ku drejtësia është kthyer në shkelje të ligjit, ndërsa padrejtësia është bërë ligji mbizotërues në nivel botëror, është më madhështore se ato ngjarje të kaluara.

Imami frymëzohet nga Ashurja

Ajo që shihni sot, arroganca e fuqive të mëdha dhe përpjekjet e tyre për të vendosur një rend të ri botëror, që mbizotëron mbi botën, është vetë padrejtësia. Ata e quajnë padrejtësinë, shtypjen dhe diskriminimin racor që ndodh në botë, me emra ligjorë si “mbrojtja e të drejtave të njeriut”. Ky është lloji më i keq i padrejtësisë, kur padrejtësia mbretëron në botë në emër të drejtësisë dhe shtypja bëhet me maskën e barazisë.

Në një kohë të tillë, perdet e errësirës u çanë, dielli i të vërtetës u shfaq dhe e drejta arriti në pushtet. Islami, i cili më parë ishte përpjekur të largohej nga skena nga të gjitha anët, u shpall i gjallë dhe i detyroi të gjithë ta pranojnë praninë e tij si një sistem qeverisës. E gjitha kjo ishte nga bekimet e Ashures, ashtu si edhe revolucioni nisi me bekimin e Ashures.

Imami ynë i madh, Imam Khomeini, i frymëzuar nga muaji Muharrem dhe nga ngjarja e Ashures, arriti ta transmetojë thirrjen e të vërtetës nga zemra e tij në veshët e umetit dhe ta ndryshojë atë. Dëshmorët tanë, në ato ditë, në Teheran, Varamin dhe qytete të tjera, ishin pjesëmarrës në ritet e zisë për Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe në ngjarjen e 15 qershorit 1963 (khordad), të parët që ranë dëshmorë, ishin ata që u sulmuan nga armiqtë e Ashures.

Në vitin 1357 hixhri (1979 diellor), ju e patë se si imami ynë i madh mori mësim nga Muharremi dhe krijoi konceptin e fitores së gjakut ndaj shpatës dhe e realizoi atë. Populli iranian, duke

ndjekur Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), u frymëzua nga mësimet e Ashures dhe gjaku i triumfoi ndaj shpatës.

Ne jemi ruajtësit e amanetit të Ashures

Sot, ne jemi trashëgimtarët dhe ruajtësit e kësaj të vërtete historike. Ata që sot duan të dëgjojnë se çfarë ndodhi në ditën e dhjetë të Muharremit dhe ta marrin atë si mësim dhe kujtesë, dëshirojnë ta dëgjojnë nga goja e dijetarëve, predikuesve dhe predikuesve femra.

Këtu paraqitet çështja e thirrjes dhe e predikimit, një çështje shumë e rëndësishme. Nëse studentët e rinj dhe të ditur të hauzeve fetare, predikuesit, hoxhallarët dhe vajtuesit e zisë arrijnë ta përdorin ngjarjen e Ashures si një shpatë për të përballuar errësirën që e ka mbërthyer jetën e njerëzve, të çajnë perdet e errësirës me këtë shpatë të bekuar shkatërruese dhe të shfaqin diellin e së vërtetës përmes sundimit të Islamit, kjo e vërtetë tashmë është shfaqur në kohën tonë. Kjo mrekulli është parë, atëherë pse të mos pritet që dijetarët e fesë, predikuesit dhe hoxhallarët, në çdo kohë, ta ngrenë shpatën e së vërtetës, Zulfikarin, përballë çdo të pavërtete? Pse ta përjashtojmë këtë mundësi, edhe nëse në atë periudhë mediet e armikut janë më të fuqishme dhe errësira më e dendur?

Është e vërtetë se propaganda armiqësore në kohën tonë ka bllokuar hapësirën mendore të njerëzve. Janë shpenzuar pasuri të mëdha për të njolllosur imazhin e Islamit, veçanërisht të Shi'izmit. Çdo person me interesa të padrejta në jetën e popujve dhe

vendeve, e ndien veten të detyruar të luftojë kundër Islamit dhe qeverisjes islame.

Mosbesimi, ndonëse i përçarë dhe i shpërndarë, është i bashkuar në një pikë: kundërshtimin e Islamit të pastër. Madje, ata kanë përdorur “Islamin falco për të luftuar Islamin e vërtetë. E gjithë kjo është e vërtetë. Por, a nuk është e mundur që, me gjithë këtë propagandë të keqe armiqësore, fronti i të vërtetës dhe i Islamit të pastër ta përsërisë këtë mrekulli, me bekimin e shpirtit, thirrjes dhe të vërtetës së Ashures dhe mesazhit të Muharremi?

Po, është një punë e vështirë, por është e mundur. Kjo është përgjegjësia jonë.

Bota sot është e etur për të vërtetën. Kjo nuk është fjala e një dijetari fetar apo e një myslimani fanatik, por është fjalë e atyre që kanë qenë për vite të tëra të lidhur me kulturën perëndimore dhe e kanë parë atë me sy pozitiv. Ata thonë: “Shtresat e rëndësishme të botës perëndimore janë të etura për Islamin”.

Problemet e qytetërimit perëndimor bashkëkohor

Me “shtresat e rëndësishme” nënkuptohen: dijetarët, mendimtarët, njerëzit me ndërgjegje, intelektualët dhe të rinjtë. Këta janë nyjat më të ndjeshme në strukturën e shoqërive perëndimore. Ata janë të etur për një shkollë ose një mësim jete, që mund t'i shpëtojë nga mijëra probleme të vërteta dhe reale. Shumë nga problemet e jetës nuk janë reale. Problemi i vërtetë

është mungesa e sigurisë shpirtërore, ndjenja e vetmisë, depresioni, shqetësimi, mungesa e qetësisë dhe e paqes së brendshme. Këto janë problemet e vërteta të njerëzimit, të cilat e çojnë një njeri, edhe pse ndodhet në majat e pasurisë dhe famës, drejt vetëvrasjes.

Pse vetëvritet një i ri i pasur, që ka mundësi të kënaqet me të gjitha kënaqësitë e jetës? Cila është dhimbja më e madhe, mungesa e pasurisë dhe pamundësia për të përjetuar kënaqësitë fizike dhe seksuale apo mungesa e qetësisë dhe e sigurisë shpirtërore, mungesa e një qendre, ku të mbështetesh shpirtërisht, mungesa e dashurisë dhe e komunikimit mes njerëzve, ndjenja e vetmisë dhe e thyerjes së brendshme?

Këto janë dhembjet që i përjeton qytetërimi perëndimor bashkëkohor dhe shtresat e ndjeshme të këtyre shoqërive i ndiejnë më shumë se të tjerët. Prandaj, ata janë në pritje të një dore, që do t'i shpëtojë nga këto vuajtje.

Në çdo vend ku ekziston vetëdija, shikimet kthehen nga Islami. Edhe pse ka ende nga ata që nuk kanë vetëdije dhe nuk e njohin Islamin, terreni është i përgatitur për pranimin e tij. Ndërsa ata që e kanë njohur Islamin, nuk i drejtohen askujt tjetër përveç tij.

Një prej mendimtarëve iraniane, i cili kohët e fundit u nda nga kjo botë, kishte thënë: *“Perëndimi sot është në kërkim të personaliteteve, si Shejkh Ensari dhe Mulla Sadra”*. Arsyeja është, sepse jeta, shpirtërorja dhe vlerat e tyre kanë tërhequr mendimtarët dhe figurat e shquara në Perëndim.

Njohja e Ashures, maja e njohurive islame

Burimi i pasur i këtyre vlerave ka qenë këtu dhe kulmi i këtyre njohurive është njohja e Ashures. Duhet ta njohim vlerën e kësaj çështjeje, sepse duam t'ia ofrojmë këto njohuri botës. Në këtë rast, nuk mund të mos falënderoj të gjithë ata që iu përgjigjën thirrjes sonë vitin e kaluar dhe pastruan ceremonitë e Ashures nga shtrembërimet.

Përbalja me shtrembërimet e Ashures

Edhe një herë tjetër, e theksoj këtë çështje, o të dashur, o besimtarë të Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*): Hyseni mund ta shpëtojë botën edhe sot, me kusht që imazhi i tij të mos shtrembërohet. Mos lejoni që konceptet e gabuara dhe shtrembërimet t'i largojnë sytë dhe zemrat nga fytyra e Pishtarit të dëshmorëve. Duhet të përballemi me shtrembërimet.

Ndjekja e çështjes së Ashures dhe e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) të bëhet nëpërmjet minberëve dhe elegjive në mënyrën tradicionale, duke rrëfyer ngjarjet e natës dhe ditës së Ashures. Zakonisht, ngjarjet, edhe ato më të mëdha, humbin me kalimin e kohës, por ngjarja e Ashures ka mbetur e gjallë, me të gjitha detajet e saj, për shkak të këtyre mbledhjeve (të zisë). Sigurisht, duhet që ngjarjet të tregohen saktësisht, sipas asaj që është përmendur në librin “Luhuf” i Ibn Tauusit dhe në librin “Irshad” i Shejkh Mufidit.

Shpjegimi i qëllimeve të Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të!)

Duhet të rrëfihen ngjarjet, të lexohen elegjitë dhe lavdërimet, të rrihet gjoksi dhe të shpjegohet ngjarja e Ashures dhe qëllimet e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) përmes ligjëratave të pasura, duke u ndalur te fjalët që ai ka thënë, si për shembull: *“Nuk dola as nga mendjemadhësia, as për luks, as për padrejtësi apo prishje, por dola për të bërë reformë në umetin e gjyshit tim”*.

Ose thënien tjetër të tij: *“O njerëz! I Dërguari i Allahut ka thënë: ‘Kushdo që sheh një sundimtar tiran, që e bën të lejueshme atë që Allahu e ka ndaluar dhe e thyen besën ndaj Tij e nuk e kundërshton me fjalë apo vepër, Allahu, me të drejtë, do ta fusë atë në të njëjtin vend me atë (tiranin)’*”.

Kjo është një pjesë nga mësimet e tij.

Ose fjala tjetër e tij: *“Kush është i gatshëm të japë shpirtin për ne dhe e ka përgatitur veten për të takuar Allahun, le të nisët me ne”*.

Këtu flitet për takimin me Allahun, që është qëllimi i krijimit të njeriut, sipas fjalës së Allahut: **“O njeri, ti me përpjekje të madhe je drejt Zotit tënd dhe do ta takosh Atë”**.²⁰

Pra, të gjitha këto përpjekje dhe vështirësi janë për këtë qëllim: *“Do ta takosh Atë”*.

²⁰ Sure “El Inshikak”, ajeti 6.

Kush e ka përgatitur veten për këtë takim me Allahun, le të niset me Hysenin. Nuk lejohet të qëndrojë në shtëpi, i lidhur me dynjanë dhe i hutuar nga rruga e Hysenit.

Duhet të veprojmë! Kjo fillon nga vetvetja, me pastrimin dhe edukimin e shpirtit, pastaj me lëvizjen drejt shoqërisë dhe botës. Këto janë qëllimet dhe përmbledhja e Revolucionit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

A e patë se çfarë bëri një njeri i brumosur me idetë e Hysenit dhe të Qerbelasë?

Përmbledhja e revolucionit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) qëndron në faktin se erdhi një ditë, kur bota ishte nën kontrollin e padrejtësisë dhe tiranisë. Askush nuk kishte guxim të tregonte të vërtetën, errësira kishte mbuluar gjithçka: qiellin, tokën dhe kohën. Madje edhe figura të mëdha, si: Ibn Abasi dhe Abdullah ibn Xha'ferri nuk udhëtuan me Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*). Çfarë do të thotë kjo? A nuk tregon kjo gjendjen e mjerë të botës në atë kohë?

Në ato kushte, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) qëndroi i vetëm përballë tiranisë, me një numër të vogël ndjekësish. Edhe nëse nuk do të ishte ai numër i vogël me të, nëse, për shembull, natën e dhjetë Muharrem, ai do t'u thoshte shokëve të tij: "Nuk keni më detyrim ndaj meje", dhe të gjithë do të largoheshin, përfshirë Abul Fadl Abasin dhe Aliun e madh, duke e lënë Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) vetëm, çfarë do të ndodhte në ditën e dhjetë? A do të tërhiqej Imami apo do të qëndronte të luftonte?

Në kohën tonë u shfaq një njeri, që tha: “Edhe nëse mbetem i vetëm dhe e gjithë bota ngrihet kundër meje, nuk do të tërhiqem nga rruga ime”. Ai ishte imami ynë, Imam Khomeini, i cili veproi dhe vërtetoi atë që tha, duke u bërë shembull i atyre që e mbajnë besën që i dhanë Allahut.

A e patë çfarë mund të bëjë një njeri që është rritur në shkollën e Hysenit dhe të Ashures? Sikur të ishim të gjithë ne prej atyre që janë edukuar në shkollën e Ashures, bota do të përparonte shumë më shpejt dhe toka do të përgatitej për shfaqjen e Imam Mehdiut, mbrojtësi i të drejtës.

Prandaj, duhet t’i paraqesim këto koncepte dhe mesazhe për umetin përmes mbledhjeve të predikimit, elegjive dhe lavdërimeve. Detyra e predikuesve është të shpjegojnë qëllimin e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) për njerëzit, në fshatra, qytete dhe në çdo cep të botës, nga minberët dhe platformat e ligjëratave, duke përdorur të gjitha format e komunikimit.

Ndoshta oratori sjell një hadith moral ose flet për politikën e brendshme apo atë ndërkombëtare, ky është në rregull, por është e domosdoshme që fjalimi i tij të përfshijë ngjarjen e Ashures, qoftë drejtpërdrejt, qoftë në mënyrë të tërthortë, në mënyrë të ndarë apo të përfshirë, që ngjarja e Ashures të mos mbetet e fshehur dhe e harruar.

Shpalosja e të vërtetave të Islamit gjatë muajit Muharrem

Pika e dytë: është shfrytëzimi i kësaj mundësie për të vepruar, ashtu siç veproi Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), domethënë ringjalljen e Islamit me bekimin e xhihadit të tij. Islami rifitoi jetën dhe lirinë e tij falë revolucionit dhe gjakut të Hysenit, i biri i Aliut.

Sot, duke u frymëzuar nga përkujtimi i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), nga emri dhe minberi i tij, është përgjegjësia juaj të shpalosni të vërtetat e Islamit, ta paraqitni Kur'anin dhe Sunetin, të sqaroni për njerëzit veprën “Nehxhul Belaga” (Predikimet dhe thëniet e Imam Aliut), sepse midis të vërtetave islame ekziston një e vërtetë e bekuar, që është bërë realitet në Iranin Islamik, ajo është sistemi i Republikës Islamike, një sistem profetik, alevian, i bazuar në udhëheqjen hyjnore.

Qeverisja me të drejtën është ndër njohuritë më të larta islame. Askush të mos mendojë se është e mundur të shpalosësh të vërtetat e Islamit, duke anashkaluar qeverisjen islame, e cila sot është mishëruar në këtë vend.

Flijimi për ruajtjen e fesë²¹

Drita e ndërgjegjësimit është thelbësore në mbrojtjen e fesë

Ashurja na mëson shumë mësimë. Një ndër mësimet më thelbësore të saj është domosdoshmëria për ta ruajtur fenë. Duhet të sakrifikojmë gjithçka për hir të Kur'anit. Të gjithë duhet të qëndrojnë të bashkuar: të vegjël e të mëdhenj, burra e gra, të moshuar e të rinj, të thjeshtë e të nderuar, udhëheqës dhe popull, në një front të vetëm përballë përplasjes së të drejtës me të padrejtën.

Fronti i padrejtësisë, pavarësisht forcës së tij të dukshme, është, në të vërtetë, shumë i dobët, siç ishte rasti me frontin e Beni Umejes, që u shemb nga karvani i robërve të Qerbelasë, qoftë në Kufe, në Sham apo në Medine, derisa përfundoi me shkatërrimin e regjimit të Ebu Sufjanit.

Mësimi që duhet nxjerrë nga kjo, është: qartësia dhe ndërgjegjësimi (el basiratu) janë më të rëndësishmet për njeriun gjatë mbrojtjes së fesë. Ata që nuk e zotërojnë këtë qartësi, shumë shpejt mashtrohen dhe kalojnë pa vetëdije në anën e të padrejtëve. Në ushtrinë e Ibn Zijadit kishte njerëz që nuk ishin as mëkatarë të mëdhenj e as të korruptuar, por thjesht ishin të paqartë, pa dritë të brendshme.

²¹ Nga takimi i udhëheqësit të Revolucionit Islamik me komandantët dhe grupet e Ashures, të Forcave të Rezistencës Basixh, më 02.04.1371 hixhri (përafërsisht 23 qershor 1992).

Këto janë mësimet e Ashures, mjaftueshëm të fuqishme për ta ngritur një komb të tërë nga poshtërimi në krenari, për të mundur frontin e mosbesimit dhe të arrogancës. Janë mësimet që japin jetë.

Qëndrueshmëria e Hysenit dhe qëndrueshmëria e Khomeinit²²

Ekzistojnë dy lloje të fitores: një fitore që njeriu e sheh me sytë e vet, siç është themelimi i një qeverie dhe shkatërrimi i armiqve të revolucionit, gjë që Imami e pa me sytë e tij; tjetra, më e rëndësishmja, është fitorja e përjetësisë, domethënë fitorja në fushën e mendimit dhe rrugës që propozohet. Kjo është fitorja që profetët e arritën, pavarësisht nga hidhërimet që përjetuan gjatë jetës së tyre. Kjo është një fitore mendore dhe metodologjike, që e arrin një njeri i madh dhe mendimtar. Edhe Imam Khomeini e arriti këtë fitore. Rikujtimi i këtij njeriu të madh përmes këtij tubimi vjetor çdo vit, ndodh pikërisht në këtë kuadër.

Ngjashmëritë midis lëvizjes së Imam Khomeinit dhe lëvizjes së Imam Hysenit

Dua të trajtoj këtu një çështje në lidhje me lëvizjen e Imam Khomeinit të madh, e cila mbart në vete një mësim për ne. U bëj

²² "Sahijfet Xhumhuri Islami", 16.3.1375 hixhri. Sipas kalendarit diellor, përkon më 6 qershor 1996.

thirrje njerëzve të mendimit, atyre me ndjeshmëri politike dhe atyre që thellohen në çështje të mëdha, që ta shikojnë me kujdes këtë çështje dhe të thellohen më shumë në të. Ju e dini se ka shumë ngjashmëri mes lëvizjes së Imamit dhe asaj të Imam Hysenit. Madje, lëvizja e Khomeinit lindi duke ndjekur lëvizjen e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Edhe pse ajo lëvizje, që është themeli, domethënë lëvizja e Hysenit, përfundoi me martirizimin e të gjithë pjesëtarëve të saj dhe kjo lëvizje përfundoi me fitoren e Imam Khomeinit, kjo nuk përbën një dallim thelbësor, sepse, të dyja lëvizjet përfaqësohen nga një imazh i përbashkët i veprimit, një përmbajtje e njëjtë dhe një plan i përgjithshëm i përbashkët. Dallimi ishte rrethanat kur ndodhën ngjarjet. Për këtë arsye, lëvizja e parë përfundoi me martirizimin e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ndërsa kjo e fundit, përfundoi me themelimin e qeverisë nga ana e Imam Khomeinit të madh. Kjo është një çështje e qartë dhe e dukshme në mënyrë të përgjithshme.

Qëndrueshmëria përballë vështirësive

Një nga çështjet më të dukshme, në të dyja lëvizjet (atë të Imam Hysenit dhe atë të Imam Khomeinit) është çështja e qëndresës së palëkundur (istikameti). Nuk duhet të kalojmë lehtë mbi fjalën “qëndresë” dhe të sillemi me të si diçka të zakonshme, sepse ajo ka rëndësi të madhe. Qëndrueshmëria e palëkundur e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte e tillë, që ai vendosi të mos i nënshtrohej Jezidit dhe qeverisjes së tij tiranike. Pikërisht këtu filloi përplasja, ai refuzoi të nënshtrohej përballë një pushteti të korruptuar që kishte devijuar fenë nga rruga e saj në mënyrë të plotë.

Kur Imami u nis nga Medina, ai e kishte këtë qëllim me vete. Kur ndjeu në Mekë se kishte përkrahës, e bashkoi lëvizjen e tij me revolucionin. Por në thelb, çështja ishte kundërshtimi ndaj një qeverisjeje të padurueshme, një pushtet që ishte i papranueshëm në vlerësimin e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në fillim, Imami qëndroi përballë kësaj qeverie, ndërkohë që gjërat ishin ende të paqarta dhe ai nuk e kishte shprehur haptazi kundërshtimin e tij. Por më pas, ai përballej me një sërë vështirësish të njëpasnjëshme, që nga detyrimi për të lënë Mekën, deri te lufta në Qerbela dhe presionet që iu ushtruan atij në ngjarjen e Qerbelasë.

Justifikimet e ligjshme e pengojnë njeriun

Një nga gjërat që e ndalojnë njeriun të ndërmarrë vepra madhështore, janë justifikimet e ligjshme. Mund të ndodhë që dikush të ketë një detyrë për të përmbushur, por në momentin e zbatimit të saj, haset në një pengesë të rëndësishme, si për shembull vrasja e një grupi të madh njerëzish dhe atëherë njeriu mendon se nuk ka më përgjegjësi mbi supet e tij.

Vini re: Sa shumë nga këto justifikime të dukshme dhe të ligjshme u shfaqën njëra pas tjetrës përpara Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), që do të kishin mjaftuar për ta larguar nga kjo rrugë çdo njeri me shikim sipërfaqësor. Një prej tyre ishte braktisja e Muslimit, nga banorët e Kufes dhe vrasja e tij. Në këtë pikë, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) mund të kishte thënë se justifikimi tashmë ekziston dhe se detyrimi është hequr nga supet e tij. Ai

mund të thoshte: “Ne dëshiruar të mos ia japim besën Jezidit, por tani është e qartë se, në këto rrethana, një veprim i tillë është jashtëzakonisht i vështirë. Njerëzit nuk e kanë fuqinë për ta përballuar atë, pra, jemi të detyruar të bëjmë besatim dhe detyrimi bie”.

Hapi tjetër ishte vetë ngjarja e Qerbelasë. Ai mund të paraqitej si një njeri që përballlet me vështirësi të mëdha dhe mundohet t’i zgjidhë ato me logjikë, duke thënë: “Këto gra dhe fëmijë nuk mund ta përballojnë këtë shkretëtirë të përvëlur nga dielli, pra detyrimi është hequr dhe është e natyrshme që të dorëzohem dhe të pranoj atë që më parë e kam refuzuar”.

Ose më vonë, në ditën e Ashures, kur filloi beteja dhe shumë prej shokëve të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) u vranë, dhe vështirësitë u bënë edhe më të mëdha, ai mund të kishte thënë: “Tani është e qartë, është e pamundur të luftojmë më tej, duhet të tërhiqemi”.

Ose kur u bë e qartë se ai, me siguri, do të bëhej shehid dhe familja e Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe të afërmit e tij do të bëheshin robër në duart e armiqve, në atë shkretëtirë. Këtu hyn çështja e nderit. Në atë moment, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), si një njeri me dinjitet dhe ndjenjë nderi, mund të kishte thënë: “Detyrimi është hequr, pse të vazhdojmë në këtë rrugë dhe të vritemi, do të thotë që bijat e Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe të Imam Aliut, gratë më të pastra të Islamit, të përfundojnë si robëresha në duart e armiqve që nuk dinë ç’është nderi”.

Vëllezër dhe motra, mendoni mirë! Kjo është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme, që meriton përqendrim në ngjarjen e dhimbshme dhe të madhe të Qerbelasë. Nëse Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) do t'i kishte parë këto ngjarje të dhimbshme, si vdekja e grave nga etja, fëmijët, vrasja e të rinjve të tij, përfshirë edhe Aliun e vogël, dhe robërimin e grave, vetëm nga një këndvështrim juridik, e do ta kishte harruar madhështinë e misionit të tij, ai mund të ishte tërhequr pak e nga pak, që në fillim dhe t'ia jepte besën Jezidit, duke thënë se “nevoja e lejon të ndaluarën përkohësisht”. Por ai nuk e bëri këtë. Kjo është qëndrueshmëria hyseniane.

Qëndrueshmëria përballë justifikimeve të ligjshme

Qëndrueshmëri (istikamet) nuk do të thotë gjithmonë vetëm të përballosh vështirësi, sepse kjo, për një njeri të madh, është shumë më e lehtë se sa ato çështje që mund të duken si të kundërta me interesin, sipas kritereve fetare, zakonore apo mendimit të thjeshtë njerëzor.

Ndoshta dikujt i thuhet: “Mos e ndiq këtë rrugë, sepse mund të torturohesh, ose të vritesh; apo disa njerëz mund të vriten për shkakun tënd; ose burra, gra e fëmijë mund të pësojnë dëme, për shkak të vazhdimit tënd në këtë rrugë”. Në raste të tilla, njeriu, në të ardhmen, mund të shmangë vdekjen ose pasoja të tjera të rënda. Por, në këtë rast të fundit, edhe ata që nuk i tremben vdekjes, mund të rrëshqasin nga rruga e drejtë. Mirëpo, ai që nuk rrëshqet, është ai që zotëron:

1- Bashkë me ndërgjegjësimin, edhe kuptimin e madhështisë së veprës që po kryen.

2- Shpirt të fortë, të palëkundur.

Këto dy cilësi i shfaqti Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) në Qerbela. Dhe kështu Qerbelaja ndriçoi si dielli gjatë gjithë historisë, nuk ka pushuar së ndrituri dhe do të vazhdojë të ndriçojë deri në përjetësi.

Imam Khomeini e vazhdoi rrugën e Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të!)

Imami ynë i madh u dallua në dy aspekte: **Së pari**, sepse ndoqi gjurmët e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe kështu i udhëhoqi drejt fitores udhëheqësit e revolucionit.

Së dyti, ai e siguroi fitoren, edhe pas largimit të tij nga kjo botë. Dëshmi e kësaj fitoreje të mendimit dhe rrugës së tij është ky tubim i madh juaji dhe akoma më i gjerë në shkallë botërore është orientimi i popujve drejt Islamit dhe vijës së Imam Khomeinit. Këto fitore janë rezultat i qëndresës së tij.

Një ditë i thanë Imam Khomeinit: “Nëse vazhdon këtë lëvizje, mund të mbyllet hauzeja (shkolla) fetare në Kum”. Por ai nuk u trondit, përkundrazi vazhdoi rrugën.

I ishte thënë, gjithashtu, se do të nxiteshin dijetarët e mëdhenj dhe autoritetet fetare kundër tij, do të kishte përçarje në botën islame. Edhe nëse shumë të tjerë do të ishin trembur, Imami nuk u lëkund dhe vazhdoi lëvizjen derisa revolucioni arriti fitoren.

I ishte thënë shpesh: “Nëse nxit popullin iranian për t’u përballur me regjimin Pahlavi, kush do të mbajë përgjegjësi për gjakun që do të derdhet?” Kishte nga ata që i paraqisnin si argument gjakun e të rinjve. Një dijetar i madh më kishte thënë në vitin 1342 ose 1344 sipas kalendarit iranian, se, kur Imami nisi lëvizjen e tij më 15 Khordad 1342 dhe shumë të rinj, më të mirët tanë, u vranë, atëherë kush mban përgjegjësi për ata dëshmorë?

Kjo mënyrë të menduari krijonte presion dhe mund të bënte çdo njeri të tërhiqej nga rruga e tij. Por Imam Khomeini ishte i palëkundur ndaj bindjes dhe idesë së tij. Këtu shfaqet madhështia e shpirtit dhe e vizionit të qartë që kishte ai.

Kjo kishte të bënte me fazën e luftës kundër regjimit monarkik tiranik. Por ajo që përbën mësim për ne sot dhe të gjithë duhet ta mendojmë thellë, është ajo që ndodhi pas kësaj. Për këtë arsye i kam ftuar mendimtarët, politikanët dhe analistët që të përqendrohen te kjo çështje, sepse ajo është jashtëzakonisht e rëndësishme.

Lufta në atë kohë ishte e përqendruar kundër regjimit monarkik. Por, sapo u themelua Republika Islamike, fusha e betejës u zgjerua dhe forma e luftës ndryshoi, pasi armiqtë e vërtetë, fuqitë imperialiste dhe tiranët e pafytyrë që shtypin popujt, filluan luftën kundër Republikës Islamike.

Këta armiq, të përfaqësuar nga arroganca globale dhe sunduesit botërorë, e kanë këtë armiqësi, sepse interesat dhe planet e tyre zgjeruese rrezikohen, sepse prania shpirtërore dhe ideologjike e Republikës Islamike, në mesin e vendeve islame, kanos mbijetesën e tyre dhe vazhdimin e sundimit mbi ato vende.

Në çdo rast, nëse në vend të Imam Khomeinit do të ishte një njeri i dobët, ai do të ishte ndalur nga rruga e tij, për shkak të justifikimeve dhe pengesave, dhe do të tërhiqej duke thënë se nuk është më e mundur të përballesh me arrogancën botërore. Por Imam Khomeini nuk e bëri këtë.

Qëndrueshmëria e Imam Khomeinit përballë sulmeve të armiqve

Që të kuptohet rëndësia e kësaj çështjeje, vëzhgoni me kujdes këto fjali: Irani u përball me një sulm politik të gjithanshëm në faza të ndryshme nga ana e mjeteve të komunikimit. Shpeshherë, sulmet politike janë shumë ndikuese. Këtë e shohim edhe sot, kur televizioni dhe radiot janë në gjendje të trembin qeveri, sepse ndikojnë në mendimet e popujve.

Ata e nisën një sulm të tillë të gjithanshëm kundër sistemit të Republikës Islamike. Populli ynë, sigurisht, u dallua për qartësi mendimi dhe qëndrueshmëri dhe nuk u lëkund. Por Imami nuk u tërhoq me justifikimin se “këta janë bërë bashkë kundër nesh”. Ai nuk tha: “Nëse mund ta përballojmë vetëm Amerikën, si mund të fitojmë përballë Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik njëkohësisht?”,

sepse në atë kohë bota ishte me dy blloqe, dhe të dyja këto superfuqi u bashkuan kundër nesh.

Por ai qëndroi i patundur, nuk u largua nga parimet dhe rruga e tij, nuk e tha kurrë atë që armiqtë prisnin prej tij. Kjo është qëndrueshmëri si ajo e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe sipas standardeve të kohës sonë. Kjo qëndrueshmëri i përngjan qëndrimit të Imam Hysenit në Qerbela.

Vendi ynë trashëgoi një shkatërrim të madh nga regjimi tiranik monarkik dhe kishte nevojë për rindërtim. Por në kohën kur filloi lufta e imponuar, armiku na sulmoi befasisht, duke shkatërruar hekurudhat, rafineritë e naftës dhe ndaloi gjithë industrinë. Në një gjendje të tillë, kushdo mund të ishte rrëzuar dhe ishte dorëzuar.

Të gjithë e dinë se Iraku nuk ishte vetëm përballë nesh. Përveç tij, përballë kishim edhe amerikanët, Bashkimin Sovjetik, Francën, NATO-n, ekspertë të huaj dhe shumë të tjerë.

Po të ishte Imami Khomeini i dobët, do të kishte thënë: “Tani detyra fetare ka rënë, nuk mund të zbatojmë ligjet islame dhe duhet të heqim dorë nga përballja me Izraelin, sepse ata po ushtrojnë presion dhe e duan këtë”. Por, ai nuk e tha kurrë një gjë të tillë. Ai qëndroi i vendosur.

Edhe kur pranoi rezolutën për armëpushim, nuk ishte për shkak të presionit të armiqve, por për arsye ekonomike, të cilat ia paraqitën atij përgjegjësit e ekonomisë së vendit në atë kohë. Ata i treguan se vendi nuk kishte më mundësi ekonomike për të vazhduar luftën.

Vetëm atëherë, Imam Khomeini u detyrua të pranojë rezolutën ndërkombëtare. Por nuk e pranoi as nga frika, as nga kërcënimi i ndërhyrjes së Amerikës, sepse Amerika kishte ndërhyrë që në fillim të luftës. Edhe sikur e gjithë bota të ndërhynte në atë luftë, Imami nuk ishte njeriu që do të thyhej.

Armiku ushtronte presion për të lëkundur Imam Khomeinin

Asnjëherë nuk ndodhi që Imam Khomeini të dyshonte, qoftë edhe për një moment gjatë dhjetë viteve, pas fitores së Revolucionit Islam, për shkak të barrës së rëndë të përgjegjësisë apo kërcënimeve të armikut, në asnjë aspekt. Kjo do të thotë se ai kishte një shpirt si ai i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në luftë ka humbje dhe Imam Khomeini kishte shumë respekt për jetën e njerëzve, i donte ata shumë dhe ndiente dhimbje për ta. Ai qante ndonjëherë dhe sytë i mbusheshin me lot. Këtë e kemi parë shpesh. Ai ishte njeri i dhembshur, plot mëshirë, me një zemër të mbushur me dashuri dhe njerëzi. Por asnjëherë nuk u frikësua apo u lëkund përballë kërcënimeve dhe nuk devijoi nga rruga e tij.

Të gjithë armiqtë e Revolucionit e kuptuan gjatë këtyre dhjetë viteve se nuk ishte e mundur ta trembnin Imam Khomeinin dhe e provuan këtë. Ky është një bekim i madh, që armiku e ndiente të pamundur ta nxirrte këtë njeri nga fusha e betejës me frikësime e kërcënime. Imam Khomeini, me atë shpirt të lartë dhe personalitet të ndritur, e bëri tërë botën të kuptojë se nuk mund ta largonin këtë njeri as me presion, as me kërcënim e as me

zbatimin praktik të atyre kërcënimeve. Për këtë arsye, u detyruan të përshtaten me revolucionin.

Këtë mund ta përmbledhim në dy fjali, ndonëse kjo përmbledhje mund të zgjerohet dhe të analizohet më tej:

1- Një nga vijat e qarta të lëvizjes së Ashures është qëndrueshmëria e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

2- Imami ynë i madh, Imam Khomeini, e ndoqi në mënyrë të plotë metodën hyseniane në lëvizjen, revolucionin dhe jetën e tij. Prandaj arriti të mbrojë Republikën Islamike dhe ta detyrojë armikun të heqë dorë nga kërcënimet dhe presionet, sepse i tregoi qartë armikut se të gjitha ato metoda janë të kota dhe ky udhëheqës nuk është njeri që tërhiqet për shkak të tyre.

KAPITULLI I TRETË

MËSIMET E ASHURES

Umeti i Profetit Muhamed (a.s) vret djalin e Profetit të tij²³

Mësimet vlejné për epokën e sundimit islam

Ka tri boshte thelbësore që lidhen me analizën e ngjarjes së Ashures. Ato janë:

Së pari: Studimi i shkaqeve dhe motiveve që qëndrojnë pas kryengritjes së Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe arsyet që e shtynë atë ta ndër marrë këtë revolucion. Kjo nënkupton një analizë fetare, shkencore dhe politike të këtij revolucioni. Ne kemi folur më parë me detaje për këtë temë, përveç studimeve me vlerë që kanë bërë dijetarët dhe të mëdhenjtë. Prandaj, sot nuk do të ndalem në këtë aspekt.

Së dyti: Studimi i mësimave të nxjerra nga Ashurja. Ky është një studim i gjallë dhe i përrjetshëm, që nuk i përket një kohe të caktuar. Mësimi i Ashures është mësim i sakrificës, i fljimit, i besimit fetar, i trimërisë, i mbështetjes ndaj të tjerëve, kryengritjes për hir të Allahut, dashurisë dhe shkrirjes në dashurinë për Allahun. Kjo kryengritje e madhe që ndezët ju, bijtë e popullit iranian, duke u bashkuar rreth Hysenit të kohës suaj, Hysenit të vetmuar, përfaqëson një nga mësimet e Ashures. Nuk dëshiroj të ndalem në ndonjë diskutim tjetër për këtë temë.

²³ Fjala e udhëheqësit të Revolucionit Islamik, në namazin e xhumasë, më 18.2.1377 hixhri (8.05.1998).

Së treti: Mësimet e nxjerra nga Ashurja janë edhe mësimet për reflektim. Ne e kemi ngritur këtë çështje disa vite më parë, ku kemi treguar se në Ashurja, përveç mësimëve, ka edhe mësimet për reflektim (përvoja të vlefshme). Studimi i përvojave nga Ashurja i përket kohës në të cilën sundon Islami. Mund të themi se thelbi i këtij studimi ka të bëjë, të paktën, me këtë periudhë që po e jetojmë, kohën që po kalon vendi ynë. Prandaj, ne duhet të nxjerrim mësim.

E kemi shtjelluar këtë çështje në këtë mënyrë: Çfarë i ndodhi asaj shoqërie islame, asaj shoqërie që ishte bashkuar rreth Profetit Muhamed (Paqja e bekimi Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), që e kishte dashur me një dashuri të thellë dhe kishte besuar në të me një besim të palëkundur, saqë ishte bërë një shoqëri plot gjallëri dhe entuziazëm fetar? Një shoqëri që u formua dhe u zhvillua nën hijen e ligjeve islame, për të cilat do të flasim më vonë. Si ndodhi që ata, disa prej të cilëve e kishin arritur kohën e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), pas vetëm pesëdhjetë vjetësh u mblodhën për ta vrarë nipin e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), në mënyrën më të tmerrshme të mundshme? A ekziston ndonjë formë më e rëndë e devijimit, mbrapsjes dhe apostazisë sesa kjo?

Zejnebjja mbajti një fjalim elokuent dhe madhështor në tregun e Kufes. Ajo u përqendrua pikërisht në këtë pikë: *“O banorë të Kufes, o njerëz të mashtrimit dhe tradhtisë! A po qani?!”*

Ata, kur panë kokën e Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të!) të vendosur mbi një heshtë dhe vajzën e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), të robëruar, e

ndjenë thellë tragjedinë dhe shpërthyen në lot. Por ajo nuk i kurseu fjalët dhe u tha: *“Ju jeni si ajo gruaja që e thur leshin dhe, pasi e ka përfunduar, e shthur punën e saj. Ju i përdorni betimet tuaja si mashtrim mes jush”*.

Kuptimi i këtyre fjalëve është: Kjo është mbrapsje, apostazi dhe rënie prapa. Ju, në të vërtetë, jeni si ajo gruaja, që pasi ka thurur pëlhurën e saj, e shkatërron punën që ka bërë dhe kthehet sërish në pikën zero. Edhe ju, në realitet, keni shkatërruar punën tuaj dhe e keni kthyer atë në lesh të papërpunuar. Kjo është rënie. Ky është një mësim për reflektim, që çdo shoqëri islame mund të përballlet me një rrezik të tillë.

Merita më e madhe e Imam Khomeinit ishte se ai e nxiti umetin të veprojë sipas mësimave të larta të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). A është e mundur që ndonjë personalitet tjetër, që nuk është profet apo i pagabueshëm, të krahasohet me Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që ndërtoi atë shoqëri?

Megjithatë, ajo shoqëri përfundoi duke e kryer atë krim. A do të thotë kjo se çdo shoqëri islame është e rrezikuar të ketë në një përfundim të tillë?

Natyrisht, nëse ajo shoqëri nxjerr mësim nga e kaluara, nuk do të përfundojë ashtu. Por, nëse nuk merr mësim, atëherë është plotësisht e mundur që të zhytet në një degradim të tillë. Këto janë mësimet që nxirren nga Ashurja.

Sa për ne, në këtë epokë, falë Zotit dhe mirësisë së Tij, kemi arritur ta ndjekim sërish rrugën e drejtë, ta ringjallim emrin e

Islamit në botë dhe ta lartësojmë flamurin e Islamit dhe të Kur'anit. Ky nder i madh i takon popullit iranian. Edhe pse revolucionin ka rreth njëzet vjet që është kryer, ai ende qëndron i palëkundur në këtë rrugë. Por, nëse na kaplon pakujdesia, nuk jemi vigjilentë, nuk ruhem dhe nuk qëndrojmë të vendosur siç duhet, atëherë edhe ne mund të përfundojmë njësoj si ata. Këtu qëndron kuptimi i mësimin të Ashures.

Tani dëshiroj të flas më gjerësisht për këtë temë, të cilën e kam trajtuar edhe vite më parë. Falë Zotit, vërej që dijetarët dhe të mirët kanë ndihmuar shumë në studimin, kërkimin, shkrimin dhe mbajtjen e fjalimeve për këtë temë. Është e natyrshme që shpjegimi i hollësishëm i kësaj teme nuk mund të përfshihet brenda kohës së kufizuar të hytbes së namazit të xhumasë. Kjo është një temë e gjatë, të cilën do ta trajtoj në mënyrë të detajuar dhe për secilën periudhë në një kontekst të përshtatshëm, nëse Zoti ma mundëson dhe më jep suksesin për ta bërë këtë.

Madhështia e ngjarjes së Qerbelasë

Së pari, dhe mbi të gjitha, duhet të kuptojmë mirë, se sa e rëndë ka qenë ajo ngjarje, në mënyrë që të mund të veprojmë dhe të ndjekim shkaqet e saj. Askush nuk duhet ta kufizojë shikimin e tij duke menduar se ngjarja e Ashures ishte, në fund të fundit, një masakër, ku u vranë disa njerëz. Jo! Ajo, siç lexojmë në "Zijaratul Ashura", ka qenë "një fatkeqësi e madhe, e rëndë dhe e jashtëzakonshme".

Për ta kuptuar madhështinë e kësaj tragjedie, do të paraqes shkurtimisht tri faza të shkurtra nga jeta e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), që të shohim personalitetin e tij në këto tri etapa dhe të pyesim veten: A është e mundur të mendohet se ai do të përfundonte më 10 Muharrem i rrethuar nga turma të umetit të gjyshit të tij dhe të vritej në mënyrën më të tmerrshme, së bashku me shokët, familjarët dhe të robëroheshin gratë e tij?

Këto tri etapa përmbliidhen në:

Së pari: Faza e fëmijërisë, që nga fillimi i jetës së tij deri në vdekjen e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Së dyti: Faza e rinisë, që zgjati 25 vjet, nga vdekja e gjyshit të tij, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), deri në udhëheqjen e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Së treti: Faza që zgjati 20 vjet, nga koha pas martirizimit të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), deri në ngjarjen e Qerbelasë.

Imami Hyseni (Paqja qoftë mbi të!) në fëmijërinë e tij

Në fazën e parë, pra në kohën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Hyseni ishte një fëmijë i përkëdhelur dhe shumë i dashur për të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte vetëm një vajzë dhe të gjithë

muslimanët e asaj kohe e dinin se ai kishte thënë: “Unë zemërohem, kur zemërohet Fatimja dhe jam i kënaqur, kur ajo është e kënaqur”. Shikoni sa madhështore ishte pozita e kësaj vajze, saqë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e madhëroi me këtë fjalë dhe të ngjashme me të, përpara muslimanëve dhe në publik. Kjo nuk është një çështje e vogël.

Ndërsa burri i saj, personi më i nderuar i asaj kohe, ishte Aliu, i biri i Ebu Talibit, një i ri trim, fisnik dhe më i besuari ndër njerëz, i pari që pranoi Islamin dhe më i angazhuari në të gjitha fushat e tij. Ishte Aliu ai, me shpatën e të cilit u themelua Islami. Ai hidhte hap përpara, atje ku të tjerët hezitonin dhe zgjidhi nyjat më të ndërlikuara. Ky dhëndër i dashur e i nderuar nuk ishte i dashur vetëm për shkak të lidhjeve familjare, por për shkak të madhështisë së personalitetit të tij. Për këto arsye, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ia dha vajzën e tij për grua. Nga kjo martesë lindi Hyseni.

Hyseni ishte më i dashuri për të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ai që ishte udhëheqësi i botës islame, prijësi i muslimanëve dhe i dashuri i zemrave të të gjithëve, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e mbante Hysenin mbi supe dhe e merrte me vete në xhami. Muslimanët e dinin se ky fëmijë ishte i dashuri i zemrës së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për të cilin çdo zemër shkrihej nga dashuria.

Një herë, kur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) po mbante hytben nga minberi, këmbët e këtij fëmije u ngatërruan në një pengesë dhe ai ra.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) zbriti menjëherë nga minberi, e mori në krahë dhe e përkëdheli. Shikoni sa shumë e donte Hysenin i Dërguari i Allahut Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë për Hasanin dhe Hysenin, kur ishin rreth gjashtë apo shtatë vjeç: “*Hasani dhe Hyseni janë prijësit e të rinjve të banorëve Xhenetit*”. Ai e tha këtë fjalë për ta, ndërkohë që ata ishin ende fëmijë. Kjo do të thotë se, edhe pse të vegjël në moshë, ata kishin kuptim, ndërgjegjësim dhe njohuri si ata që janë në moshën e rinisë. Prej tyre buronte etika dhe nderi.

Sikur dikush të thoshte në atë kohë se ky fëmijë do të vritej më vonë nga dora e umetit të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pa asnjë faj apo krim, askush nuk do ta besonte. Ashtu siç e shpalli vetë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) këtë të vërtetë të hidhur dhe qau për të. Të gjithë u habitën në atë kohë dhe e mohuan mundësinë që një gjë e tillë të ndodhte.

Imami Hyseni (Paqja qoftë mbi të!) në ditët e rinisë së tij

Faza e dytë: është periudha që zgjati njëzet e pesë vjet, nga vdekja e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) deri në udhëheqjen e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Gjatë kësaj kohe, Hyseni ishte një i ri i gjallë, dijetar dhe trim. Ai mori pjesë në luftëra dhe përballoi vështirësitë më të mëdha. Ishte i njohur nga të gjithë për madhështinë e tij. Kur përmendeshin të ndershmit, sytë ktheheshin drejt tij, mendjet përqendroheshin tek ai dhe emri i tij shkëlqente në mesin e gjithë myslimanëve të Mekës, Medinës dhe kudo ku ishte përhapur Islami, si një shembull i virtyteve dhe meritave.

Të gjithë e shikonin atë dhe vëllain e tij, Hasanin, me respekt dhe nderim, madje edhe udhëheqësit e asaj kohe tregonin ndaj tyre madhështi dhe nderim ndaj tyre. Ai ishte model dhe shembull për të rinjtë e asaj kohe. Dhe, ashtu si më parë, sikur dikush të thoshte në atë kohë, se ky i ri do të vritej nga dora e këtij umeti (bashkësie), askush nuk do ta besonte.

Izolimi i Ehli Bejtit

Faza e tretë: është periudha që erdhi pas martirizimit të Prijësit të besimtarëve Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Këtu filloi koha e izolimit të Ehli Bejtit, familjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Gjatë kësaj kohe, Imamatin e morën Imam Hasani dhe Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi ta!*), të cilët banonin në Medinën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte një personalitet i dashur, një burrë fisnik, i lartë, me prejardhje të pastër dhe dijetar.

Ai ishte aq i ditur dhe i guximshëm, sa që në atë kohë i dërgoi një letër Muavijes (khalifit emevit), e cila, po të ishte shkruar nga dikush tjetër dhe t'i ishte dërguar ndonjë sundimtari, do të kishte sjellë ndëshkimin me vdekje. Por Muavija, kur e mori letrën e tij, e priti me respekt dhe e lexoi duke injoruar përmbajtjen e saj të rreptë.

Tani, po të thoshte dikush në atë kohë se ky burrë i ndershëm, i çmuar, fisnik dhe i lartë, i cili në sytë e njerëzve përfaqësonte vetë Islamin dhe Kur'anin, do të vritej së shpejti nga dora e këtij umeti të Islamit dhe Kur'anit, me një vrasje të tmerrshme, askush nuk do ta besonte. Por kjo ngjarje e çuditshme dhe e pabesueshme ndodhi realisht.

Po, kush ishin ata që e kryen këtë krim? Ishin pikërisht ata që shkonin tek ai, që e vizitonin, që i tregonin dashuri dhe besnikëri. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se shoqëria islame, gjatë këtyre pesëdhjetë viteve, ishte zbrazur nga vlerat e saj shpirtërore dhe ishte zhveshur nga realiteti i Islamit. Nga jashtë dukej si një shoqëri islame, por brenda ishte bosh. Këtu qëndron rreziku më i madh. Namazet vazhdonin të kryheshin, xhematet zhvilloheshin dhe umeti ende quhej "umeti mysliman", madje disa prej tyre edhe shprehnin dashuri për Ehli Bejtin.

Bota islame dhe dashuria për Ehli Bejtin (*Paqja qoftë mbi ta!*)

Ju siguroj se e gjithë bota islame, dikur dhe sot, beson në Ehli Bejtin, familjen e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe askush nuk dyshon në këtë. Dashuria për Ehli Bejtin është një dukuri e përbashkët mes të gjithë myslimanëve, si në të kaluarën, ashtu edhe në të tashmen. Kudo që të kthesh fytyrën sot në botën islame, do të gjesh myslimanë që e duan Ehli Bejtin.

Xhamia me emrin e Imam Hysenit dhe xhamia tjetër me emrin e Zejnebes së nderuar në Kajro, janë gjithmonë të mbushura me vizitorë. Myslimanët i vizitojnë këto vende, dhe i marrin si ndërmjetës për t'iu lutur Allahut.

Kohët e fundit, rreth një apo dy vite më parë, më erdhi një libër i ri. Edhe pse librat e vjetër janë të mbushur me dashurinë për Ehli Bejtin, unë po e përmend këtë rast për shkak të fakteve të tij. Ky libër është shkruar nga një autor bashkëkohor, nga Hixhazi (Arabia Saudite). Në të argumentohet se te Ehli Bejti futeshin: Muhamedi, Aliu, Fatimja, Hasani dhe Hyseni. Ky është një besim që për ne, shi'itët, është pjesë e shpirtit tonë. Autori i këtij libri nuk është shi'it, ai është një mysliman nga një rrymë tjetër, megjithatë ai e shkroi dhe botoi këtë libër. Libri ekziston dhe unë kam një kopje të tij. Me siguri mijëra kopje të tij janë shtypur dhe janë shpërndarë.

Kjo do të thotë se Ehli Bejti gëzon respekt dhe pranim te të gjithë myslimanët.

Edhe në atë kohë, familjarët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) gëzonin dashuri dhe nderim të madh, por, megjithatë, ndodhi ajo ngjarje e tmerrshme, vrasja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Ku qëndron mësimi në këtë? Mësimi që duhet të marrim, është se çfarë duhet të bëjmë që një shoqëri të mos rrëshqasë drejt një fundi të tillë. Për këtë arsye, është e domosdoshme që të kuptojmë rrethanat që e çuan atë shoqëri drejt asaj tragjedie. Ky është një diskutim i gjerë, por unë dua t'jua paraqes në mënyrë të përmbledhur.

Shtyllat themelore të strukturës së sistemit profetik

Së pari, si hyrje në këtë temë, duhet të theksohet se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndërtoi themelet e një sistemi të plotë, i cili bazohej mbi disa shtylla. Katër prej këtyre shtyllave përbënin shtyllat më të rëndësishme të kësaj strukture:

1- Njohuria e saktë dhe e qartë

Një njohje e thellë dhe e qartë për çështjet e fesë, për dispozitat, për shoqërinë, për përgjegjësinë (fetare), për njohjen e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, si dhe për natyrën. Kjo është ajo njohuri që, përmes mbledhjes së saj, solli zhvillimin e shkencave dhe e ngriti shoqërinë islame në kulmin e qytetërimit dhe të dijes në shekullin e katërt hixhri.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk la asnjë paqartësi ose dyshim. Kemi për këtë

shumë ajete të mahnitshme nga Kur'ani i shenjtë që nuk mund të përmenden të gjitha këtu. Sa herë që lindte ndonjë paqartësi ose keqkuptim, shpallej një ajet që e sqaronte atë.

2- Drejtësia absolute dhe e paanshme

Një drejtësi e plotë dhe e drejtë, pa favorizime, qoftë në fushën e gjykimit, qoftë në shpërndarjen e të drejtave të përgjithshme. Kur ishte fjala për të drejtën e tij personale, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shpesh falte, por, kur bëhej fjalë për të drejtat e shoqërisë, ai zbatonte drejtësinë në mënyrë të rreptë: në ndarjen e pasurisë, në zbatimin e ligjeve të Allahut, në caktimin e posteve dhe përgjegjësiave dhe në mbajtjen e barrës së përgjegjësisë.

Është e qartë se drejtësia nuk është njësoj me barazinë. Mos e ngatërroni këtë. Ndonjëherë barazia sjell padrejtësi, ndërsa drejtësia nënkupton të vendosësh çdo gjë në vendin e vet dhe t'i japësh secilit të drejtën që i takon. Në kohën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), drejtësia ishte drejtësi absolute, pa asnjë njollë. Askush nuk përjashtohej nga kjo drejtësi.

3- Adhurimi i pastër vetëm për Allahun

Adhurim i singertë, pa asnjë lloj shirku (idhujtarie), në jetën personale, në namaz, ku qëllimi duhet të jetë afrimi tek Allahu, në ndërtimin e shoqërisë, në sistemin qeverisës, në mënyrën e jetesës

dhe në marrëdhëniet shoqërore ndërmjet njerëzve. Kjo është një temë që meriton një shpjegim të gjerë dhe të veçantë.

4. Dashuria e thellë dhe ndjenja e fortë emocionale

Kjo është ndër veçoritë thelbësore të shoqërisë islame: dashuria për Allahun dhe dashuria e Allahut për njerëzit: **“Ai i do ata dhe ata e duan Atë”, “Allahu i do penduesit dhe të pastrit”, “Thuaj: ‘Nëse e doni Allahun, më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë’”**. Kjo dashuri përfshin, gjithashtu: dashurinë për bashkëshorten, dashurinë për fëmijët (është e pëlqyer t’i puthësh dhe t’i duash fëmijët), dashurinë për vëllezërit myslimanë dhe afrimin ndaj tyre me dashuri dhe mbi të gjitha: dashurinë për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për Ehli Bejtin e tij. Allahu ka thënë në Kur’an: **“Përveç dashurisë për të afërmit (Ehli Bejtin)”**.

Ndryshimi i shoqërisë paraislame (xhahilite)

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i përcaktoi këto parime të përgjithshme dhe e ndërtoi shoqërinë mbi këto shtylla themelore. Ai vendosi elementet kryesore të qeverisjes dhe për dhjetë vite punoi sipas këtij modeli. Është e qartë se edukimi i njerëzve ndodh në mënyrë graduale dhe nuk realizohet menjëherë.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i shpenzoi të gjitha përpjekjet e tij përgjatë këtyre dhjetë viteve, për të forcuar këto themele dhe për t'i mbjellë rrënjët e tyre thellë në tokë. Por, dhjetë vite janë shumë pak, nëse qëllimi është që njerëzit të edukohen ndryshe nga ajo me të cilën janë rritur dhe janë mësuar, me cilësitë dhe veset e tyre të trashëguara.

Shoqëria xhahilite (paraislame), në çdo aspekt të saj, ishte krejtësisht në kundërshtim me përmbajtjen e këtyre katër shtyllave, sepse ajo ishte bosh nga çdo lloj njohurie dhe e zhytur në errësirën e paditurisë dhe humbjes. Nuk kishte asnjë adhurim të Allahut, ishte një shoqëri tiranike dhe arrogante, shumë larg drejtësisë, e mbushur me padrejtësi dhe diskriminim.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) e përshkruan me mjeshtëri këtë realitet të errët në hytben e dytë në “Nehxhul Belaga”: “Në trazira, ata i shtypnin njerëzit në mënyrën më të fshehtë dhe i shkelmojnë me thonjtë e tyre”.

Shoqëria e asaj kohe ishte e zhveshur nga çdo ndjenjë dashurie. Ata i varrosnin vajzat e tyre të gjalla dhe çdo fis kërkonte hakmarrje për të vrarin e vet nga çdo mashkull që i përkiste fisit të vrasësit, pa marrë parasysh, nëse ishte fajtor apo i pafajshëm, i vetëdijshëm për ngjarjen apo i paditur. Ajo ishte një shoqëri e përshkuar nga shtypja, ashpërsia, brutaliteti dhe egërsia, në formën e saj më të skajshme.

**Uilajeti, vazhdimi i rrugës edukative që nisi Profeti
Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi
familjen e tij!*)**

Ai që është rritur dhe është formuar në atë gjendje (të injorancës paraislame), mund të rregullohet dhe të edukohet brenda dhjetë vjetëve, nëse plotësohen kushtet përkatëse dhe mund të bëhet mysliman. Por nuk është e mundur që brenda atyre dhjetë vjetëve t'i rrënjosen në thellësi të shpirtit vlerat dhe konceptet islame, në një masë të tillë, që ai të ketë aftësinë për të ndikuar te të tjerët, njësoj si Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Njerëzit hynin në Islam në grupe të mëdha dhe turma-turma. Shumë prej tyre nuk e kishin përjetuar kohën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe nuk i kishin jetuar ato dhjetë vite të tij.

Këtu bëhet e qartë rëndësia e çështjes së testamentit (*vasijetit*), të cilën e besojnë shi'itët. Burimi i këtij "*vasijeti*" dhe tekstit hyjnor është pikërisht nevoja për të vazhduar rrugën edukative që kishte nisur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe jo thjesht një testament si ata që bëjnë zakonisht njerëzit para vdekjes për fëmijët e tyre. Këtu kemi të bëjmë me vazhdimin e rrugës profetike, pas largimit të tij.

Unë nuk dua të hyj në debate teologjike, por dëshiroj ta trajtoj këtë çështje nga aspekti historik dhe t'ju ftoj edhe ju që ta analizoni me vëmendje. Ky diskutim, padyshim, nuk është vetëm për shi'itët, por u takon të gjithë myslimanëve: shi'itëve, sunive dhe të gjitha shkollave islame, njësoj. Duke marrë parasysh rëndësinë e tij, ky diskutim duhet të zgjojë interesin e të gjithëve.

Ajo që duhet të pyesim, është: Çfarë ndodhi në shoqërinë islame gjatë atyre 50 viteve, pas ndarjes nga Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që e bëri atë të kthehet prapa nga gjendja e lartë në të cilën ishte ngritur? Kjo është çështja thelbësore dhe kërkon shqyrtim të thellë historik.

Është e qartë se ndërtimi që kishte ngritur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk mund të rrëzohej aq lehtë.

Kjo është arsyeja pse, menjëherë pas ndarjes së tij, shumica e gjërave, përjashto çështjen e vasijetit, vazhduan si më parë: drejtësia ishte ende në gjendje të mirë, përmendja e Allahut ishte e pranishme, adhurimi zhvillohej normalisht. Nëse dikush shikonte strukturën e përgjithshme të shoqërisë islame në vitet e para pas

largimit të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), do të vërente se çdo gjë dukej në vendin e vet. Po, ndodhnin disa ngjarje herë pas here, por pamja e jashtme tregonte se themelet që kishte vendosur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ishin ende në këmbë. Megjithatë, siç ndodh në çdo shoqëri, gjërat nuk qëndrojnë gjithmonë njësoj. Me kalimin e kohës, shoqëria islame filloi të dobësohej gradualisht dhe të boshatiset nga brenda.

Rruga e atyre që Ti i ke mirësuar

Ka një pikë në suren “El Fatiha”, për të cilën kam folur disa herë në takime të ndryshme. Kur njeriu i lutet Zotit, duke thënë: **“Udhëzoni në rrugën e drejtë”** (اهدنا الصراط المستقيم), menjëherë pas saj shpjegon se cila është kjo rrugë: **“Rruga e atyre që Ti i ke mirësuar”** (صراط الذين أنعمت عليهم). Zoti i Madhëruar ka begatuar shumë popuj dhe kombe.

Ai u ka dhënë mirësi edhe Beni Israilëve (bijve të Izraelit), siç thuhet: **“O bijtë e Izraelit, përkujtoni mirësinë që Unë ju kam dhënë”**.

Mirësia dhe begatia hyjnore nuk është e kufizuar vetëm për profetët, të drejtët dhe dëshmorët: **“Këta janë me ata që Zoti i ka begatuar prej profetëve, të drejtëve, dëshmorëve...”** pra, të gjithë këta e kanë fituar atë begati e mirësi, edhe Beni Israilët, gjithashtu. Megjithatë, të mirësuarit ndahen në dy grupe:

Grupi i parë: Janë ata që, pasi u është dhënë begatia, nuk kanë rënë në zemërimin e Zotit, nuk kanë bërë veprime që ta shkaktojnë atë dhe nuk janë shmangur nga udhëzimi. Këta janë ata për të cilët ne i lutemi Zotit, që të na udhëzojë në rrugën e tyre.

Fraza **“jo të atyre që kanë shkaktuar zemërimin (e Zotit)”** (غير المغضوب عليهم), në të vërtetë, është përkthim për ata që janë të begatuar, pra, ne po kërkojmë rrugën e atyre që janë të begatuar dhe që nuk janë nga ata që kanë shkaktuar zemërimin hyjnor.

Grupi i dytë: Janë ata që, pasi morën begatinë, e shkëmbyen atë me mosmirënjohje, u rebeluan ndaj saj dhe, për këtë arsye, ranë nën zemërimin e Zotit, ose u shoqëruan me ata që e bënë këtë dhe për pasojë u shmangën nga udhëzimi i drejtë. Në disa nga rregullat tona (shi'ite) thuhet se: **“Të zemëruarit”** janë çifutët dhe ky shpjegim është një shembull konkret i kësaj të vërtete, sepse çifutët, madje, edhe deri në kohën e Isait (Jezusit), luftonin me dijeni dhe qëllimisht kundër Musait dhe trashëgimtarëve të tij.

Ndërsa “të humburit” janë të krishterët, sepse ata u shmangën nga rruga, që në fillim, ose të paktën shumica prej tyre devijuan, kur Zoti u dha atyre begatinë.

Po myslimanët? Myslimanëve, gjithashtu, Zoti ua zbriti begatinë e Tij. Por, për shkak të veprimeve të tyre, ajo begati u kthye në rrugën e “të zemëruarve” dhe “të humburve”.

Imami Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur u vra Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), zemërimi i Zotit në tokë u bë i madh”, sepse ai ishte imam i pamëkatë. Nga kjo kuptohet se edhe një

shoqëri që ka marrë begatinë hyjnore, mund të shkojë në drejtim të gabuar dhe ta tërheqë mbi vete zemërimin e Allahut. Prandaj, ecja në rrugën e drejtë kërkon përpikëri dhe vëmendje maksimale, gjë që është, padyshim, e vështirë dhe kërkon zgjuarsia e kujdes të madh.

Gjendja e elitës pas largimit nga jeta e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)

Po përmend më poshtë disa shembuj: Elita (*el khauas*) dhe masa e gjerë e njerëzve (*el auaam*), secili, pati gjendjen e vet të veçantë. Nëse elita devijon, ata mund të përfundojnë në kategorinë e atyre që kanë shkaktuar zemërimin e Zotit (*el maghdub alejhim*), ndërsa masa e gjerë mund të përfundojë në radhët e të humburve (*ed dalin*).

Librat e historisë janë të mbushur, natyrisht, me shembuj dhe dëshmi për këtë, dhe nga tani e tutje do t'ju citoj nga historia e Ibn El Ethirit, duke shmangur çdo burim shi'it, madje edhe disa burime sunite, që vetë sunitë i vënë në dyshim, siç është libri "*El Imamet ues Sijase*" i Ibn Kutejbeh Ed Dinuri, sepse në atë libër përmenden çështje dhe ngjarje që janë befasuese dhe tronditëse.

Kur dikush lexon përmbajtjen e veprës së Ibn El Ethirit të titulluar "*El Kamil fi' Et Tarikh*", kupton që ajo përmban njëanshmëri pro Umajadëve dhe pro Osmanëve. Ndoshta ai ka

ndjekur këtë stil për të shmangur probleme politike apo për arsye taktike. Ai, për shembull, shkruan për ngjarjen e vrasjes së Osmanit: “Osmanin e vranë banorët e Egjiptit, Kufes, Basrës, Medinës dhe të tjerë”. Pasi përmend disa rrëfime dhe dokumente historike, ai shton: “Kemi lënë pa përmendur shumë prej arsyeve që njerëzit i përmendin si shkas për vrasjen e Othmanit, për shkak të rrethanave që e kërkuan këtë”.

Kur Ibn El Ethiri flet për ngjarjen e Ebu Dherit dhe si e dëboi Muavija nga Shami (Damask) në Medinë, pa respekt dhe më pas e internoi në Rabdha në mënyrë të poshtër, ai shkruan: “Kanë ndodhur gjëra që nuk është e hijshme të përmenden”.

Nga kjo kuptohet se ky historian ose ka ushtruar vetëcensurë, siç do të thoshim sot, ose ka qenë i njëanshëm. Në çdo rast, ai nuk ishte shi’it dhe nuk kishte prirje drejt Shi’izmit, madje, ndoshta ishte me prirje pro Umajade dhe pro Osmane. E theksoj përsëri, se gjithçka që do të citoj më pas, është nga Ibn El Ethiri, jo nga burime shi’ite.

Do të sjell disa shembuj që tregojnë se si u soll elita gjatë pesëdhjetë viteve, pas largimit nga jeta e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe si u arrit deri në atë gjendje. Kur i analizoj ngjarjet dhe rrethanat e asaj epoke, vërej se ato katër shtylla themelore, adhurimi (*el ubudijetu*), dija (*el ma’rife*), drejtësia (*el adlu*) dhe dashuria (*el mahabbetu*), kanë pësuar tronditje. Do të paraqes disa shembuj për këtë, ashtu siç janë përmendur pikërisht në tekstet historike.

Talha ibn Abdullahu

Said ibn el Asi, ishte nga fisi Umajad dhe prej të afërmve të Osmanit. Ai u bë guvernator, pas Velid ibn Ukbeh ibn Ebi Muit. Velidi është personi që keni parë skena nga jeta e tij në serialin televiziv *"Imam Aliu"*, në të cilin ndodhi vrasja e magjistarit, në praninë e tij. Saidi u emërua për të ndrequr dëmet që kishte shkaktuar Velidi.

Një ditë, një burrë, në një nga mbledhjet e tij, tha: "Sa bujar është Talha!" Pa dyshim, Talha i kishte dhuruar dikujt pasuri apo kishte nderuar dikë. Saidi tha: "Ai që ka prona si Nashastaxhi, me të vërtetë, mund të quhet bujar!" Nashastaxhi kishte një pasuri të madhe pranë Kufes, që i përkiste Talha ibn Abdullahut, një sahab i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili në atë kohë jetonte në Medinë.

Pastaj Saidi shtoi: "Pasha Allahun, sikur unë të kisha një pasuri si ajo, do t'jua bëja jetën të begatë dhe të bollshme!" Krahasoni këtë gjendje me periudhën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe vitet e para, pas vdekjes së tij dhe vëreni se si kishte ndryshuar jeta e të mëdhenjve, udhëheqësve dhe sahabëve, dhe si e shihnin botën materiale. Gjërat kishin arritur në këtë pikë vetëm dhjetë ose pesëmbëdhjetë vjet pas vdekjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ebu Musa el Esh'ari

Shembulli tjetër është Ebu Musa el Esh'ari, i cili ishte guvernator i Basrës dhe i njëjti person që luajti rol kyç në çështjen e arbitrazhit (*tahkim*), pas betejës së Sifinit. Një ditë, ai u ngjit në minber, ndërsa populli përgatitej për një ekspeditë ushtarake. Ai i ftoi njerëzit në xhihad, duke përmendur vlerën e tij të madhe. Për shkak të kësaj, disa njerëz braktisën kafshët e tyre dhe vendosën të shkonin në këmbë, me shpresë që të merrnin shpërblim më të madh prej Zotit. Ata larguan kuajt, sepse mendonin se, po t'i përdornin, nuk do ta merrnin shpërblimin e plotë. Por disa të tjerë, më të mençur, thanë: “Le të presim dhe të shohim, çfarë do të bëjë vetë Ebu Musai. Nëse fjalët e tij përputhen me veprat, do të bëjmë si ai”.

Në librin e Ibn el Ethirijt thuhet fjalë për fjalë: “Kur doli për në luftë, ai nxori pasurinë e tij nga pallati me mbi dyzet gomarë”. Këto ishin pronat e tij të çmuara, të cilat ishte i detyruar t'i merrte me vete, edhe në fushën e luftës. Kjo ndodhte, sepse: nuk kishte banka apo institucione financiare, ku të ruante pasurinë; qeveria nuk ishte e besueshme – një urdhër për ta shkarkuar nga detyra mund të vinte në çdo çast. Nëse shkarkohej, ndërkohë që ishte në fushën e betejës, nuk do të kishte më mundësi të kthehej në Basra për të marrë pasurinë. Prandaj ai e ngarkoi gjithë pasurinë mbi 40 gomarë dhe e mori me vete në luftë.

Kur doli, një grup njerëzish e ndaluan dhe i thanë: “Na merr edhe neve me vete mbi ndonjë nga këta gomarë, ashtu siç na ke nxitur të ecim në këmbë”. Por ai i goditi me kamxhik. Ata u larguan nga kafsha e tij. Ai vazhdoi rrugën e tij. Mirëpo, njerëzit

nuk e duruan këtë sjellje, shkuan në Medinë dhe u ankuan tek Osmani, i cili e shkarkoi atë nga posti. Kur ky Ebu Musai, që kishte qenë sahab i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe pjesë e elitës (*khaëas*), arriti në një gjendje të tillë, ç' mund të themi për të tjerët?

Sad ibn ebu Vekasi

Shembulli i tretë është Sad ibn ebu Vekasi, i cili ishte emëruar guvernator i Kufes. Sadi mori para hua nga Bejtul Mali (thesari publik). Në atë kohë, Bejtul Mali nuk ishte në dorë të guvernatorit, sepse ata zakonisht emëronin guvernatorin për çështjet administrative dhe politike, ndërsa një person tjetër merrej me financat dhe ishte përgjegjës drejtpërdrejt para kalifit. Kur Sadi u emërua guvernator i Kufes, arkëtari i Bejtul Malit ishte Abdullah ibn Mesudi, një sahab i nderuar.

Pasi Sadi mori para hua nga Abdullah ibn Mesudi, pas një kohe ky i fundit e paditi, por nuk arriti ta kthente borxhin dhe shkoi puna deri në debat dhe përplasje mes tyre. Në këtë moment, ishte i pranishëm Hashim ibn Utebe ibn ebu Vekasi, një nga shokët besnikë të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe një burrë fisnik, i cili tha: “Ju të dy jeni shokë të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe njerëzit ju shikojnë. Mos u grindni, por përpikuni ta zgjidhni çështjen në mënyrë paqësore”.

Abdullah ibn Mesudi, që ishte njeri i ndershëm dhe i besueshëm, doli nga shtëpia dhe kërkoi ndihmën e disa njerëzve,

për të marrë paratë nga shtëpia e Sadit, gjë që do të thotë se paratë ndodheshin aty. Kur Sadi e mori vesh këtë, kërkoi ndihmën e disa të tjerëve për t'i ndaluar ata. Nga mospagimi i borxhit dhe sjellja e Sadit, lindi një përplasje e madhe.

Pra, nëse vetë Sad ibn ebu Vekasi, një nga anëtarët e këshillit prej gjashtë personash, që vendosën për pasuesin e kalifatit, arrin në këtë nivel të dashurisë për pasurinë dhe konfliktin, vetëm pas disa viteve, kjo është shumë domethënëse.

Ibn el Ethiri e përshkruan këtë ngjarje me fjalët: “Kjo ishte përplasje e parë e madhe mes njerëzve të Kufes”. Pra, shkaku i përplases së parë midis banorëve të Kufes, sipas Ibn el Ethirit, ishte një nga elitat “*el khauasu*”, që u pushtua nga dashuria për këtë botë deri në këtë shkallë.

Mervan ibn Hakemi

Një tjetër shembull është Mervan ibn Hakemi. Kur myslimanët pushtuan vendet e Afrikës dhe ndanin plaçkën e luftës mes ushtarëve, ishte detyrimi i tyre që një të pestën e plaçkës (*khums*) ta dërgonin në Medinë. Kjo shifër ishte shumë e madhe.

Ibn el Ethiri shkruan në një vend tjetër se, kur kjo pasuri arriti në Medinë, ajo u ble nga Mervan ibn Hakemi për pesëqind mijë dinarë, një shumë jashtëzakonisht e madhe. Megjithatë, vlера e vërtetë e saj ishte shumë më e madhe se ajo që u pagua, gjë që u mor më pas si një akuzë kundër kalifit Osman. Osmani e

justifikonte veprimin, duke thënë: “Ai (Mervani) është i afërmi im dhe unë po e ndihmoj familjen time, sepse ai jeton në vështirësi”.

Ky rast tregon qartë se të afërmit dhe të privilegjuarit e shoqërisë ishin bërë të etur për pasuri dhe për pushtet.

El Uelid ibn Ukbetu

Çështja tjetër është se Osmani e shkarkoi Sad ibn ebu Vekasin nga posti i guvernatorit të Kufes dhe në vend të tij emëroi El Uelid ibn Ukbetu ibn ebu Muajtin, i cili ishte nga të afërmit e kalifit.

Kur El Uelidi hyri në Kufe, banorët u habitën që ky person ishte emëruar guvernator i tyre, sepse ai njihej për marrëzinë dhe prishjen morale. Për të, ka zbritur ajeti i Kur'anit: **“Nëse vjen ndonjë mëkatar (fasik) me një lajm, hulumtoni mirë...”**²⁴ Kjo do të thotë se Kur'ani vetë e përshkroi atë si “*fasik*”, sepse kishte sjellë një lajm të rremë, që kishte sjellë dëm në kohën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Shiko se si ishin kthyer përmbys standardet dhe vlerat në atë kohë! Ky njeri, të cilin Kur'ani e quan “*fasik*” dhe ajeti recitohej çdo ditë nga myslimanët, u bë guvernator. Madje vetë Sad ibn ebu Vekasi dhe Abdullah ibn Mesudi u habitën, kur e panë atë guvernator në Kufe.

²⁴ Sure “El Huxhurat”, ajeti 6.

Abdullah ibn Mesudi, sapo e pa, i tha: “Nuk e di... mos ndoshta, pas largimit tonë, njerëzit u përmirësuan apo gjithçka u prish?”

Ndërsa Sadi iu përgjigj me ironi: “Mos je bërë më i mençur, që kur ikëm ne apo kemi marrë ne fund, që kur erdhe ti?!”

El Uelidi iu përgjigj: “Mos u mërzit, o Ebu Ishak! Kjo nuk ka të bëjë me mirësi apo keqbërje... Ky është pushtet, të cilin disa e hanë për drekë e të tjerë për darkë”.

Kjo thënie e lëndoi thellë Sad ibn ebu Vekasin, sepse ai ishte nga shokët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ai i tha: “Po e shoh që ju e keni kthyer këtë çështje në një mbretëri!”

Udhëheqja (el uilajetu) është një qeverisje e mbushur me dashuri për njerëzit dhe lidhje me ta

Një herë, Omeri e pyeti Selman Farisiun: “A jam unë një mbret apo një kalif?” Selmani, i cili ishte një figurë e madhe, i nderuar, prej shokëve të mëdhenj të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe fjala e tij kishte peshë, iu përgjigj: “Nëse ti ke mbledhur nga toka e myslimanëve një dirhem, qoftë më shumë apo më pak dhe e ke vendosur atë jashtë vendit të vet të drejtë, atëherë ti je mbret, jo kalif”. Kështu ia sqaroi kriterin.

Ibn el Ethiri transmeton se Omeri qau nga kjo përgjigje, që ishte një këshillë tepër e thellë dhe me kuptim të madh.

Pra, udhëheqje do të thotë qeverisje, e cila bazohet në dashurinë ndaj njerëzve dhe lidhjen e ngushtë me ta, shoqërohet me butësi dhe dhembshuri për popullin. Nuk ka të bëjë me diktat apo sundim mbi njerëzit. Ndërsa mbretëria (monarkia) nuk ka këtë kuptim, mbreti është një sundimtar autokrat, që vepron si të dojë pa llogaridhënie.

Kjo ishte gjendja e elitave (*el khauas*). Në këtë pikë kishin përfunduar ata brenda një kohe të shkurtër. E gjithë kjo ndodhi gjatë kohës së udhëheqësve të drejtë, të cilët i jepnin rëndësi të madhe zbatimit të urdhrave fetare, sepse kishin jetuar për një kohë të gjatë pranë Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe jehona e fjalëve të tij ende dëgjohej në Medinë.

Në atë shoqëri, Ali ibn ebu Talibi ishte ende i pranishëm, një njeri që mishëronte drejtësinë. Por, kur qendra e udhëheqjes u zhvendos në Damask, çështja e kalifatit u tejkalua dhe u deformua rëndë.

Këto ishin vetëm disa shembuj të gjendjes së elitës (*khauas*) në atë kohë.

Nëse dikush kërkon në librin e historisë së Ibn El Ethirit apo në burime të tjera historike të besueshme nga vëllezërit myslimanë, do të gjejë mijëra, jo qindra shembuj të kësaj natyre.

Një hebre që flet në emër të Islamit

Është e natyrshme që, kur drejtësia humbet dhe adhurimi i Zotit zhduket, shoqëria bëhet bosh dhe shpirtrat prishen. Një shoqëri e tillë, kur arrin në atë pikë të garës së etur për pasuri dhe grumbullimin e saj, arrin deri në atë pikë, saqë personi që u mëson njerëzve dijet, është Kab el Akhbari, një hebre që më pas u bë mysliman, e që nuk e përjetoi as kohën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ai nuk hyri në Islam gjatë jetës së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), as në kohën e Ebu Bekrit, por vetëm në kohën e Omerit dhe ndërroi jetë në kohën e Osmanit. Çfarë të thuash për një shoqëri të tillë? Disa thonë se është gabim ta quash Kab el Akhbar, sepse emri i tij i saktë është Kab el Ahbar. “Ahbar” është shumësi i “hibr”, që do të thotë: dijetar hebre. Ky njeri ishte ndër figurat kryesore të dijetarëve hebrenj. Pastaj, u fut në Islam dhe filloi të fliste për çështje islame.

Një ditë ishte ulur në një nga mbledhjet e kalifit Osman, kur hyri Ebu Dherri.

Kabi tha një fjalë, që e zemëroi Ebu Dherrin, i cili ia ktheu: “Çfarë pune ke këtu? A do të na mësosh neve Islamin dhe rregullat e tij, ndërkohë që ne i kemi dëgjuar ato nga vetë i Dërguari i Allahut?”

Kur humbasin kriteret, shkatërrohen vlerat, zbrazet përmbajtja dhe gjithçka reduktohet në formë e dukje. Kur dashuria për dynjanë dhe pasurinë mbizotëron te njerëz, që dikur

ishin të përkushtuar në asketizëm dhe nder, që ngritën lart flamurin e vërtetësisë dhe të devotshmërisë, atëherë ndodh që për çështjet e kulturës dhe dijes, të marrë fjalën dikush që e ka pranuar Islamin më vonë, dhe të shprehë, në emër të Islamit, atë që mendon ai vetë dhe jo atë që thotë Islami. Pastaj disa njerëz duan ta vënë fjalën e tij mbi fjalën e një myslimani me përvojë e besim të thellë.

Tregime për njerëzit e thjeshtë

Kjo ishte gjendja e elitës (*el khauas*). Sa për njerëzit e thjeshtë (*el aëam*), ata zakonisht ndjekin të dalluarit dhe ecin pas tyre, kudo që ata shkojnë. Për këtë arsye, një nga krimet më të mëdha që mund të bëjë një personalitet i shquar në shoqëri, është largimi nga rruga e drejtë, sepse ky largim çon në largimin e shumë të tjerëve, kur shohin që vlerat janë shtrembëruar dhe veprat janë në kundërshtim me fjalët. Ajo që thuhet, bie ndesh me Sunetin e Profetit, edhe ata vetë ndjekin atë rrugë, duke u marrë shembull nga të mëdhenjtë.

Amar ibn Jasiri, njeriu i vlerave

Po ju tregoj një shembull që lidhet me njerëzit e thjeshtë: Guvernatori i Basrës i shkroi kalifit, duke i raportuar për numrin e madh të banorëve të qytetit dhe pamundësinë e tyre për të mbuluar shpenzimet publike. Ai kërkoi nga kalifi që të rriste

tatimin (kthimin vjetor të prodhimeve) për dy qytete që i përkisnin Basrës.

Amar ibn Jasiri ishte një njeri fisnik dhe i palëkundur, si mal i lartë (një simbol i qëndrueshmërisë dhe besnikërisë). S'ka dyshim se kishte edhe të tjerë si ai, të paprekur nga tundimet, por ata ishin të paktë.

Banorët i kërkuan Amarit, që të kërkonte rritjen e tatimeve për dy qytete, edhe për ta. Ai e refuzoi këtë kërkesë, sepse ishte kundër parimeve të tij. Për këtë arsye, e urryen dhe e paditën te kalifi, i cili e shkarkoi nga posti i tij.

Ngjashëm ndodhi edhe me Ebu Dherrin dhe të tjerë. Ndoshta Abdullah ibn Mesudi ishte ndër ta.

Kur nuk respektohen më parime të tilla, shoqëria zhvishet nga vlerat. Kjo është një nga mësimet e mëdha që duhet të nxjerrim.

Devotshmëri do të thotë vetëvëzhgim dhe përgjegjësi ndaj të tjerëve

Dijeni, të dashur miq, se njeriu nuk e kupton plotësisht realitetin e zhvillimeve shoqërore, veçse pas një kohe të gjatë. Pikërisht kjo është arsyeja që na detyron të jemi të vëmendshëm, të kujdesshëm dhe të vetëdijshëm. Ky është kuptimi i devotshmërisë (*tekua*).

Devotshmëri do të thotë: Ai që ka kontroll vetëm mbi veten, duhet të ruajë dhe ta përmbajë veten. Ndërsa ai që ka pushtet mbi të tjerët, duhet të ruajë veten dhe ata që janë nën përgjegjësinë e tij. Ata që ndodhen në krye të pushtetit, duhet të kenë kujdes si ndaj vetes së tyre, ashtu edhe ndaj gjithë shoqërisë, në mënyrë që ajo të mos rrëshqasë drejt lakmisë për dynjanë dhe lidhjes pas zbukurimeve të saj, si dhe të mos bjerë në greminën e dashurisë për vetveten.

Kjo nuk do të thotë se duhet të largohemi nga ndërtimi i shoqërisë, përkundrazi, ndërtimi i shoqërisë dhe shtimi i pasurisë publike janë të domosdoshme, por jo për përfitime personale. Kërkimi i pasurisë për vetveten është i papranueshëm. Çdokush që ka mundësi të rrisë pasurinë e shoqërisë dhe të realizojë projekte të mëdha për të mirën e përgjithshme, fiton shpërblim të madh.

Ka njerëz që gjatë këtyre viteve kanë arritur të ndërtojnë vendin, të ngrenë lart flamurin e zhvillimit dhe të kryejnë punë të mëdha. Kjo është krenari për ta dhe nuk hyn në kategorinë e dashurisë për dynjanë.

Dashuria për dynjanë vlen atëherë, kur dikush kërkon përfitime për veten, punon vetëm për interesat e veta ose grumbullon pasuri për veten nga thesari i myslimanëve apo nga burime të tjera. Kjo është sjellje e neveritshme dhe e dënueshme.

Prandaj duhet të jemi të kujdesshëm, që të mos biem në këto kurthe, sepse, nëse kujdesi mungon, shoqëria zhvishet ngadalë nga vlerat, derisa mbetet vetëm me një pamje të jashtme boshe. Dhe, kur është në këtë gjendje, një fatkeqësi e madhe mund

ta godasë papritur, siç ndodhi me atë shoqëri në kohën e kryengritjes së Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Prandaj ajo nuk arriti ta përballonte këtë sprovë.

Reji, çmimi për vrasjen e të dashurit të Zehrasë

Umer ibn Saadit iu ofrua posti i guvernatorit të Rejit. Në atë kohë, Reji ishte një krahinë e gjerë dhe e pasur. Duhet të dimë se posti i emirit (guvernatorit) në kohën e Benu Umejes nuk ishte si posti i prefektit apo guvernatorit në kohët tona. Prefektët sot janë punonjës shtetërorë, marrin rroga të caktuara dhe bëjnë punë të lodhshme administrative. Por në atë kohë, gjendja ishte ndryshe. Guvernatori kishte dorë të lirë për të vepruar me pasuritë e rajonit që drejtonte, sipas dëshirës së tij, me kusht që një pjesë të tyre ta dërgonte në kryeqytetin e kalifatit. Prandaj, posti i guvernatorit konsiderohej jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe fitimprurës.

Por kushti për ta marrë këtë post, ishte: lufta kundër Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Natyrshëm, një person me vlera dhe ndërgjegje të pastër nuk do të pranonte as për një çast një ofertë të tillë. Çfarë vlere ka Reji apo e gjithë bota, nëse vendoset përballë Hysenit? Asgjë nuk mund ta justifikojë vrasjen e Hysenit, fëmijëve të tij dhe familjes së tij të pastër. Por, kur shoqëria zbrazet nga vlerat, kur njerëzit harrojnë moralin dhe drejtësinë, atëherë edhe krimet më të mëdha bëhen të mundshme. Në një gjendje të tillë,

njeriu më shumë vonon për të fituar kohë, se sa për të menduar me të vërtetë.

Edhe nëse do të mendonte një vit të tërë, do të arrinte të po i njëjti përfundim, si ai që shtyn vendimin për një natë, sepse nuk ka më ndjeshmëri ndaj të vërtetës. Kështu ndodhi: Umer ibn Sadi mendoj një natë dhe të nesërmen pranoi ofertën. Por, Zoti nuk ia dha suksesin për të përfituar nga kjo botë. Përfundimi i gjithë kësaj ishte tragjedia e Qerbelasë.

Analizë e ngjarjes së Ashures

Dua të bëj një vërejtje të shkurtër në analizën e ngjarjes së Ashures.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), njeriu që mishëronte të gjitha vlerat hyjnore dhe njerëzore, u ngrit me revoltën e tij për të ndaluar rënien e shoqërisë në humnerën e degjenerimit moral dhe shpirtëror.

Shoqëria kishte rënë aq poshtë, saqë, nëse njerëzit do të dëshironin të jetonin një jetë të ndershme dhe islame, do të ndiheshin tërësisht bosh, sepse asgjë nuk kishte mbetur nga përmbajtja reale e Islamit. Në këtë realitet të zbrazët dhe të korruptuar, Hyseni qëndroi me gjithë qenien e tij dhe sakrifikoi gjithçka për hir të vlerave hyjnore. Ai sakrifikoi vetveten, djemtë e tij (Aliu i Madh e Aliu i Vogël), vëllain e tij, Abasin dhe gjithë shokët e tij besnikë. Ai e arriti atë qëllim, për të cilin ishte ngritur

dhe kështu u realizua fjala Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Hyseni është prej meje dhe unë jam prej Hysenit”.

Ky është aspekti tjetër i ngjarjes së Qerbelasë, e cila është e mbushur me heroizma. Kjo epope e pavdekshme nuk mund të kuptohet veçse nën dritën e dashurisë dhe pasionit për të vërtetën. Vetëm ata që shohin me syrin e dashurisë, mund ta kuptojnë se çfarë bëri Hyseni në një natë dhe një ditë, nga pasditja e ditës së nëntë të Muharremit, deri në pasditen e ditës së dhjetë.

Ai i dha emër të pavdekshëm vetes së tij në këtë botë. Një emër që do të qëndrojë përgjithmonë. Prandaj, të gjitha përpjekjet për ta fshirë ngjarjen e Qerbelasë nga kujtesa dhe historia, kanë dështuar. Ajo nuk u harrua dhe nuk do të harrohet kurrë.

Ashurja, fushë mësimi dhe reflektimi²⁵

Ashurja, përveçse është një mësim, është edhe një fushë për reflektim. Njeriu duhet të mendojë thellë për të nxjerrë mësimë prej saj. Po çfarë do të thotë të reflektosh (të marrësh mësim)? Do të thotë të vendosësh veten në një situatë krahasimi me atë ngjarje, të kuptosh gjendjen ose rrethanat që po kalon, cilat janë rreziqet që e kërcënojnë dhe çfarë është e domosdoshme për të bërë.

²⁵ Takim i udhëheqësit me repartet, skuadrat dhe njësitë e Ashures , pjesë e forcave të rezistencës mobilizuese, më 22.4.1371 sipas kalendarit iranian.

Për shembull, kur sheh një makinë që është përmbysur apo është përplasur me një tjetër dhe kjo ka çuar në vdekjen e pasagjerëve, ti ndalesh për të nxjerrë mësim nga ky aksident, mendon për shpejtësinë me të cilën po udhëtonte makina dhe mënyrën e drejtimit që çoi në atë përfundim tragjik. Ky është një lloj tjetër mësimi, që vjen përmes reflektimit. Prandaj, është e nevojshme ta zgjerojmë disi diskutimin mbi këtë temë.

Mësimi i parë

Mësimi i parë që na tërheq vëmendjen në çështjen e Ashures, është se ne shohim çfarë ndodhi në shoqërinë islame, pas pesëdhjetë vitesh nga largimi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), saqë Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ndërmerre një sakrificë të tillë për ta shpëtuar atë. Nëse sakrifica e Hysenit, i biri i Aliut, do të kishte ndodhur pas një mijë vitesh nga periudha e hershme e Islamit dhe në zemrën e kombeve dhe shteteve kundërshtarë dhe armiqësore ndaj Islamit, atëherë do të ishte një çështje tjetër. Por Hyseni, i biri i Aliut, po shihte një situatë që kishte mbizotëruar në qendrën e botës islame, Mekë dhe Medinë dhe nuk pa rrugëdalje tjetër, përveç sakrifikimit të gjakut të tij të pastër.

Por, cila ishte ajo gjendje që e bëri Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) të ndiejë, se nuk mund të ringjallej Islami përveçse me sakrificën e tij, përndryshe ai do të zhdukej? Këtu qëndron mësimi.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) udhëhiqte shoqërinë islame, ngrinte flamuj nga Meka dhe Medina dhe dërgonte myslimanët drejt skajeve të Gadishullit Arabik dhe drejt Shamit (Levantit), saqë kërcënonin Perandorinë romake. Ushtritë romake iknin para myslimanëve që ktheheshin në vendet e tyre si fitimtarë, ashtu si ndodhi në Tebuk. Zëri i Kur'anit dëgjohej në minaret e xhamive, përshkonte rrugicat e qyteteve dhe Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u recitonte njerëzve ajetet e Kur'anit, i këshillonte dhe i udhëhiqte me përkushtim drejt rrugës së udhëzimit.

Atëherë, çfarë ndodhi që kjo shoqëri u largua kaq shumë nga Islami, saqë u qeveris nga një njeri si Jezidi? Çfarë ndodhi që një njeri si Hyseni, i biri i Aliut, të mos shihte asnjë rrugëdalje tjetër, përveç ndërmarrjes së kësaj sakrifice të madhe, e cila nuk ka shembull në histori? Çfarë ndodhi që gjërat arritën deri në këtë pikë? Këtu qëndron mësimi.

Sëmundja e shoqërisë islame

Sot ne duhet të mendojmë thellë dhe me kujdes për këtë çështje. Ne sot përbëjmë një shoqëri islame dhe duhet të kërkojmë e të kuptojmë se çfarë sëmundje e goditi atë shoqëri, saqë puna përfundoi te Jezidi. Çfarë ndodhi që ai qytet, i cili dikur ishte qendra e qeverisë së Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), vetëm njëzet vjet pas martirizimit të tij, sheh kokat e

bijve të tij të mbërthyer mbi shtiza dhe të sillen nëpër rrugicat e qytetit?

Kufa nuk ishte e huaj për fenë. Përkundrazi, ajo ishte pikërisht qyteti, ku Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ecte nëpër tregjet e saj me kamxhikun në dorë, duke urdhëruar për të mirën dhe ndaluar nga e keqja, ditë e natë. Në xhamitë e saj jehonte zëri i leximit të Kur'anit, në mëngjes dhe në mbrëmje. Është po ky qytet, që më pas dëshmoi që vajzat e Prijësit të besimtarëve dhe gratë e familjes së tij, silleshin vërdallë të robëruara dhe të futura nëpër tregje si skllave.

Shkaqet kryesore të humbjes

Çfarë ndodhi gjatë atyre njëzet viteve, saqë gjendja arriti në këtë pikë?

Çfarë sëmundje e rrezikshme është ajo që mund ta çojë një shoqëri, në krye të së cilës qëndronte Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), në këtë gjendje, dhe vetëm brenda disa dekadave? Ne duhet të kemi frikë nga kjo sëmundje.

Nëse imami ynë i madh e konsideron veten ndër nxënësit e diplomuar nga shkolla e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe krenar për këtë, atëherë krenaria e tij qëndron në aftësinë për të kuptuar dispozitat

që solli Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për të vepruar sipas tyre dhe për t'i përcjellë ato. Por, ku jemi ne dhe ku është imami ynë, krahasuar me Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)?

Shoqëria që ndërtoi Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ra në atë gjendje vetëm pas disa vitesh. Prandaj shoqëria jonë duhet të jetë shumë e kujdesshme, që të mos preket nga ajo epidemi. Këtu qëndron mësimi.

Ne duhet ta identifikojmë atë epidemi dhe ta konsiderojmë si një rrezik të madh që na kanoset, në mënyrë që ta shmangim. Unë besoj se ky mesazh i Ashures është më i rëndësishmi për ne sot, ndër të gjitha mësimet dhe mesazhet që mbart Ashurja. Duhet të përcaktojmë se çfarë sëmundjeje ra mbi atë shoqëri, saqë koka e Hysenit, i biri i Aliut dhe nipi i figurës më të madhe në Islam, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), u soll nëpër rrugët e qytetit, në të cilin i ati i tij kishte qeverisur, një qytet nga i cili nuk lëvizte asgjë pa urdhrin e tij, e megjithatë, nga po ai qytet, dolën njerëz që shkuan në Qerbela, për ta vrrarë atë dhe shokët e tij të etur. Pastaj robëruan gratë e shtëpisë së Prijësit të besimtarëve.

Ka shumë për të thënë mbi këtë temë, por unë do të përmend një ajet nga Kur'ani, si përgjigje ndaj kësaj pyetjeje. Kur'anin na e ka dhënë përgjigjen dhe na e ka përcaktuar

sëmundjen: **“Dhe pas tyre erdhi një brez që e humbi namazin dhe ndoqi epsheet; andaj ata do të hasin humbjen”**.²⁶

Largimi nga përmendja e Allahut dhe ndjekja e epsheve

Shkaqet thelbësore të këtij largimi dhe humbjeje qëndrojnë në dy gjëra:

E para: Largimi nga përmendja e Allahut. Shfaqja më e dukshme e saj, është: namazi, harrimi i Zotit, boshatisja e jetës nga aspektet shpirtërore, braktisja e përkushtimit, e përmendjes, lutjes, e ndërmjetësimit të Zoti i Madhëruar, mungesa e mbështetjes tek Ai dhe zhdukja e mësimave hyjnore nga jeta publike.

E dyta: Ndjekja e epsheve dhe dëshirave vetjake. Me një shprehje të shkurtër: dashuria për dynjanë, lakmia për pasuri, pasioni për mbledhjen e thesarit dhe fundosja në kënaqësitë tokësore.

Epidemia e rrezikshme është humbja e parimeve

Kjo është një provë e madhe dhe thelbësore, dhe mund të na godasë edhe ne.

Nëse në shoqërinë islame zhduket ose dobësohet parimësia dhe secili prej nesh zhytet në konflikte të brendshme, nëse frikësohemi se do të mbesim prapa të tjerëve në aspektet materiale dhe themi: “Ata kanë mbledhur pasuri, të bëjmë edhe ne njëlloj”, atëherë fillojmë të vendosim interesat personale përpara

²⁶ Sure “Merjem”, ajeti 59.

interesave të shoqërisë. Është e qartë se situata do të përfundojë në atë mënyrë.

Sistemi islam formohet, ruhet dhe përparon përmes besimit, përkushtimit të lartë, shpalljes së parullave dhe gjallërimit të simboleve fetare. Dobësimi i këtyre parullave, moskujdesi ndaj parimeve islame dhe revolucionare, si dhe shpjegimi i çështjeve vetëm në bazë të llogarive materiale, të gjitha këto e tërheqin shoqërinë drejt atij përfundimi fatkeq. Kjo është pikërisht ajo që goditi myslimanët në periudhën e hershme të Islamit.

Kur përmbysen vlerat

Ka pasur një kohë në të cilën, për myslimanët, më e rëndësishmja ishte përparimi i Islamit, kënaqësia e Zotit të Madhëruar, mësimi i fesë dhe i dijeve islame, njohja e Kur'anit dhe e mësimave të tij. Sistemi i qeverisjes dhe i administrimit të shtetit në atë kohë ishte i ndërtuar mbi asketizëm (zuhd), devotshmëri, shmangie nga lakmia për dynjanë dhe stolitë e saj, dhe largim nga dëshirat vetjake. Si rezultat, ndodhi një lëvizje e madhe drejt Zotit. Në atë gjendje, ishte e natyrshme që një person, si Aliu, i biri i Ebu Talibit, të arrinte në kalifat dhe Hyseni, i biri i Aliut, të zinte një vend të veçantë, sepse vlerat dhe standardet mishëroheshin te këta persona më shumë se te të tjerët.

Kur standardi është Allahu, devotshmëria, të larguarit nga dynjaja dhe xhihadi në rrugë të Allahut, atëherë në skenë dalin ata

që përmbushin këto cilësi dhe marrin drejtimin e punëve. Kështu shoqëria kthehet në një shoqëri islame.

Por, nëse përmbysen vlerat dhe në pushtet vijnë ata që kanë më shumë dashuri për dynjanë, që janë më të zënë me kënaqësitë tokësore, më të prirë ndaj dredhive për të arritur interesat personale dhe më larg nga sinqeriteti e besnikëria, atëherë përfundimi do të jetë sundimi i njerëzve, si Umer ibn Sa'd dhe Ubejdullah ibn Ziyad, dhe vrasja e një njeriu si Hyseni, i biri i Aliut.

Për të kujdesshmit, nuk lejohet përmbysja e vlerave

Ata që janë të kujdesshëm, duhet të mos lejojnë përmbysjen e standardeve në një shoqëri islame. Nëse lëkundet standardi i devotshmërisë në shoqëri, atëherë është e qartë se përfundimi do të jetë derdhja e gjakut të një njeriu të devotshëm si Hyseni, i biri i Aliut. Nëse maturimi i gjykimit bëhet përmes dredhive, forcës dhe përbuzjes ndaj vlerave islame, atëherë është e qartë se në majën e pushtetit do të ngjitet dikush si Jezidi dhe në Irak do të bëhet njeriu i parë një si Ubejdullah ibn Ziyad.

Islami kishte për qëllim t'i ndryshonte këto standarde. Kjo është ajo që duhet të bëjë edhe revolucioni ynë: të përballet me këto standarde të kota dhe të gabuara që sundojnë botën materiale dhe t'i ndryshojë ato.

Bota e sotme dhe mbizotërimi i materializmit

Bota e sotme është bota e arrogancës, e forcës dhe e epsheve. Është botë ku vlerat materiale mbizotërojnë mbi ato shpirtërore. Kjo nuk është diçka e re. Aspektet shpirtërore janë zbehur dhe janë venitur prej shekujsh. Janë bërë përpjekje për të zhdukur vlerat shpirtërore dhe kanë ardhur njerëzit me fuqi, adhures të materializmit dhe kapitalizmit, për të ngritur një sistem që kontrollon fenë, një sistem i drejtuar nga një fuqi si Amerika, e cila është më e rrejshme, më dredharake, më përçmuese ndaj virtyteve njerëzore dhe më e pamëshirshme ndaj njerëzimit. Pas saj vijnë forca të tjera, secila sipas fuqive të tyre.

Revolucioni islam dhe frymëzimi nga Ashurja

Revolucioni islam, ndër të tjera, synon ta ringjallë Islamin dhe parimin: “Më i ndershmi ndër ju te Zoti, është më i devotshmi”. Revolucion i erdhi për të shkatërruar këtë strukturë të gabuar që sundon botën dhe për të ndërtuar një të re në vend të saj, sepse, kur ndërtohet një strukturë që bazohet vetëm në materializëm, atëherë është e kuptueshme që një njeri i degjeneruar dhe i zhytur në epshe, si Muhamed Riza Pahlavi, ngjitet në pushtet, ndërsa një njeri i ndershëm si Imami gjendet në burg dhe mërgim. Në një shoqëri ku mbizotërojnë forca, korrupsioni, mashtrimi dhe poshtërsia, nuk ka vend për një njeri

të pastër, të singertë, shpirtëror dhe të përkushtuar ndaj Zotit. Vendi i tij do të jetë burgu, internimi ose pushkatimi.

Por, kur ndryshuan rrethanat dhe një njeri si Imami mori drejtimin e punëve, dhe u zhdukën epshet, lakmia për dynjanë, varësia dhe korrupsioni, në vend të tyre, erdhën: devotshmëria, asketizmi, pastërtia, ndriçimi shpirtëror, përpjekja për Zotin, dhembshuria, burrëria, vëllazëria, altruizmi dhe sakrifica, atëherë këto vlera dhe virtyte mbizotëruan me ardhjen e Imamit.

Kujdes nga dobësimi i shpirtit të revolucionit dhe nga izolimi i bijve të tij

Nëse ruajmë këto vlera, sistemi i Imamatit do të qëndrojë i fortë. Në atë rast, nuk do të shpien në thertore njerëz si Hyseni. Por, nëse i humbasim vlerat, nëse shpirti revolucionar zbehet dhe, nëse përqendrimi ynë shkon nga përgjegjësitë dhe parimet hyjnore te zbukurimet personale, nëse izolojmë atë njeri të përkushtuar, të devotshëm e të singertë, që s'kërkon tjetër veçse një fushë, ku të luftojë për hir të Zotit, ndërkohë që i japim pushtet personave të paturpshëm, lakmitarë, ambiciozë dhe pa shpirt e pa ndriçim, atëherë çdo gjë do të ndryshojë.

Nëse koha ndërmjet vdekjes së Profetit Muhamed (Paqja bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) dhe martirizimit të nipit të tij ishte pesëdhjetë vjet, në kohën tonë ky interval mund të jetë shumë më i shkurtër dhe shumë shpejt këto virtyte do të

zhduken, dhe njerëzit që i përfaqësojnë ato, do të çohen në thertore. Prandaj, mësimi nga Ashurja është: të mos lejojmë që fryma e revolucionit dhe bijtë e tij të përjashtohen nga shoqëria.

Çfarë ndodhi, që shkoi situata deri te ngjarja e Qerbelasë?²⁷

Mikrobi që e ndoti trupin e shoqërisë

Kam folur një herë për mësimet që nxirren nga lëvizja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe kam thënë: Përveç mësimëve që i mësojmë nga kjo ngjarje, ka edhe mësimet që i marrim nga ajo. Mësimet na tregojnë çfarë të bëjmë, ndërsa përvojat (përsiatjet) na mësojnë si të sillemi ndaj asaj që ka ndodhur dhe ndaj asaj që mund të ndodhë në të ardhmen.

Përvoja e nxjerrë nga lëvizja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) qëndron në faktin që njeriu duhet të reflektojë mbi historinë dhe të shohë se çfarë ndodhi me atë shoqëri islame, e cila kishte në krye një njeri si Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), jo një njeri të zakonshëm, i cili e udhëhoqi shoqërinë për dhjetë vjet, me një aftësi që tejkalonte

²⁷ Ky tekst është marrë nga një fjalim i udhëheqësit me komandantët dhe pjesëtarët e Gardës Revolucionare Islamike dhe forcave të sigurisë, më 5.10.1374 (sipas kalendarit iranien), me rastin e Ditës së Gardës.

imagjinatën njerëzore, i mbështetur nga shpallja hyjnore e përjetshme dhe nga një urtësi e pafundme që e karakterizonte atë.

Më pas erdhi në pushtet Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Kufa u bë qendra e këtij sundimi madhështor. Atëherë, çfarë ndodhi? Cili mikrob hyri në trupin e kësaj shoqërie, saqë një njeri si Hyseni, i biri i Aliut, u vra në atë mënyrë, pas vetëm një gjysmë shekulli nga largimi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe njëzet vjet pas martirizimit të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), në mesin e asaj shoqërie dhe atyre njerëzve? Çfarë ndodhi? Si mund të ndodhte një ngjarje e tillë?

Përveç kësaj, ajo (ngjarja e Qerbelasë) nuk ndodhi ndaj një djali të panjohur, por ndaj atij djali që i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e kishte përqaftuar shumë herë, e kishte ulur pranë vetes në minber, teksa fliste me njerëzit. Ishte po ai nip për të cilin Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte thënë: “Hyseni është prej meje dhe unë jam prej Hysenit”. Marrëdhënia mes gjyshit dhe nipit ishte shumë e ngushtë.

Ishte po ai djalë që përbënte një shtyllë të rëndësishme të qeverisë së Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) në çështjet e luftës, paqes dhe politikës. Ai shkëlqente si dielli.

Gjendja e asaj shoqërie arriti në atë pikë, saqë një njeri kaq i shquar dhe nipi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me tërë atë devotshmëri, personalitet të lartë, dinjitet dhe me ato rrethe mësimore që mbante në Medinë, në mesin e atyre shokëve, ndihmësve, dashamirëve dhe shi'itëve të përhapur nëpër viset e ndryshme të botës islame,

vritet në mënyrë të dhimbshme, i rrethuar dhe i etur. Nuk mjafton që vritet, por edhe të gjithë ata që ishin me të, përfshirë foshnjën e tij gjashtëmuajshe. Pastaj gratë dhe fëmijët e tij merren robëresha dhe sillen vërdallë nga një qytet në tjetrin.

Çfarë ndodhi në të vërtetë, është një mësim!

Krahasoni shoqërinë tonë dhe atë shoqëri, që të mund të gjeni ndryshimet mes tyre. Ne jemi një shoqëri, në krye të së cilës qëndron Imami ynë i madh, i cili është, pa dyshim, njeriu më i madh dhe më i shquar i kohës sonë. Por ku është imami ynë (Khomeini) krahasuar me Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)? Fuqia e jashtëzakonshme që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e frymëzoi në atë shoqëri, ishte e tillë që vazhdoi ta udhëhiqte atë edhe shumë dekada pas vdekjes së tij.

Mos mendoni se fitoret që ndodhën pas tij, ishin të shkëputura nga fryma e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ato ishin rezultat i asaj fuqie të madhe të atij njeriu madhështor, e cila vazhdoi dhe vazhdon ta çojë përpara shoqërinë islame. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është i pranishëm në të gjitha fitoret që arriti ajo shoqëri dhe që po arrin shoqëria jonë deri në këtë ditë.

Unë gjithmonë e drejtoj fjalën time te të rinjtë, studentët, nxënësit e shkollave fetare shi'ite dhe të tjerët: merreni historinë seriozisht dhe thellohuni në të me vëmendje. Shikoni se çfarë

ndodhi. Ata ishin një popull që shkoi, por mësimi nga e kaluara është një leksion që Kur'ani na thërret ta mësojmë.

Thelbi i çështjes qëndron në disa pika, në të cilat nuk dua të hyj tani për t'i analizuar apo për t'i sqaruar, sepse kam folur mjaft për to më parë dhe dera është e hapur për kërkime e thellim. Studiuesit e vërtetë duhet vetëm të ulen dhe të shqyrtojnë hollësisht çdo fjalë e çdo detaj të asaj ngjarjeje.

Faktori kryesor: Përhapja e dashurisë për dynjanë, korrupsioni dhe imoraliteti

Një nga çështjet që u bë faktor thelbësor në këtë tragjedi, ishte përhapja e dashurisë për dynjanë, korrupsioni dhe imoraliteti, gjë që ua mori njerëzve burrinë fetare, ndjenjën e përgjegjësisë dhe besimin. Arsyeja pse ne përqendrohemi kaq shumë në çështjen e korrupsionit, imoralitetit, xhihadt, urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja dhe çështje të ngjashme, është sepse korrupsioni dhe imoraliteti e godasin shoqërinë me apati dhe mpirje.

Qyteti i Medinës, që dikur ishte qendra e parë e qeverisë islame, pas një kohe të shkurtër u shndërrua në një stacion ku mbizotëronin muzikantët, këngëtarët dhe valltarët më të famshëm. Madje situata arriti në atë pikë, sa që, kur pallati i Shamit (Damaskut) donte të sillte këngëtarët më të njohur, i drejtonin sytë nga Medina për të marrë artistët dhe këngëtarët prej andej.

Ky guxim (për mëkat) nuk ndodhi pas njëqind apo dyqind vjetësh, por shumë afër me martirizimin e bijës së Fatimes, Zehrasë, madje edhe më herët. Këto gjëra ndodhën në kohën e Muavijes dhe Medina u shndërrua në qendër të korrupsionit dhe imoralitetit, saqë djemtë e familjeve të njohura e fisnike, madje edhe disa të rinj nga Beni Hashim, u ndotën nga ky degjenerim.

Pushtetarët e kohës e dinin shumë mirë çfarë po bënin, ku po i vinin duart dhe çfarë po përhapnin. Ky dëm nuk u kufizua vetëm në Medinë, edhe rajonet e tjera u prekën nga kjo fatkeqësi.

Kujdes nga stuhitë e korrupsionit

Këtu bëhet e qartë rëndësia e kapjes fort pas fesë, devotshmërisë dhe aspekteve shpirtërore, si dhe rëndësia e vetëpërmbytjes dhe ndershmërisë. Për këtë arsye, ne shpeshherë kemi këshilluar dhe kemi nxitur rininë më të mirë të kohës sonë, që të jetë të kujdesshme ndaj stuhive të korrupsionit.

Kush mund të krahasohet me të rinjtë që i përkasin Gardës Revolucionare dhe forumeve të mobilizuara (Basixh)? Ata janë më të mirët e të rinjve, sepse janë të përparuar në fushën e dijes, fesë dhe xhihadit. Ku mund të gjejmë të tjerë si ta? Rrallë gjen njerëz të tillë në botë dhe në këtë numër kaq të madh. Për rrjedhojë, duhet pasur kujdes, që të mos bien pre e korrupsionit.

Sot, Zoti i Madhëruar e ka ruajtur shenjtërinë e këtij revolucionit dhe dimensionet e tij shpirtërore. Rinia jonë është e pastër dhe e ndershme, por dijeni mirë se zbukurimet dhe

ëmbëlsitë e kësaj bote janë shumë të rrezikshme. Ato mund të tronditin edhe zemrat më të forta dhe njerëzit më të qëndrueshëm. Prandaj duhet të ngriheni kundër këtyre tundimeve. Kjo është ajo që quhet “xihadi më i madh”.

Ju e keni kryer xihadin më të vogël, në mënyrën më të mirë dhe keni arritur një shkallë të lartë. Tani është radha që xihadin më të madh ta përfundoni, po ashtu, në mënyrën më të mirë.

Faktori tjetër: Indiferentizmi i ndjekjes së të vërtetës dhe fatit të Islamit

Një tjetër faktor që i çoi zhvillimet në këtë gjendje, gjë që mund ta kuptojmë qartë nga jeta e imamëve, ishte se ndjekësit e të vërtetës, të cilët përbënin shtyllat kryesore të strukturës së udhëheqjes hyjnore dhe të Shi'izmit, ishin indiferentë ndaj fatit të botës islame dhe nuk i kushtuan aspak rëndësi.

Disa prej tyre treguan një lloj zelli dhe aktivizimi, por për shkak të ashpërsisë së sundimtarëve, siç ndodhi gjatë sulmit ndaj Medinës në kohën e Jezidit, i cili dërgoi një njeri mizor për të shtypur ata që protestuan kundër tij, ata u tërhoqën, lanë gjithçka dhe e harruan krejt situatën. Sigurisht, nuk ishin të gjithë në Medinë, por disa prej tyre dhe përçarja ishte përhapur mes tyre.

Gjendja ishte krejtësisht kundër mësimave islame. Nuk kishte unitet, as organizim, as ndërlidhje mes forcave. Si rezultat,

armiku i goditi rëndë, pa mëshirë. Përballë sulmit të parë, ata u tërhoqën. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme.

Është e natyrshme që në konfliktin mes të drejtës dhe të pavërtetës të ketë goditje të ndërsjella, ashtu siç e drejta i godet të padrejtët, edhe të padrejtët i godasin ata që janë në të drejtën. Kështu vazhdon përballja, derisa njëres palë t'i mbarojnë fuqitë dhe të pësojë disfatë.

Sekreti i vërtetë i vazhdimësisë së dijeve të profetëve

Sekreti që qëndron pas vazhdimësisë së dijeve të profetëve, që nga fillimi e deri në ditët tona, është fjala e teuhidit (njësimit të Zotit), virtytet dhe vlerat fetare. Këto janë po të njëjtat dije që sot kanë përfshirë gjithë botën, kudo që të ktheni sytë, do të shihni dijen e profetëve.

Të gjithë profetët, me përjashtim të një pakice, janë shtypur. Ja, Musai, çfarë përndjekjesh pësoi apo Isai (Jezusi), çfarë ndjekjesh dhe presionesh përjetoi! Por dijet e tyre mbetën të gjalla deri më sot.

Sekreti i vërtetë i kësaj qëndrueshmërie është se profetët nuk e lanë kurrë fushën bosh. Dështimi i njërit nuk bëri që tjetri t'i dorëzohej të kotës dhe të pavërtetës. Të gjithë profetët, përveç një pakice, u goditën rëndë nga armiqtë e tyre: u vranë, u dogjën, u burgosën, u prenë për së gjalli dhe përjetuan tortura të tmerrshme

nga tiranët, por ja ku jemi sot, e gjithë bota është nën hijen e dijeve të tyre.

Kudo që të ktheni fytyrat tuaja, do të shihni dritën e dijeve të profetëve. Madje, moralet e mira dhe shprehjet e bukura si “drejtësia”, “paqja” e të ngjashme, janë fryt i mësimave të profetëve. Sekret i kësaj është qëndrueshmëria dhe mosdorëzimi, moslodhja dhe mosbraktisja e fushës së betejës.

Ky parim, për fat të keq, nuk ekzistonte në kohën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe në atë periudhë të historisë islame. Kjo çoi në atë tragjedi të madhe, sepse njerëzit kishin humbur lidhjen me tyre, shpejt ndiheshin të mposhtur e të lodhur dhe braktisnin fushën, gjë që i dha armikut mundësinë të ecë përpara pa pengesë.

Frymëzimi i Imamit Khomeinit nga përvoja e Qerbelasë

Kjo përvojë është shfrytëzuar një herë, në mënyrë të plotë dhe rezultoi me një fitore të madhe. Kjo ndodhi në Revolucionin tonë Islamik. Allahu i Madhëruar krijoi Imamin tonë të madh me një mënyrë të tillë, që ai kurrë nuk ndjeu disfatë apo lodhje, dhe dështimi nuk gjeti vend në shpirtin e tij. Ai besonte në përparim, edhe në rrethanat më të vështira. Këtë e keni parë nga afër gjatë tetë viteve të luftës, ku asnjëherë nuk vendosi të tërhiqet, madje qëndronte si një mal i pathyeshëm. Kur njeriu mbështetet në një mal të tillë, atëherë lufton me siguri e qetësi.

I tillë ishte edhe gjatë përballjes me regjimin e Pahlavit. Ai e vazhdoi luftën edhe përkundër dështimeve, vështirësive, goditjeve, presioneve, internimeve dhe moshës së shtyrë. Kur filloi luftën e tij, nuk ishte i ri, por 63 vjeç. E mbaj mend mirë, kur ai tha në një fjalim në vitin 1341 hixhri (1962): “Pse të kem frikë? Nëse më vrasin, ndërsa jam 63 vjeç, në moshën kur ndërruan jetë i Dërguari i Allahut dhe Imami Aliu, atëherë unë do të largohem nga kjo botë. A ka ndonjë lumturi më të madhe se kjo?” Ky ishte qëndrimi i tij. Një mal i pathyeshëm dhe i qëndrueshëm.

Edhe pse kur nisi luftën, Imami Khomeini ishte 63 vjeç, ai mbajti barrën e rëndë dhe e udhëhoqi revolucionin deri në moshën tetëdhjetë apo nëntëdhjetëvjeçare, duke përballuar ngjarje të mëdha. Këtë e keni parë me sytë tuaj: kërcënimet e Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, bashkëpunimin e tyre, luftën tetëvjeçare, bllokadën ekonomike, propagandën dhe presionin politik... Asnjë stuhi nuk e lëkundti atë, nuk mundën ta tronditin dhe ai fitoi.

Kjo përvojë u zbatua një herë të vetme. Kjo ndodhi në revolucionin tonë, ku populli luftarak qëndroi pas atij njeriu në rreshta të bashkuar. Madje, edhe njerëzit e dobët iu bashkuan lëvizjes dhe armiku pësoi disfatë. Sot, po ashtu, armiku ynë po pëson disfatë.

Pozicioni ynë në këtë ngjarje²⁸

Duhet të jetojmë me shqetësimet. Kur'ani na fton të meditojmë mbi të kaluarën dhe të nxjerrim mësim nga historia, por ndonjëherë vijnë disa dhe filozofojnë, duke thënë se e kaluara nuk mund të shërbejë si shembull për të tashmen. Këto mendime ngrihen nga disa që mendojnë se janë në gjendje t'i paraqesin ato si teori filozofike, por nuk janë të aftë për këtë. Ne nuk kemi punë me njerëz të tillë.

Kur'ani është i vërtetë dhe i besueshëm dhe na fton të marrim mësim nga historia. Marrja e mësimave nga historia nënkupton atë gjendje shqetësimi, për të cilën fola më parë, sepse historia përfshin çështje që, nëse duam të nxjerrim mësim prej tyre, do të na kaplojë njëfarë shqetësimi, një shqetësim që ka lidhje me të ardhmen. Por, pse? Cili është shkaku i këtyre shqetësimeve? Çfarë ka ndodhur në histori?

Përmes Ashures

Ngjarja që ndodhi, ishte në fillim të Islamit. Në një moment e kam përmendur se bota islame duhet të reflektojë mbi arsyen që brenda vetëm pesëdhjetë vitesh pas vdekjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), çoi në atë

²⁸ Takimi i udhëheqësit të Revolucionit Islamik me komandantët dhe pjesëtarët e brigadës 27 "Muhamed Resulull'lah" të Gardës së Revolucionit Islamik.

që bijtë e saj, ministra, prijës, komandantë, dijetarë, gjykatës dhe lexues të Kur'anit, të mbledhen në Kufe dhe Qerbela dhe t'i copëtojnë zemrën Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në atë mënyrë të tmerrshme.

Njeriu duhet të kërkojë thellë mbi shkaqet që çuan në atë gjendje. Kam folur për këtë temë dy apo tre vite më parë nën titullin "Mësime nga Ashurja". Gjëja më e rëndësishme nga ngjarja e Ashures janë mësimet që nxirren nga ajo.

Kam përmendur më parë se situata arriti deri aty, sa të nxirrnin familjen e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nëpër rrugë dhe tregje para syve të njerëzve dhe t'i akuzonin ata si kharixhinj²⁹. Në Islam, termi *khauarixh* përdoret për ata që ngrihen kundër një imami të drejtë dhe e ndajnë unitetin e umetit. Ata meritojnë mallkimin e Allahut, të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të besimtarëve. Prandaj, myslimanët e asaj kohe i urrenin khauarixhët³⁰. Kush ngrihej kundër një imami të drejtë, jeta e tij ishte e pavlefshme, edhe pse Islami i jep rëndësi të madhe gjakut të njerëzve. Ata përhapën se nipi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), djali i Fatimes dhe i Aliut, ishte ngritur kundër një imami të drejtë e ai imam i drejtë ishte Jezidi, i biri i Muavijes. Njerëzit i besuan. Pushtetarët

²⁹ Fjala "kharixh" vjen nga fjala arabe "kharexhea", që do të thotë "doli jashtë". Ata u quajtën kështu sepse u shkëputën (dolën) nga radhët e myslimanëve, konkretisht nga ushtria e Aliut, pas betejës së Siffinit (657 e.s.).

³⁰ Khauarixhët (ose në arabisht: الخوارج – al khawārij) ishin një sekt politik dhe fetar që u shfaq në fillimet e Islamit, gjatë periudhës së kalifatit të katërt, Ali ibn Ebi Talib (Paqja qoftë mbi të!).

ishin njerëz tiranë, që thoshin çfarë u pëlqente, por pse njerëzit i besonin? Pse qëndronin në heshtje ndaj tyre?

Pse u godit umeti islam me harresë dhe dobësi?

Ajo që më shqetëson më së shumti në këtë çështje, është pikërisht ky aspekt: pse arritën gjërat deri në këtë pikë? Pse umeti islam, që ishte në atë shkallë të hollësishme në zbatimin e dispozitave islame dhe në shqyrtimin e ajeteve kur'anore, u godit nga kjo gjendje harrese, pakujdesie dhe indiference, që përfundoi me një tragjedi të tillë? Kjo çështje e mbush mendjen e njeriut me pyetje. A jemi ne më të vendosur dhe më të fortë se shoqëria e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) apo ajo në kohën e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*)? Çfarë duhet të bëjmë, që të mos përsëritet ajo që ndodhi atëherë?

Sigurisht, për pyetjen që shtrova, për shkaqet e kësaj gjendjeje, nuk është përgjigjur askush, por përgjigjja është tek unë dhe dua të theksoj se askush nuk e ka trajtuar këtë temë në mënyrë të plotë dhe të thelluar, edhe nëse është folur për të.

Sot, dëshiroj të flas shkurtimisht për këtë çështje. Fjalët e mia do të jenë të përmbledhura, në lidhje me thelbin e saj. Unë do të shpalos përpara jush disa nga temat kryesore, që të mendoni vetë mbi to, që studiuesit dhe mendimtarët të kërkojnë rrënjët e kësaj tragjedie dhe të mendojnë për mënyrat e parandalimit që ajo të mos përsëritet.

Duhet ta parandalojmë përsëritjen e historisë. Nëse unë dhe ju nuk qëndrojmë sot kundër saj, mos u çudisni, nëse shoqëria jonë islame arrin në të njëjtën gjendje, ndoshta pas pesëdhjetë vitesh, ndoshta pas pesë apo dhjetë vitesh, përveç nëse ekzistojnë sy të mprehtë që depërtojnë thellë në çështje, një sy besnik që tregon rrugën, mendimtarë që drejtojnë ngjarjet dhe një vullnet i fortë që e mbështet këtë rrugë. Vetëm atëherë do të ndërtohet një hendek i fortë dhe një kështjellë e pathyeshme, që askush nuk mund ta depërtojë. Përndryshe, nëse jemi indiferentë, e njëjta gjendje do të përsëritet dhe atëherë të gjitha këto gjakderdhje do të jenë të kota.

Situata në atë kohë kishte arritur deri në atë pikë sa djali dhe nipi i atyre që u vranë në Bedër nga Imam Aliu, Hamzai dhe udhëheqësit e tjerë të Islamit, të uleshin në vendin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), përpara të cilit u vendos koka e të dashurit të Profetit (Imam Hysenit), dhe ai filloi të godasë dhëmbët e tij me një shkop prej kallami dhe thoshte: “Ah, sikur të kishin qenë të pranishëm paraardhësit e mi në Bedër, të shihnin si u tronditën ensarët nga goditjet e shpatave”.

Këtu Ku’rani urdhëron që të merret mësim dhe thotë: **“Thuaj: ‘Ecni nëpër tokë dhe shihni çfarë ndodhi’”**.³¹ Bëhuni të kujdesshëm, që ky kuptim, me ndihmën e Zotit, të përhapet në kulturën e sotme të vendit tonë përmes mendimtarëve, studiuesve dhe njerëzve me vizion. Po ju flas sot shkurtimisht për këtë temë.

³¹ Sure “Neml”, ajeti 67.

Të veçantët (el khauas) dhe të zakonshmit (el auam) në shoqëri

Vini re, të dashurit e mi, nëse shikoni shoqërinë njerëzore, çfarëdo shoqërie qoftë, në çdo qytet apo vend, do të shihni se njerëzit, nga një këndvështrim i caktuar, ndahen në dy kategori: një kategori **që vepron** me mendim, kuptim, vetëdije dhe vullnet. Ajo e njeh rrugën e saj dhe e ndjek atë. Nuk po flasim këtu, nëse rruga që ndjek kjo kategori, është e drejtë apo e gabuar. Këtë kategori mund ta quajmë “të veçantët” (el khauas).

Ndërsa kategoria tjetër nuk përpiket të kuptojë se cila është rruga e drejtë apo cili është qëndrimi i saktë. Nuk i intereson të kuptojë, të analizojë, të krahasojë apo të dallojë. Ata vetëm ndjekin atmosferën e përgjithshme dhe prirjet e shumicës. Le ta quajmë këtë kategori “të zakonshmit” (el auam). Pra, shoqëria mund të klasifikohet në të veçantë dhe të zakonshëm. Kjo ndarje nuk duhet të ngatërrohet me diçka tjetër.

Cilët janë të veçantët (el khauas)? A janë një klasë e caktuar shoqërore?

Jo! Sepse kjo kategori që e quajmë “të veçantët” përfshin njerëz të arsimuar dhe të paarsimuar. Nganjëherë, mund të jetë ndër të veçantët një person i paarsimuar, por që e kupton se çfarë duhet të bëjë dhe vepron në përputhje me një plan dhe një vullnet, edhe nëse nuk ka ndjekur shkollë, nuk ka diplomë dhe nuk vesh rroba të dijetarëve, por ai e kupton realitetin dhe të vërtetën.

Në ditët e shpërthimit të Revolucionit, para fitores së tij, unë isha në mërgim, në qytetin Iranshahr. Në një nga qytetet aty afër, ishte një grup personash, përfshirë edhe një shofer, që ishin të kulturuar dhe të vetëdijshëm. Edhe pse në pamje të jashtme mund të klasifikoheshin si nga populli i thjeshtë (*el auam*), në të vërtetë, ishin nga të veçantët (*el khauas*).

Ata vinin rregullisht të më takonin në Iranshahr dhe më rrëfenin bisedat e tyre me dijetarin fetar të qytetit të tyre, një njeri i mirë, por që ishte nga të zakonshmit.

Vini re: Shoferi i kamionit ishte nga të veçantët, ndërsa ai dijetari i respektuar, imami i xhematit, ishte nga të zakonshmit.

Dijetari thoshte: “Kur përmendet emri i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dërgimi i një here salavat mjafton, ndërsa kur përmendet emri i Imam Khomeinit, pse ju dërgoni salavat për Profetin tri herë? A nuk kuptoni?” Shoferi i përgjigjej: “Ditën që të mbarojë përballja dhe Islami të sundojë kudo dhe revolucioni të ketë fituar, do të ndalojmë së bëri salavat tri herë, kur të përmendet emri i Imam Khomeinit, madje nuk do ta bëjmë as një herë të vetme. Këto tri salavate janë një formë përballjeje dhe qëndrese”. Shikoni: edhe pse ishte një shofer, ai e kuptonte të vërtetën, ndërsa ai dijetari nuk e kuptonte.

Tiparet e të veçantëve (el khauas)

E përmenda atë shembull, për të kuptuar se, kur themi “të veçantët”, nuk nënkuptojmë një kategori njerëzish që veshin një rrobë të caktuar. Mund të jetë burrë apo grua, mund të jetë i pasur apo i varfër, mund të jetë punonjës në institucionet shtetërore apo mund të jetë kundërshtar i regjimit shtypës. Fjala “të veçantët” i përfshin si të mirët, ashtu edhe të këqijtë mes tyre. Më pas, edhe brenda grupit të të veçantëve, do t’i ndajmë ata në nëngrupe të tjera.

Të veçantët janë ata që, kur veprojnë ose mbajnë një qëndrim, e bëjnë këtë me vetëdije, mendim dhe analizë. Ata e kuptojnë, e vendosin dhe e dinë se çfarë po bëjnë, e zgjedhin rrugën e tyre me mendje dhe shqyrtim.

Ndërsa ata që qëndrojnë përballë tyre, janë të zakonshmit (el auam). Ata nuk analizojnë situatat, por ecin thjesht me rrjedhën e ujit: Kur njerëzit thërrasin “vdekje për...”, edhe ata thërrasin po njësoj. Kur shohin se masa thotë “rroftë...”, ata i bashkohen turmës. Kur atmosfera është në një drejtim, shkojnë atje; kur ajo ndryshon, kthehen në kahun tjetër.

Varësia e të zakonshmëve nga rrethanat

Le të imagjinojmë se kushëriri i Imam Hysenit, Muslim ibn Akili, hyri në Kufe. E çfarë ndodhi? Njerëzit thanë: “Erdhi i dërguari i Beni Hashimit, i dërguari i Imam Hysenit, ai që është i

vendosur për kryengritje dhe ndryshim". Ata u grumbulluan rreth tij dhe e mbështetën, tetëmbëdhjetë mijë veta i dhanë besën.

Por, pas pesë apo gjashtë ditësh, krerët e fiseve hynë në Kufe dhe u thanë njerëzve: "Përse e morët këtë qëndrim? A e kuptoni se do të paguani një çmim shumë të shtrenjtë?!" Në atë moment, njerëzit filluan të tërhiqeshin: "Kë do të mbronin? Dhe kundër kujt?" Pastaj guvernatori, Ibn Zijadi, e rrethoi shtëpinë e Tuas, për të kapur Muslimin. Po ata njerëz që e mbështetën më parë, dolën vetë për ta luftuar Muslimin. Këta janë të zakonshmit (el auam): veprimet e tyre nuk burojnë nga mendimi apo analiza e drejtë, ata lëvizin sipas rrymës dhe atmosferës së përgjithshme.

Të veçantët (el khauas) në frontin e të drejtës dhe të së kotës

Pra, në çdo shoqëri ka të veçantë dhe të zakonshëm. Le ta lëmë mënjane çështjen e të zakonshmëve dhe të shqyrtojmë gjendjen e të veçantëve.

Të veçantët ndahen, gjithashtu, në dy grupe:

1. Të veçantët që janë në anën e të drejtës;
2. Të veçantët që janë në anën e të pavërtetës (së kotës).

A nuk është kështu?

Njerëzit e kulturuar, me mendim e dituri, kur janë në anën e të drejtës, e njohin të vërtetën dhe e kuptojnë se ajo është në atë anë, prandaj edhe veprojnë për të. Ata e dallojnë të drejtën dhe

janë në gjendje ta identifikojnë atë, këta janë të veçantët në anën e të drejtës.

Por nga ana tjetër, ka edhe të veçantë që janë në anën e kundërt, në anën e të pavërtetës.

Po të kthehemi në periudhën e hershme të Islamit, shohim dy grupe: Njëri ishte grupi i mbështetësve të Imam Aliut, Imam Hysenit dhe Beni Hashimit. Ndërsa tjetri ishte grupi i mbështetësve të Muavijes. Edhe në anën e Muavijes kishte të veçantë, njerëz të mençur, me mendim dhe strategji, që mbështesnin Beni Umejen. Edhe ata ishin nga të veçantët, por të veçantët e të pavërtetës.

Pra, të veçantët në çdo shoqëri ndahen në dy kategori: Të veçantët që janë mbështetës të së drejtës dhe të veçantët që janë mbështetës të së pavërtetës.

Çfarë mund të presim nga të veçantët që mbështesin të pavërtetën? Asgjë tjetër përveç komplotit kundër të drejtës dhe kundër jush. Prandaj, detyra juaj është t'i luftoni ata. Luftoni të veçantët që mbështesin të pavërtetën. Kjo është një çështje pa diskutim.

Të veçantët nga mbështetësit e të drejtës

Tani kalojmë te të veçantët nga mbështetësit e të drejtës. Unë po ju flas tani, shikoni veten tuaj dhe shihni se në cilin pozicion ndodheni. Kur themi se është thelbësore ndjekja me

vetëdije dhe mendimi, nuk duhet të ngatërrojmë historinë me tregimin. Historia është një anë tjetër e rrugëtimit tonë personal.

Histori do të thotë unë dhe ti, do të thotë ne që jemi sot këtu. Nëse jemi ne ata që e tregojmë dhe e shpjegojmë historinë, atëherë secili prej nesh duhet ta gjejë veten në këtë histori, të kuptojë se ku ndodhet brenda saj. Pastaj të shohim: çfarë bënë ata që, në atë kohë, ishin në pozitën që jemi ne sot dhe përse humbën? A mos vallë gabuan në një pikë? Duhet ta njohim këtë gjë, që të mos e përsërisim ne të njëjtin gabim.

Ashtu siç është zakon në mësimet ushtarake: Simulohet një kundërshtar dhe krahasohet me palën tonë. Më pas vëzhgohet plani ynë: mund të shihet që mendja që e ka hartuar planin, ka bërë një gabim në këtë pikë, prandaj, kur ju të bëni planin, duhet ta shmangni atë gabim. Ose ndodh që plani të ketë qenë i saktë, por urdhërdhënësi, informatori, lajmëtari apo edhe një ushtar i thjeshtë në rreshtat tanë bën një gabim. Në këtë rast, ju e kuptoni se duhet ta shmangni atë gabim, edhe nëse nuk ka qenë në nivelin e planit. E tillë është rrjedha e historisë. Tani, ju duhet ta gjeni veten në këtë skenë, që po e përshkruaj nga fillimi i Islamit.

Disa njerëz, nga shtresa e zakonshme, nuk janë në gjendje të marrin vendime. Fati i tyre varet nga koha dhe rrethanat. Nëse ndodh që të jenë në një epokë, ku udhëheqja është në dorën e një imami të drejtë, si Imam Aliu ose Imami i ndjerë Khomeini dhe ky udhëheqës i çon drejt Xhenetit, atëherë është mirë për ta. Këta njerëz, të udhëhequr nga të drejtët, përfundojnë (me ndihmën e Allahut) në Xhenet.

Por, nëse ndodh që epoka e tyre të përkojë me një *Ashure* të një kohe, ku udhëheqja është në duart e atyre që Allahu në Kur'an i përshkruan kështu: **“Dhe Ne i bëmë ata udhëheqës që thërrasin drejt Zjarrit...”**³², apo, **“A nuk e ke parë atë që e ndërroi mirësinë e Allahut me mosbesim dhe e çoi popullin e tij drejt shkatërrimit? Xhehenemi do të jetë vendbanimi i tyre, sa vend i shëmtuar për qëndrim!”**³³, atëherë fundi i tyre është Zjarri.

Kujdes, mos u bëni nga masa e zakonshme!

Prandaj, kujdes mos bëheni pa vetëdije, pjesë e të zakonshmëve. Me këtë nuk duam të themi se duhet të përfundoni studime të larta, aspak! Unë tashmë kam thënë se kuptimi i popullit të zakonshëm, pa vetëdije (aumëve) nuk është ky. Sa e sa njerëz kanë përfunduar nivelet më të larta të arsimit, por sërish janë pjesë e masës së zakonshme! Po ashtu, sa e sa janë ata që kanë studiuar shkencat fetare, por janë nga të njëjtit “aum”. Sa e sa të varfër apo të pasur, janë pjesë e kësaj shtrese.

Të qenit nga masa është çështje që varet nga vullneti yt dhe imi. Prandaj duhet të kemi kujdes që të mos jemi nga ata. Çdo vepër që bëjmë, duhet të jetë me vetëdije.

Kushdo që vepron pa vetëdije, është nga masa. Për këtë arsye, në Kur'an thuhet përmes gjuhës së të Dërguarit të Allahut: **“Thuaj:**

³² Sure “Kasas”, ajeti 41.

³³ Sure “Ibrahim”, ajeti 28.

Kjo është rruga ime: të ftoj drejt Allahut me dituri të plotë, unë dhe çdokush që më pason mua....”³⁴

Prandaj, shikoni, së pari, veten tuaj, a jeni nga masa e zakonshme apo jo? Nëse jeni nga ajo shtresë, nxitoni të dilni prej saj. Përpiquni të fitoni aftësinë për të analizuar, për të kuptuar dhe për të qenë të vetëdijshëm.

Por, nëse jeni nga të veçantët (elita e vetëdijshme), atëherë shikoni e thoni: A jemi nga të veçantët që janë mbështetës të së vërtetës apo të gabimit (të së kotës)?

Çështja këtu është shumë e qartë: Të veçantët, në shoqërinë tonë, janë pa dyshim nga mbështetësit e të vërtetës. Ata thërrasin njerëzit drejt Kur’anit, drejt Sunetit (traditës profetike), drejt Ehli Bejtit (familjes së Profetit), drejt rrugës së Zotit dhe drejt vlerave islame. Kjo është natyra e Republikës Islamike. Prandaj, nuk do të flasim tani për të veçantët, që janë në anën e të kotës, nuk kemi punë me ta, për momentin.

Tërësisht, fjala jonë është për të veçantët nga mbështetësit e të drejtës. Pikërisht këtu fillon i gjithë problemi.

Të veçantët (elita) që mbështesin të vërtetën dhe lidhja e tyre me dynjanë

Nëse ata janë pakicë, ajo kategori e të veçantëve, pra mbështetësit e të vërtetës, janë shumicë, por, në të njëjtën kohë,

³⁴ Sure “Jusuf”, ajeti 108.

rrëzohen shpirtërisht përballë joshjeve të kësaj bote, si: pasuria, shtëpia, fama, pozita, pushteti dhe largohen nga rruga e Zotit për interesat personale, atëherë ata qëndrojnë në heshtje, kur duhet të thonë të vërtetën, për të ruajtur jetën e tyre, pozitat, punët, pasuritë ose për dashurinë ndaj fëmijëve, familjes, të afërmve, miqve...

Nëse këta janë shumicë, atëherë mjerë për ne! Sepse atëherë, ata që ndjekin rrugën e Hysenit, do të shkojnë drejt tokës së dëshmorëve dhe do të theren si kurbanë, ndërsa ndjekësit e Jezidit do të marrin pushtetin në duar.

Beni Umeja sundoi shtetin që e themeloi i Dërguari i Zotit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe mbretërimi i tyre zgjati një mijë muaj, që do të thotë nëntëdhjetë vjet dhe udhëheqja shpirtërore do të kthehet në një mbretëri dhe pushtet sundues.

Shndërrimi i shoqërisë islame në një shoqëri monarkike

Shoqëria islame është një shoqëri e imametit, që do të thotë se imami (udhëheqësi shpirtëror e moral) është në krye të pushtetit dhe njerëzit i binden atij me zemër, me besim dhe bindje shpirtërore. Ndërsa sundimtari (mbreti) është krejt ndryshe. Ai sundon me forcë, me pushtet të imponuar dhe njerëzit nuk e besojnë, nuk e pranojnë dhe nuk ndiejnë afërsi ndaj tij. Këtu e kemi fjalën për njerëzit me vetëdije dhe kuptim.

Beni Umeja e shndërroi imametin në mbretëri dhe e sundoi shtetin islam për 90 vjet. Më pas u hodhën themelet e një sistemi të brishtë, i cili më vonë çoi në një revolucion kundër Beni Umejes, që ra nga pushtetit. Në pushtet erdhën Beni Abasitët, të cilët e sunduan botën islame për gjashtë shekuj, pra 600 vjet, duke u paraqitur si “pasardhës të të Dërguarit të Allahut”.

Por Beni Abasitët, më saktë, mbretërit e tyre, u morën me korrupsion, degjenerim moral, pije alkoolike, amoralitet, imoralitet, ligësi, grumbullim pasurie, qejfe, dëfrime dhe mijëra mëkatesh të tjera. E megjithatë, edhe ata shkonin në xhami, siç bëjnë zakonisht mbretërit e botës dhe udhëhiqnin namazin (si imamë të lutjes). Njerëzit faleshin pas tyre nga halli, edhe nëse nuk ishin aq të detyruar, ose për shkak të një besimi të shtrembër. Kjo në fund çoi në rrënimin e besimit të njerëzve.

Mallkimi i atij që mbolli farën e parë

Nëse të gjithë ose shumica e të veçantëve (elitës) që mbështesin të drejtën në një shoqëri të caktuar, kanë frikë për jetën e tyre, për humbjen e pasurisë, pozitës, autoritetit apo statusit shoqëror, ose kanë frikë nga izolimi, për shkak të lidhjes së tyre me dynjanë, atëherë ata nuk e mbështesin më të drejtën dhe nuk janë të gatshëm të sakrifikojnë veten e tyre.

Kur çështjet arrijnë në këtë pikë, atëherë ndodh, në krye të gjithçkaje, martirizimi i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) në atë formë tragjike. Në fund, vjen sundimi i Beni Umejes dhe grupit

mervanit. Pas tyre Beni Abasitët e më pas një varg sulltanësh që sunduan botën islame deri në ditët e sotme.

Shikoni sot botën islame dhe disa vende myslimane: vëzhgoni kush i sundon ato: mëkatarë, të korruptuar e të degeneruar. Njësoj edhe në vende të tjera.

Prandaj, në Zijaretin e Ashures,³⁵ thuhet: “O Zot, mallko të parin që i bëri padrejtësi të drejtës së Muhamedit dhe familjes së tij”. Kjo është e vërteta.

Mirë, u afruam disi në analizimin e ngjarjes së Ashures, e cila përmban shumë mësim. Pasi e dëgjuat këtë hyrje, tani kalojmë te historia.

³⁵ Zijareti i Ashurás është një lutje e veçantë (zijārah – vizitë shpirtërore) që recitohet më 10 Muharrem, ditën e Ashurás, në kujtim të Imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të!) dhe dëshmorëve të tjerë të Karbalasë.

Përfitimet materiale – pika e nisjes së rrëshqitjes së elitës që mbështet të drejtën

Rrëshqitja e elitës që mbështeste të drejtën, filloi pas vdekjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), rreth gjashtë, shtatë ose tetë vite më vonë. Fjalët e mia këtu janë pa e përfshirë fare çështjen e kalifatit. Ajo është një temë më vete. Këtu po flas për këtë rrugë (rrëshqitëse), për shkak të rrezikut të madh që ajo bart.

Gjithçka ndodhi rreth shtatë vite pas vdekjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Shenjat e para u shfaqën, kur thanë: “Nuk është e drejtë që ata që kanë përparësi në Islam, që ishin shokët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe morën pjesë në luftërat e tij, të trajtohen njësoj si njerëzit e tjerë”.

Kështu, u dhanë atyre privilegje materiale nga pasuria publike (Bejtul Mal).

Kjo ishte tulla e parë. Kështu ndodhin zakonisht të gjitha devijimet, fillojnë nga një pikë e vogël, por më pas rriten dhe përhapen me çdo hap të mëtejshëm.

Devijimet nisën këtu, derisa arritën kulmin në kohën e Osmanit, kur gjërat u përkeqësuan aq shumë, sa në mesin e sundimit të kalifit të tretë, disa nga shokët e mëdhenj të Profetit, u bënë më të pasurit e kohës së tyre. Pra, shokë të njohur, si: Talha, Zubejri, Sa’d ibn Ebi Vekasi dhe të tjerë si ata, u bënë kapitalistë të

klasit të parë. Madje njëri prej tyre, kur vdiq dhe donin t'ua ndanin pasurinë trashëgimtarëve, ishin të detyruar të copëtonin shufrat e arit që ai kishte shkruirë, ashtu siç copëtohet druri me sëpatë. E shihni deri ku kishte arritur gjendja në atë kohë historike...

Shkaqet e problemeve në kohën e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*)

Kjo nuk është diçka që thonë vetëm shi'itët në librat e tyre, por është ajo që shkruajnë të gjithë. Shumat e mëdha të parave, dinarëve dhe dirhemëve, që ata lanë pas, ishin shuma jashtëzakonisht të mëdha. Kjo situatë shkaktoi ato ngjarje gjatë kohës së Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*)..

Disa njerëz, duke i dhënë rëndësi shumë të madhe pozitës, hynë në konflikt me të. Gjithashtu, kishin kaluar pesëmbëdhjetë vjet nga vdekja e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe shumë gabime dhe ngatërresa filluan të shfaqen.

Nëse nuk do të ishte kjo periudhë prej 25 vjetësh, nuk do të kishte pasur kurrë ndonjë problem për Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), në ndërtimin e atij shoqërie. Por ai u përball me një shoqëri të tillë: njerëz, shërbëtorë dhe të afërm dhe një fe, në të cilën disa prej njerëzve quheshin ata që "marrin pasurinë e Zotit" (d.m.th, e keqpërdorin pasurinë e komunitetit).

Kjo është një shoqëri, ku vlerat humbën mes dashurisë për dynjanë dhe ku besimtarët hasën shumë vështirësi, kur donin të udhëhiqnin njerëzit drejt xhihadit (luftës për kauzën e drejtë).

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu dhe Imami Hyseni (*Paqja qoftë mbi ta!*) nuk i përtypin hidhërimet që vijnë nga të veçantët (el khauasu)

Shumica e të veçantëve në kohën e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ishin prej atyre që e mbështesnin të vërtetën, domethënë ata që e njihnin të vërtetën, por i jepnin përparësi dynjasë mbi Ahiretin. Kjo ishte arsyeja që ai hyri në tri beteja dhe periudha e sundimit të tij, që zgjati katër vjet e nëntë muaj, përfundoi me këto tri beteja, derisa në fund u martirizua nga dora e një fatkeqi.

Gjakut i Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), është i çmuar, ashtu si edhe gjaku i Imami Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Në Zijaretin e Ashures lexojmë: “Paqja qoftë mbi ty, o gjak hakmarrës i Allahut dhe biri i gjakut hakmarrës të Tij!” Kjo do të thotë se Allahu i Madhëruar është zotëruesi i gjakut të Imami Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i gjakut të babait të tij, Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Një shprehje e tillë nuk është përdorur për askënd tjetër përveç tyre.

Është e vetëkuptueshme se për çdo gjak të derdhur ka një hakmarrës, i quajtur “ualiu’d-demm” (zotëruesi i gjakut). Tek arabët, babai është zotërues i gjakut të të birit, biri është zotërues i gjakut të babait dhe vëllai për vëllanë. Kjo quhet hakmarrje dhe të drejtën e kërimit të gjakut e quajnë “the’run”. Ai që kërkon hakmarrje për gjakun e Imamit Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), është vetë Allahu i Madhëruar, ashtu siç është edhe Ai që kërkon hakmarrje për gjakun e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Pra, zotëruesi i gjakut të këtyre dy personaliteteve, është Allahu i Madhëruar.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), u martirizua për shkak të atyre rrethanave dhe pas tij erdhi i biri, Hasani, të cilit nuk iu dha mundësia të qëndronte përballë atyre kushteve më shumë se gjashtë muaj, sepse ithtarët e tij e braktisën dhe e lanë të vetëm. Ai pa se, nëse do të nisej për të luftuar me Muavijen me atë pakicë që kishte dhe do të martirizohej, nuk do të kishte askush që do të kërkonte hakmarrje për të, për shkak të përhapjes së prishjes morale në shoqërinë islame dhe ndër të afërmit (besnikët e afërt). Propaganda, paratë dhe mashtrimet e Muavijes do të pushtonin të gjithë dhe njerëzit, pas një apo dy vjetësh, do të thoshin: “Imam Hasani nuk veproi mirë që sfidoi Muavijen”. Kjo do të thoshte që gjaku i tij do të shkonte kot. Prandaj, ai duroi të gjitha vështirësitë dhe nuk u hodh vetë në fushën e martirizimit.

Imami Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe zgjedhja më e vështirë

Ju e dini se ndonjëherë martirizimi është më i lehtë se të mbeturit gjallë. Këtë e kuptojnë mirë njerëzit e urtësisë, të saktësisë dhe të thellësive shpirtërore. Ndonjëherë, jeta dhe veprimi, në disa rrethana, bëhen shumë më të vështira se sa vdekja, dëshmia dhe takimi me Allahun. Por Imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*) zgjodhi rrugën më të vështirë. Në ato rrethana, elita e shoqërisë ishte gati duke u rrëzuar dhe nuk ishte e gatshme të ndërmerrnin asnjë veprim.

Për këtë arsye, kur Jezidi mori pushtetin, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u ngrit kundër tij, sepse Jezidi, me cilësitë e tij të këqija, mund të luftohej lehtë. Nëse dikush do të vritej në luftë kundër tij, gjaku i tij nuk do të shkonte kot. Rrethanat në kohën e Jezidit nuk linin asnjë mundësi tjetër përveçse rrugës së revolucionit, ndryshe nga koha e Imam Hasanit (*Paqja qoftë mbi të!*), në të cilën kishte dy mundësi: rruga e martirizimit dhe rruga e jetës. Në atë kohë, të mbeturit gjallë ishte më me shpërblim, më i dobishëm dhe më i vështirë se vdekja. Imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*) zgjodhi rrugën më të vështirë.

Por situata nuk ishte kështu në kohën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Nuk kishte asnjë mundësi tjetër, përveçse revolucionin. Të mbeturit gjallë, që do të nënkuptonte mosrevolucionin, nuk kishte asnjë kuptim në atë kohë. Ai duhej të ngrihej, pa marrë parasysh, nëse do të merrte pushtetin apo do të

përfundonte i martirizuar. Ai duhej ta tregonte rrugën dhe të vendoste shenjë drejt saj, që të bëhej e qartë se, kur gjërat arrijnë në këtë pikë, është e domosdoshme të veprohet në atë drejtim.

Roli vendimtar i të veçantëve (*elita*)

Kur u ngrit Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), shumë prej këtyre të veçantëve (elitës) nuk erdhën për ta ndihmuar, pavarësisht pozitës së tij madhështore në shoqërinë islame. Vëreni sa i madh është dëmi që shkakton prania e këtyre të veçantëve në shoqëri, të veçantë që e vënë përparësinë e dynjasë së tyre mbi fatin e gjithë botës islame për shekuj me radhë dhe kjo përkundër pozitës dhe famës që kishte Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*).

Po i shikoja çështjet e revolucionit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe lëvizjes së tij që nisi nga Medina dhe vura re se në natën, para se të nisej nga Medina, edhe Abdullah ibn Zubejri kishte dalë nga qyteti. Në të vërtetë, të dy ishin në të njëjtën pozitë, por çfarë ndryshimi ka mes Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Abdullah ibn Zubejrit?

Fjalët e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), qëndrimi i tij, ishin aq të fuqishme, sa që ai i foli guvernatorit të Medinës (qeveritarit të atëhershëm, Velidit) me qetësi, pa servilizëm, dhe e këshilloi që të mos përdorte ashpërsi ndaj tij. Sa herë që Mervani ndërhynte me ndonjë fjalë, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ia

kthente ashpër dhe kërcënueshëm, saqë Mervani nuk kishte çfarë të bënte tjetër, veçse të heshtte i poshtëruar.

Ndërkohë, të njëjtët persona që nuk guxuan të përballeshin me Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), shkuan dhe rrethuan shtëpinë e Abdullah ibn Zubejrit. Ai dërgoi të vëllain për t'u folur dhe kërkoi leje nga ata që të shkonte vetë nesër në pallatin e qeveritarit. Por ata e fyen, e kërcënuan se, nëse nuk dilte vetë, do ta vrisnin, deri sa ai u nënshtua dhe iu lut që t'i lejonin të dërgonte vëllain e tij dhe të vinte vetë ditën tjetër.

Madhështia e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*)

Edhe pse Abdullah ibn Zubejri ishte një figurë e shquar, qëndrimi i tij ishte i ndryshëm nga ai i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Askush nuk guxonte të sillej me Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) ose ta drejtonte fjalën me një mënyrë mosrespektuese, për shkak të nderit që ai gëzonte dhe madhësisë së personalitetit të tij, autoritetit dhe fuqisë së tij shpirtërore.

Në rrugën e tij për në Mekë, kushdo që e takonte dhe fliste me të, i drejtohej me fjalët: "Të bëhem kurban për ty!", ose "Babai dhe nëna ime qofshin flijuar për ty!", ose "Xhaxhai dhe daja im qofshin kurban për ty!", kështu i flisnin Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Ai kishte një pozitë të veçantë dhe të dalluar në shoqërinë islame.

Një ditë erdhi te ai, në Mekë, Abdullah ibn Muti' dhe i tha: "O biri i të Dërguarit të Allahut! Nëse ti ngrihesh kundër tyre (pushtetarëve), pas teje do të na robërojnë. Këta njerëz nuk na sulmojnë tani, vetëm sepse kanë frikë dhe respekt për ty. Por nëse ti rebelohesh dhe vritesh, ata do të na trajtojnë si skllevër".

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) gëzonte një pozitë të lartë dhe madhështore, për të cilën nënshtroheshin edhe figura të mëdha, si: Abdullah ibn Abasi, Abdullah ibn Xhaferi, madje edhe Abdullah ibn Zubejri. Ky i fundit, edhe pse nuk e shikonte Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) me sy të mirë, përsëri tregonte për të nderim dhe respekt të madh.

Të gjithë të mëdhenjtë dhe të afërmit e të vërtetës, pra ata që nuk ishin në anën e qeverisë umajase dhe nuk ishin pjesë e frontit të padrejtësisë, përfshirë shumë nga shi'itët që besonin në udhëheqjen e Aliut dhe e konsideronin atë kalifin e parë legjitim, kur ndjenë dhunën e pushtetit në fuqi, u zbrapsën, duke dashur të ruajnë veten, pasurinë dhe pozitat e tyre. Si pasojë e kësaj zbrapsjeje, nga ana e elitës, shumica e njerëzve të zakonshëm u anuan nga e pavërteta.

Lëvizja e masave ndjek lëvizjen e elitës

Po të hedhim një vështrim mbi emrat e banorëve të Kufes, që i shkruan letra Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e ftuan të shkonte tek ata, do të shohim se të gjithë ishin nga shtresa e elitës,

nga të mëdhenjtë dhe krerët e njerëzve. Numri i letrave ishte i madh, arriti qindra faqe, ndoshta mbushnin disa karroca. Shumica e atyre që i kishin shkruar, ishin nga paria dhe krerët e qytetit. Nga toni i atyre letrave kuptohet se sa prej elitës ishin përkrahës të së vërtetës dhe të gatshëm për të sakrifikuar dynjanë për hir të fesë, këtë e kuptojmë nga përmbajtja e tyre.

Por, meqë numri i atyre që ishin të gatshëm të sakrifikonin fenë, për hir të dynjasë, ishte më i madh, rezultati përfundoi me vrasjen e Muslim ibn Akilit në Kufe, megjithëse ai kishte marrë besën nga tetëmbëdhjetë mijë vetë dhe më pas me vrasjen e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) në Qerbela.

Të vetëdijshmit dhe madhështia e kësaj lëvizjeje

Kjo do të thotë se lëvizja e elitës sjell pas vetes lëvizjen e masave. Nuk e di, a e kuptojmë siç duhet madhështinë e kësaj të vërtete, që gjithmonë ndjek njerëzit e vetëdijshëm?

Me siguri keni dëgjuar për atë që ndodhi në Kufe: populli i atjeshëm i kishte shkruar letra Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), duke i thënë: “Eja tek ne, i nderuar!” Atëherë ai dërgoi Muslim ibn Akilin për të parë gjendjen nga afër dhe për të vlerësuar, nëse ishte e përshtatshme të vinte vetë.

Muslimi shkoi në Kufe dhe qëndroi në shtëpitë e prijësve të shi'itëve; u lexoi atyre letrën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe njerëzit filluan të vinin në grupe për t'i shprehur besnikëri.

Në atë kohë, guvernatori i Kufes ishte Numan ibn Bashiri, një njeri i dobët dhe paqësor, i cili deklaroi se nuk do të luftonte me askënd, përveç nëse sulmohej. Ai nuk ndërmori asnjë veprim kundër Muslim ibn Akilit. Kur njerëzit panë se rruga ishte e lirë, filluan të shkonin te Muslimi dhe i dhanë besën.

Por disa nga elita që përkrahnin të pavërtetën, përkrahës të umajadëve, i dërguan një letër Jezidit për ta informuar se, nëse kishte ndonjë interes në Kufe, duhet të caktonte një njeri të vendosur dhe të fuqishëm si guvernator, pasi Numan ibn Bashiri nuk ishte i aftë për t'u përballur me Muslim ibn Akilin.

Jezidi i shkroi Ubejdullah ibn Zijadit, i cili në atë kohë ishte guvernator i Basrës, duke e emëruar, gjithashtu, guvernator të Kufes, përveç postit që kishte në Basra. Ubejdullahu menjëherë u nis nga Basra për në Kufe. Këtu, gjithashtu, del në pah roli i elitës, të cilët e hapën rrugën për ndodhitë që pasuan. Nëse është e nevojshme, mund të shtjellojmë më tej një pjesë të kësaj ngjarjeje.

Masat lëvizin pa analizë

Ubejdullah ibn Zijadi arriti në afërsi të Kufes gjatë natës. Sapo njerëzit panë një njeri me fytyrë të mbuluar, që po vinte me kalë dhe pajisje ushtarake, masat e thjeshta menjëherë menduan se ishte Imam Hyseni. Ata iu afruan me shumë thjeshtësi dhe e përshëndetën: *"Paqja qoftë mbi ty, o biri i të Dërguarit të Allahut!"*

Kjo është tipike për njerëzit e thjeshtë. Ata nuk kanë aftësi për të analizuar apo për të gjykuar situatën. Sapo panë dikë që po vinte me ushtri e pajisje, menjëherë menduan se ishte Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), pa e dëgjuar as të thotë një fjalë. Të gjithë filluan të përsërisnin: “Ky është Imam Hyseni!”, ndërkohë që duhet të kishin reflektuar për të njohur se kush ishte në të vërtetë.

Por, ky që kishte ardhur, nuk iu drejtua aspak njerëzve dhe shkoi drejt pallatit të qeverisë. Aty u paraqit dhe hyri brenda, duke filluar që prej andej të planifikonte shtypjen e lëvizjes së Muslim ibn Akilit. Ai u përqendrua në përdorimin e mënyrave më të ashpra të presionit, kërcënimeve dhe torturave kundër mbështetësve të Muslim ibn Akilit. Me mashtrim e thirri Hani ibn Urvetun në pallat dhe e goditi në kokë dhe në fytyrë.

Kur një grup njerëzish u mbledh rreth pallatit për ta mbështetur, ai arriti t’i shpërndajë me mashtrime dhe gënjeshtër. Këtu shfaqet, edhe një herë roli i elitës së korruptuar, që quhet përkrahëse e të vërtetës. Ata e njohën dhe e dalluan të vërtetën, por e lanë pas dore, për hir të dynjasë.

Pas kësaj, Muslim ibn Akili marshoi me një turmë të madhe mbështetësish. Sipas librit të Ibn Ethirit, numri i tyre arriti në tridhjetë mijë vetë. Vetëm ata që ishin rreth shtëpisë së tij, arritën në katër mijë persona, të armatosur me shpata, për ta mbrojtur. Kjo ndodhi ditën e nëntë të muajit Dhul Hixhe.

Ubejdullah ibn Zijadi nxitoi të fuste përçarës dhe mbështetës të pushtetit (elitën e së keqes) në mesin e tyre, për të përhapur frikë dhe panik. Ata filluan të përhapin thashetheme se

Beni Umeje zotëronin gjithçka: armë, pasuri dhe fuqi, ndërsa këta (mbështetësit e Muslimit) nuk kishin asgjë. Frika u përhap mes njerëzve dhe ata filluan të largoheshin gradualisht nga Muslimi. Kur erdhi koha e namazit të akshamit, nuk kishte mbetur askush me Muslim ibn Akilin.

Në atë moment, një lajmëtar i Ubejdullah ibn Zijadit shpalli: “Të gjithë duhet të paraqiten në xhaminë e Kufes, për të falur namazin e akshamit me guvernatorin!” Sipas burimeve historike, xhamia u mbush plot me njerëz që u falën pas Ibn Zijadit.

Përtesa e elitës që përkrahte të vërtetën

Pse përfunduan punët në atë mënyrë? Kur e shikoj situatën, shoh se kjo i atribuohet elitës, prej përkrahësve të së vërtetës, të cilët disa prej tyre ndoqën një rrugë që përfundoi në një përtesë të madhe dhe të rrezikshme. Ndër ta ishte edhe Shurejhi, gjykatësi. Ky nuk ishte nga Beni Umeje dhe e njihte mirë realitetin, e dinte kush ishte në të drejtë.

Kur sollën Hani ibn Urvetu, e goditën në kokë dhe e plagosën në fytyrë dhe më pas e hodhën në burg, fisi i tij u ngrit dhe rrethoi pallatin e Ibn Zijadit. Ibn Zijadi u frikësua nga tubimi i tyre, pasi ata e shihnin se ai kishte vrarë Hanin. Prandaj urdhëroi Shurejhin që të shkonte e ta shihte me sytë e tij, nëse Hani ishte gjallë.

Shurejhi shkoi dhe e pa me sytë e tij se Hani ishte gjallë, por i plagosur. Sapo Hani e pa Shurejhin, iu drejtua me një thirrje dëshpëruese, duke iu lutur myslimanëve për ndihmë: “Ku janë njerëzit e mi? A kanë vdekur? Pse nuk vijnë të më shpëtojnë nga kjo që jam duke përjetuar?” Shurejhi thotë: “Desha të dilja dhe t’i njoftoja njerëzit e mbledhur rreth pallatit, për fjalët e Hanit, por për fat të keq aty ishte një spiun i Ibn Zijadit dhe nuk munda”. Çfarë do të thotë “nuk munda”? Do të thotë se ai i dha përparësi dynjasë ndaj fesë.

Ndoshta, sikur Shurejhi të kishte folur me guxim, historia do të kishte ndryshuar. Po t’u kishte thënë njerëzve se Hani ishte gjallë, por në burg dhe se Ibn Zijadi donte ta vriste, në një kohë kur ende nuk kishte marrë plotësisht kontrollin, njerëzit do të kishin sulmuar dhe do ta kishin shpëtuar Haniun. Do të ishin forcuar dhe do ta kishin kapur Ibn Zijadin, duke e vrarë ose duke e dëbuar dhe Kufja do të ishte e hapur për Imam Hysenin. Dhe kështu nuk do të ndodhte tragjedia e Qerbelasë.

Po të mos kishte ndodhur Qerbelaja, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) do ta kishte marrë pushtetin. Edhe nëse do të kishte zgjatur vetëm nëntë muaj apo ndoshta më gjatë, do të kishte pasur një ndikim të madh dhe bekim të madh në historinë islame.

Një lëvizje e vetme ndonjëherë mund ta ndryshojë fytyrën e historisë, kurse një tjetër, që vjen nga frika, dobësia, dashuria për dynjanë dhe lakmia për jetë, mund ta çojë historinë drejt shkatërrimit. Ti, o Shurejhi gjykatës, pse nuk dëshmove për të vërtetën, kur e pe Hanin në atë gjendje? Ky është pikërisht roli i elitës që e vë përpara dynjanë përpara fesë.

Kur Ibn Zijadi urdhëroi krerët e fiseve të punonin për shpërndarjen e njerëzve që ishin rreth Muslimit, pse ata iu bindën urdhrit të tij? Ata nuk ishin të gjithë nga Beni Umeje e as kishin ardhur nga Shami (Siria). Madje disa prej tyre ishin nga ata që i kishin shkruar letra Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), si Shibth ibn Rebij, ky njeri kishte dërguar letër dhe e kishte ftuar Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) që të vinte. Por, ishte pikërisht ky, që më pas u urdhërua nga Ibn Zijadi, të shpërndajë njerëzit. Ai shkoi e filloi t'i dekurajonte, duke përdorur kërcënime, frikësime dhe tundime. Ai kontribuoi drejtpërdrejt në shpërndarjen e turmës.

Pse vepruan kështu?

Sikur dikush, si Shibthi ibn Rebij të kishte pasur frikë nga Allahu në atë moment vendimtar, në vend që të kishte frikë nga Ibn Zijadi, fytyra e historisë do të ishte ndryshe. Por këta u përpoqën të dekurajonin njerëzit dhe masa u shpërnda.

Por pse u shpërndanë edhe përkrahësit besimtarë të Muslimit? Edhe pse ndër ta kishte njerëz të mirë e të ndershëm, disa prej tyre, më vonë shkuan në Qerbela dhe u martirizuan atje, duke e shlyer gabimin e tyre. Ne sot po flasim për ta, pa përmendur emra. Por, gjithashtu, kishte edhe prej atyre që nuk erdhën në Qerbela. Disa nuk ishin në gjendje, disave nuk iu dha mundësia. Por, më pas u përfshinë në radhët e "Et Teuabin" (të penduarit).

Ndikimi i “të penduarve” në histori

Por, çfarë dobie pati veprimi i tyre, pasi ndodhi tragjedia e Qerbelasë dhe u vra nipi i të Dërguarit të Allahut? Historia filloi të marrë tatëpjetën që nga ajo ngjarje. Për këtë arsye, numri i pendestarëve ishte disa herë më i madh se numri i dëshmorëve të Qerbelasë.

Dëshmorët e Qerbelasë u vranë të gjithë në një ditë, edhe pendestarët u vranë të gjithë në një ditë. Por, siç vëreni, ndikimi që lanë pendestarët në histori, nuk i afrohet as një të mijtës së asaj që lanë dëshmorët e Qerbelasë, sepse ata nuk vepruan në kohën e duhur, vlerësimi dhe vendimi i tyre erdhi me vonë.

Pse e lanë Muslim ibn Akilin vetëm? Ai kishte ardhur si përfaqësues i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ata ia kishin dhënë besën. Këtu nuk po i drejtohem masës së popullit, por elitës: Pse, kur ra nata, e lanë të vetmuar, saqë ai u detyrua të kërkonte strehim në shtëpinë e një gruaje (Tu’a)?

Përtesa e elitës për të mbështetur Muslim ibn Akilin

Sikur elita të mos e kishte braktisur Muslimin... Edhe sikur vetëm njëqind burra të qëndronin me të, ta strehonin në shtëpinë e ndonjërit prej tyre dhe ta mbronin, do të kishte ndryshuar gjithçka.

Madje, edhe kur Muslimi ishte vetëm, ai rezistoi për disa orë, kur erdhën për ta arrestuar. Edhe pse kundërshtarët ishin të shumtë, ai arriti t'i zmbrapste disa herë. Po të kishte me vete vetëm njëqind vetë, a do të mund ta kapnin? Jo, sepse njerëzit do të ishin ngritur për t'i ndihmuar. Pra, elita dështoi këtu, sepse nuk u ngrit për të mbështetur Muslimin.

Shikoni: kudo që të shkoni në histori, përballeni me rolin e elitës. Është e qartë se vendimi i elitës në momentin e duhur, shikimi i saktë i situatës dhe braktisja e dynjasë, për hir të fesë, në momentin vendimtar, janë faktorë që mund ta shpëtojnë historinë dhe të ruajnë vlerat. Ky është veprimi i nevojshëm në kohën e duhur dhe vendin e duhur.

Por nëse koha kalon, vendimi i vonuar nuk sjell më dobi.

Shembulli i Algjerisë. Në Algjeri, pas zgjedhjeve, ku fitoi Fronti Islamik, ushtria mori pushtetin ditën e parë, me nxitjen e Amerikës dhe të tjerëve. Nëse udhëheqësit e Frontit Islamik do ta kishin nxjerrë popullin në rrugë, që në ditën e parë dhe të mos i kishin lënë të ardhurit në pushtet të forcoheshin, do ta kishin rrëzuar qeverinë ushtarake dhe do të kishin ngritur një shtet islam. Në atë kohë, regjimi ushtarak nuk kishte aq shumë forcë, as nuk ishte i aftë të merrte nën kontroll gjithçka. Por ata nuk morën

një vendim të tillë. Disa i zuri frika, të tjerët u treguan të dobët dhe disa menduan: “Na takon presidenca”, ose kishin arsye të tjera.

Imami dhe vendimi i tij vendimtar

Në pasditen e ditës së njëzet e një të muajit Behmen, të vitit 1357 (11 shkurt 1979), u shpall gjendja ushtarake në Teheran, por Imami Khomeini u bëri thirrje njerëzve që të dilnin në rrugë. Sikur Imami të mos e kishte marrë këtë vendim në atë moment vendimtar, Muhamed Reza (Shahu i Iranit) do të vazhdonte ta qeveriste këtë vend.

Sikur njerëzit, kur u shpall gjendja ushtarake, të ishin mbyllur në shtëpitë e tyre, atëherë do të kishin filluar nga vetë Imami, pastaj nga shkolla Refah (qendra revolucionare), pastaj nga zonat e tjera, do të kishin shkatërruar gjithçka. Do të kishin vrarë në Teheran gjysmë milioni njerëz dhe gjithçka do të kishte marrë fund, ashtu siç ndodhi në Indonezi, ku u vranë një milion njerëz dhe pastaj gjithçka u kthye si më parë, dhe ai njeri qëndron në pushtet deri më sot, me gjithë nderin dhe respektin që i jepej, pa lëvizur as një milimetër nga pozita e tij.

Por Imami mori vendimin e duhur në momentin kritik dhe në vendin e duhur.

Sikur elita të kishte kuptuar çfarë duhej bërë në kohën e duhur dhe ta kishte zbatuar atë, fytyra e historisë do të kishte

ndryshuar. Nuk do të kishte ndodhur që njerëz si Husen ibn Aliu të tërhiqeshin në fusha si ajo e Qerbelasë.

Edhe nëse elita e kishte keqkuptuar situatën, ose kishte vonuar në kuptim, ose e kishte kuptuar, por ishte përçarë, siç ndodhi me vëllezërit afganë, madje edhe nëse udhëheqësit ishin të aftë, por elita nuk u përgjigj, atëherë s'kishte për të ndodhur ndryshim.

Njëri nga elitarët tha: "Tani jemi të zënë". Një tjetër tha: "Lufta ka mbaruar, na lini të merremi me punët tona, të fitojmë kafshatën e gojës". Për disa vite mbloodhën pasuri të mëdha. Thanë: "U lodhëm nga lufta dhe bredhjet nga një front në tjetrin, njëherë në perëndim, njëherë në jug". Nëse elita sillet kështu, dijeni se historia do të përsëritë ngjarje si ajo e Qerbelasë!

Ku jeni ju? A jeni nga elita apo nga masa?

Allahu i Lartësuar ka premtuar ndihmën për ata që e ndihmojnë Atë. Nëse dikush çohet për hir të Allahut dhe bën çmos, fitorja do të jetë në anën e tij, jo domosdoshmërisht që çdo individ do të fitojë personalisht, por që një grup, kur ngrihet, do të arrijë fitoren.

Është e natyrshme që rruga do të ketë vështirësi, sakrifica dhe dhimbje, por në fund ka fitore, gjithashtu. Allahu thotë: "Allahu do t'i ndihmojë ata që e ndihmojnë Atë". Ai nuk thotë: "Do t'ju ndihmojmë pa derdhur gjak". Jo, kurrë!

Por thotë: “Vriten dhe vrasin, por fitojnë”. Kjo është një ligjësi hyjnore.

Kur kemi frikë për gjakun tonë, për nderin tonë, për pasurinë dhe familjen tonë, kur kemi frikë për rehatinë tonë dhe dëshirojmë një jetë komode, të fitojmë para dhe të kemi një shtëpi luksoze dhe, kur këto gjëra na ndalin nga veprimi, atëherë bëhet e qartë se edhe nëse njerëz si Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), që udhëheqin rrugën, do të martirizohen deri në njeriun e fundit, ashtu siç u martirizua Imam Aliu dhe Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Elita, elita, shtresa e veçantë

Shikoni, të dashurit e mi, ku qëndron pozicioni juaj. Nëse jeni nga elita dhe realisht jeni, atëherë bëni kujdes! Kjo është gjithçka që duam të themi. Natyrisht, kjo që po them, është një përmbledhje e një teme që meriton të studiohet në dy fusha:

Fusha e parë është ajo historike. Sikur të kisha kohë të mjaftueshme, do të merresha vetë me të. Por, për fat të keq, nuk ka më kohë për këtë tani. Prandaj, kjo fushë duhet të studiohet për të gjetur shembuj nga historia, ku elita nuk veproi kur duhej dhe të përmenden emrat e tyre. Po të kishim mundësi dhe të mos ju lodhja juve e vetveten, do t’ju flisja me orë për këto çështje dhe këta njerëz, kam shumë në mendje për këtë.

Ngjarjet historike janë të përsëritshme në çdo kohë

Fusha e dytë është zbatimi i këtyre parimeve në çdo kohë, jo vetëm në kohën tonë, por në çdo epokë, ku elita është dashur të veprojë sipas përgjegjësive të saj, por nuk e ka bërë. Kemi folur për rrezikun e ndjekjes së dynjasë nga ana e elitës, duhet të studiohet, se si të mos joshen nga kjo botë, duke përmendur shembuj të qartë dhe të prekshëm.

Të dashurit e mi!

Ecja në rrugën e Allahut gjithmonë ka kundërshtarë. Nëse ndonjëri prej këtyre elitave që përmendëm, dëshiron të ndër marrë një veprim të drejtë, menjëherë ngrihen të tjerë, nga po e njëjta elitë, për ta qortuar dhe për ta kritikuar rëndë për qëndrimin e tij, ashtu siç ndodhte edhe gjatë ditëve të revolucionit tonë.

Por elita duhet ta përballojë këtë. Kjo është një nga kërkesat themelore të luftës shpirtërore të elitës: durimi përballë qortimeve, kritikave dhe sulmeve, sepse gjithmonë do të përballen me akuza, shpifje dhe fyerje nga kundërshtarët.

O Zot, bëje përfundimin e jetës sonë të jetë martirizimi në rrugën Tënde!

Lus Zotin t'ju japë të gjithëve sukses dhe të bashkojë shpirtin e Imamit me profetët dhe të dashurit e Tij. Lus, gjithashtu, që populli iranian të qëndrojë i palëkundur në këtë rrugë të ndriçuar, që ka nisur. O Zot, na jep jetë në shërbim të Revolucionit Islam dhe vlerave islame dhe bëj që të vdesim në

këtë rrugë! O Zot, bëje vdekjen tonë një vdekje për Ty dhe ngriji gradat e dëshmorëve tanë të ndershëm, çdo ditë e më shumë! O Zot, shpërbleji me shpërblim të madh ata që sakrifikuan për këtë rrugë dhe jepu atyre shëndet e paqe! O Zot, jepu gradat më të larta atyre që duruan vështirësitë në këtë rrugë, atyre që ishin në robëri për një kohë, liroji ata që nuk janë liruar ende dhe, për ata që janë zhdukur dhe trupat e tyre nuk dihen ku janë, jep durim dhe shpërblim për familjet e tyre!

O Zot, për hir të Muhamedit dhe familjes së Muhamedit, na trego fuqinë Tënde në poshtërimin dhe shkatërrimin e Amerikës dhe të gjithë akseve të arrogancës globale dhe lakenjve të tyre! Jepi popullit iranian ëmbëlsinë e fitores mbi ta!

O Zot, plotësoji nevojat e myslimanëve, çliro vendet islame nga duart e të huajve dhe nga kolonizimi amerikan dhe zgjoi liderët e myslimanëve nga gjumi i tyre, shpëtoji ata nga llumi i epsheve dhe dëshirave!

O Zot, ashtu siç fshive Bashkimin Sovjetik, të kërkojmë që të fshish edhe pjesën tjetër të boshtit të arrogancës! O Zot, përfshiji me mëshirën dhe bekimet e Tua të gjithë ata që jetuan dhe vdiqën në këtë rrugë! O Zot, me mirësinë dhe bujarinë Tënde, prano të gjitha veprat dhe përpjekjet!

Dallimi midis të drejtës dhe të padrejtës – një detyrë e vështirë në jetën e njerëzimit³⁶

Në historinë e njerëzimit, çështja e dallimit midis të drejtës dhe të padrejtës ka qenë gjithmonë një nga çështjet më të vështira, veçanërisht në historinë e profetësisë. Të gjithë njerëzit dëshirojnë ta ndjekin të drejtën, ta zbatojnë atë dhe të qëndrojnë larg të padrejtës, përveç atyre që janë bërë lëndë djegëse për zjarrin e zemërimit hyjnor dhe janë shndërruar në pasqyrime të djallit.

Shumica e njerëzve, veçanërisht ata të arsyeshmit, të drejtët dhe me cilësi njerëzore, dëshirojnë t'i shmangen të keqes dhe të kapen pas së vërtetës. Por ta dallosh të drejtën, nuk është gjithmonë e lehtë.

Në një prej fjalimeve të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ku shpreh dhimbjen e tij, e përshkruan qartë këtë realitet, duke thënë: *“Sikur e padrejta të ishte ndarë krejtësisht nga e drejta, nuk do t’u fshihej njerëzve që kërkojnë të vërtetën. Sikur e drejta të ishte e pastër nga përzierja me të padrejtën, armiqtë do ta braktisnin menjëherë. Por merret pak nga kjo (e vërteta) dhe pak nga ajo (e padrejta), dhe përzihen, e aty djalli sundon mbi ithtarët e vet”*.³⁷

Ne kemi shijuar shpesh hidhësinë e pasojave të përzierjes midis të drejtës dhe të padrejtës në të gjithë historinë e profetëve dhe në historinë islame. Ndoshta një nga arsyt pse periudha e paqëndrueshmërisë dhe trazirave në këtë vend zgjati për më shumë se dy shekuj dhe nuk ishim në gjendje t’i jepnim një goditje

³⁶ “Hadithul Uilajeti”, vëll. 2, f. 189-190.

³⁷ “Nehxhul Belaga”, Ligjërata 50.

vendimtare kolonializmit, që të largohej dhe të mos kthehej më kurrë, është pikërisht kjo: ngatërrimi mes së drejtës dhe të padrejtës dhe mungesa e qartësisë së rrugës përpara umetit (popullit).

Për këtë arsye, populli iranian ka përjetuar shumë goditje për shkak të përzierjes së të drejtës me të padrejtën, qoftë gjatë lëvizjes kushtetuese, qoftë në ngjarjet që e paraprinë dhe ato që e pasuan.

Por lëvizja e udhëhequr nga dijetarët dhe populli, nën udhëheqjen e Imam Khomeinit (Zoti e lartësoftë fjalën dhe gradën e tij!), ngriti parulla të tilla që nuk lanë hapësirë për përzierje të së drejtës me të padrejtën.

Kjo ndarje u arrit përmes ndërgjegjësimit të popullit, që u rrit gradualisht gjatë pesëmbëdhjetë viteve dhe e dalloj të drejtën nga e padrejta. Revolucion i fitoi dhe pas fitores, Imam Khomeini (Zoti e lartësoftë fjalën dhe gradën e tij!) nuk lejoi më, që e drejta dhe e padrejta të ngatërroheshin mes tyre.

Standardi për të njohur të drejtën dhe të padrejtën

Nëse bëhet e mundur që të ngatërrohet e drejta me të padrejtën, atëherë nevojitet patjetër ekzistenca e kritereve për t'i dalluar ato. Nuk është e mundur që Allahu i Lartësuar t'i lërë njerëzit pa udhëzime dhe shenja të qarta.

Pra, cili është kriteri për të dalluar të drejtën nga e padrejta? Për këtë, duhet kërkuar në Kur'anin famëlartë, në hadithe (rregullat profetike) dhe në fjalët e të afërmve të Zotit dhe njerëzve të mëdhenj. Duhet domosdoshmërisht të njihet standardi për të bërë këtë dallim.

Ka raste të shumta në Kur'an dhe në traditën profetike që e thonë qartë: Çdo gjë që përputhet me sheriatin, është e drejtë dhe çdo gjë që bie ndesh me të, është e padrejtë. Sigurisht, ky standard nuk është i lehtë për çdo njeri, sepse është e vështirë të përcaktosh se çfarë është saktësisht në përputhje me sheriatin dhe çfarë e kundërshton atë.

Ngurtësimi dhe gabimet e rënda të khauarixhëve³⁸

Kuptimi i khauarixhëve dhe gabimi i elitës

Kur humbet përqendrimi i duhur në adhurim dhe shpirtëroja e tij – që është përkushtimi, afërsia me Zotin dhe dorëzimi ndaj Tij, atëherë njeriu ekspozohet ndaj rreziqeve të shumta. Një prej këtyre rreziqeve është ngurtësimi (fanatizmi i verbër fetar).

Disa khauarixhë, për të cilët dëgjoni shumë këto ditë, ishin shumë të përkushtuar në adhurime, recitonin ajete nga Kur'ani

³⁸ "Hadithul Uilajeti", vëll. 4, f. 136-139.

dhe falnin namazet e tyre rregullisht. Kjo ndikonte edhe mbi disa nga shokët e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në betejën e Xhemelit, njëri nga shokët e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) pa një khauarixh, duke u falur natën në mënyrë të devotshme dhe duke recituar me një zë të bukur ajetin: “A është ai që falet gjatë natës...”³⁹ Ky shok u trondit dhe u kthye te Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) për të pyetur rreth tij. Pra, edhe të vetëdijshmit dhe të afërmit e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) binin ndonjëherë në gabime të tilla.

Besimi, vetëdija dhe shpata e Aliut

Nuk ishte e kotë, kur Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Mos i vrisni khauarixhët pas meje, sepse ai që kërkon të vërtetën, por gabon, nuk është si ai që kërkon të pavërtetën dhe e arrin atë”.

Situata kërkonte me të vërtetë shpatën e Aliut, vetëdijen e tij, besimin në vetvete dhe në rrugën që ndiqte, sepse edhe vetë elita përreth tij ndonjëherë lëkundej. Në një transmetim, thuhet se ai i tha njërit prej shokëve që e kishte parë atë njeri duke u falur: “Do të ta tregoj nesër”. Kur beteja u mbyll dhe nga khauarixhët kishin mbetur gjallë veçse dhjetë, ai eci mes të vrarëve për të nxjerrë mësim për shokët e tij. Kur arriti te një trup i shtrirë me fytyrë për tokë, tha:

³⁹ Sure “Ez Zumer, ajeti 9.

- Kthejeni! - Pastaj i tha shokut të tij- A e njeh këtë?
- Jo, o Prijës i besimtarëve.
- Ky është ai njeriu që po lexonte dje Kur'anin!

Çfarë lloj leximi i Kur'anit është ky? Çfarë adhurimi është ky? Është largim nga shpirti i vërtetë i adhurimit. Kush e kupton vërtet thelbin e adhurimit, të namazit dhe të Kur'anit, e kupton, gjithashtu, se po të ishin realisht thelbi i Islamit të mishëruara te Ali ibn ebu Talibi, atëherë ai do t'i largonte të gjitha dyshimet dhe do të bashkohej me të.

Por largimi nga feja dhe nga Kur'ani bën që njeriu të humbasë aftësinë për të kuptuar këtë realitet dhe si pasojë, ai ngre shpatën kundër vetë Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Pra, njëra anë e problemit është ngurtësimi, fanatizmi dhe gabimet e rënda, të cilat i kemi parë përgjatë sundimeve të Beni Umejes dhe Beni Abasit. Disa persona që ishin konsideruar si të devotshëm, të përkushtuar dhe të zellshëm në adhurim, madje emrat e tyre u përfshinë në listat e të drejtëve, bënë gabime aq të mëdha, sa që ngatërronin frontin e të vërtetës me frontin e së pavërtetës.

Kjo është një nga gabimet më të mëdha, sepse ka gabime që mund të falen dhe tejkalohen, por gabimi që nuk mund të kapërcehet, është pikërisht ky: ngatërrimi i të drejtës me të padrejtën dhe humbja e aftësisë për t'i dalluar ato.

Elita e Imam Aliut nuk gaboi kurrë

Madhështia e Amar ibn Jasirit dhe të ngjashmëve me të, nga elita e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), qëndronte në faktin se ata kurrë nuk u hutuan dhe nuk gabuan rrugën, në asnjë rrethanë. Këtë madhështi e kam vërejtur në shumë raste gjatë betejës së Sifinit. Sigurisht që kjo nuk kufizohet vetëm me Sifinin.

Kur besimtarët përballeshin me pasiguri dhe konfuzion, kishte njerëz me dritë të thellë të dijes dhe gjuhë të qartë e të fuqishme, të cilët i largonin dyshimet nga mendjet e njerëzve. Njëri prej tyre ishte Amar ibn Jasiri. Sa herë që njeriu shqyrton ngjarjet që përjetoi Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), përfshirë Sifinin, ndjen qartë ndikimin dhe rolin e këtij njeriu të madh, me vizion të kthjellët.

Beteja e Sifinit zgjati me muaj dhe ishte një betejë e çuditshme. Njerëzit përballë ushtrisë së Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) shiheshin duke falur namazin, adhuronin, recitonin Kur'anin – madje ngritën mus'hafet (Kur'anët) mbi majat e heshtave. Ky ishte një moment që kërkonte zemra të guximshme për të ngritur shpatën kundër tyre, pavarësisht pamjes së tyre fetare.

Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Sikur Imam Aliu të mos i kishte luftuar njerëzit e kibles (që luteshin drejt Mekës), detyrimi fetar ndaj tiranëve dhe mëkatarëve do të kishte mbetur përgjithmonë i paqartë*”. Ishte Ali ibn ebu Talibi ai që e hapi këtë rrugë dhe e sqaroi se çfarë duhej bërë.

Kur djemtë tanë ndërmerrnin sulme në disa llogore të frontit dhe kapnin robër nga armiku, gjenin në vendet e tyre tespihe dheu nga toka e Qerbelasë. Po, ata ishin të ngjashëm me ata që luftuan kundër Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ndërkohë që falnin namaz. Kjo bëri që disa të bien në fitne (konfuzion).

Në këto momente, Amar ibn Jasiri u vinte në ndihmë. Aty kërkohej ndërgjegjësim, zgjuarsi dhe një njeri si Amari.

Nëse një njeri nuk arrin ta kuptojë shpirtin e veprave dhe adhurimeve, që është drejtimi i zemrës nga Allahu dhe përkushtimi ndaj Tij, dhe nuk përpiket të afrohet tek Allahu në çdo vepër të tij, atëherë veprat e tij janë vetëm dije sipërfaqësore. Çdo besim apo vepër që mbetet në sipërfaqe, është gjithmonë e rrezikuar. Këtë e kemi parë vazhdimisht përgjatë historisë islame.

Arsyet e forcës në frontin e të pavërtetës

Kam përmendur më parë se disa prej fetarëve, të shenjtëve dhe asketëve merrnin pjesë në oborret e disa kalifëve tiranë e të shthurur, të cilët ishin zhytur në ligësi dhe mashtrime, dhe mbanin fytyra të shumta. Ata u jepnin këshilla dhe predikime këtyre kalifëve, të cilët ndonjëherë ndikonin prej tyre, ose nga hipokrizia dhe mashtrimi, ose sepse zemrat e tyre dridheshin, ose sepse ndodheshin nën ndikimin e alkoolit dhe ndjenjat i pushtonin përkohësisht, ose ndoshta qanin nga fjalët e dikujt. Por, nuk vononte shumë që këta njerëz, megjithëse ishin të njohur për

dijen dhe devotshmërinë e tyre, t'i bashkoheshin rrethit të afërt të kalifit.

Njeriu has gjëra të çuditshme në historinë islame. Një prej tyre është Amr ibn Ubejdi, i njohur për adhurimin dhe asketizmin e tij, për të cilin kalifi abasid kishte thënë: “Të gjithë ecin ngadalë, të gjithë ndjekin gjahun, përveç Amr ibn Ubejdit”, që do të thotë se ai ishte ndryshe nga të tjerët që pretendonin devotshmëri dhe përkushtim. Nëse e shikoni këtë burrë dhe Muhamed ibn Shihab Ez Zuhri dhe të ngjashmit me ta, do të vëreni se ata ishin nga ata që shkaktonin konfuzion kundër frontit të së vërtetës, duke mbështetur dhe duke forcuar frontin e të pavërtetës, ndërkohë që pretendonin se ishin me të drejtën, domethënë me familjen e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të mbi familjen e tij!), të vetmuar dhe të shtypur. Si rezultat i këtij injorimi, dora e armikut shtrihej përmes tyre.

Thelbi i adhurimit është shkatërrimi i idhullit të brendshëm

Shpirti i adhurimit është përkushtimi ndaj Allahut. Ne, o vëllezër dhe motra, duhet të përpiqemi ta ringjallim shpirtin e përkushtimit brenda vetes, që do të thotë t'i dorëzohemi Zotit të Lartësuar dhe të shkatërrojmë idhullin që fshihet brenda nesh.

Pakujdesia dhe ngatërresa shkatërrojnë veprat e mira⁴⁰

Sekreti në veprën e Imami Khomeinit

Sekreti që qëndron pas veprës së Imami Khomeinit (Zoti e lartësoftë fjalën dhe gradën e tij!), që fitoi zemrat dhe i preku ato, që e tronditi botën, është përkushtimi i tij i vazhdueshëm drejt përsosmërisë. Unë dhe të ngjashmit e mi, përballemi me vështirësi për ta kuptuar këtë dhe për të vepruar sipas tij. Ta thuash këtë me fjalë, është e lehtë për gjuhën, por zbatimi është i vështirë, shumë i vështirë. Ne nuk jemi në gjendje ta kuptojmë plotësisht këtë shprehje, por ai e jetoj atë.

Mos mendoni se Imami, që u largua për te Zoti i tij në vitin 1368 hixhri, është i njëjti me atë që hyri në Teheran në vitin 1357 hixhri. Jo! Ai kishte përparuar shumë përpara, kishte ecur shumë dhe ishte rritur shumë.

Është e vërtetë që ne nuk jemi në gjendje t'i kuptojmë shkallët e larta të njerëzve të tillë të mëdhenj, por njeriu që e shikon prej së poshtmi, e sheh kulmin ku ata fluturojnë. Dëshmoj për Zotin, se sa herë që e vizitoja Imamin, pas çdo Ramazani, e ndieja se ai kishte arritur në një nivel shumë më të lartë se më parë dhe ishte larguar edhe më shumë nga çështjet materiale. Ai përparonte dhe përsosej dita-ditës. I tillë është besimtari i vërtetë:

⁴⁰ "Hadithul Uilajeti", vëll. 6, f. 248-251.

“Ai që ka dy ditë të njëjta, është i mashtruar; e ai që dita e tij e nesërme është më e keqe se e sotmja, është i mallkuar”.⁴¹

Veprat e këqija shkatërrojnë besimin

Ka shumë prej atyre që luftuan me shpatë përpara të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por nuk arritën ta ruanin historinë e tyre. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë për shpatën e një njeriu që kishte luftuar përpara Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në një nga betejat: “Ai burrë që gjithmonë ka luftuar përpara të Dërguarit të Allahut, u vra...”, pra, e njëjta shpatë u ngrit më pas kundër Aliut, të birit të Ebu Talibit. Kjo do të thotë se edhe ata që kanë të kaluar kohë të lavdishme, mund ta humbasin atë.

Ne, gjithashtu, jemi të rrezikuar nga humbja e shpërblimeve. Mos mendoni se, nëse veprojmë një vepër të mirë, ajo do të mbetet gjithmonë në regjistrin tonë. Jo! Edhe një vepër e keqe mund ta zhdukë veprën e mirë, kur qëndrojmë përpara Allahut të Lartësuar. Madje, një veprim i keq mund të zhdukë edhe vetë bazën e besimit.

Allahu në Kur'an thotë për fundin e atyre që bënë keq: **“Dhe fundi i atyre që bënë të keqen, ishte se përgënjeshtuan argumentet e Allahut”.**⁴²

⁴¹ “Biharul Enuar”, vëll. 70, f. 173.

Ka nga këta edhe mes nesh. Unë njoh njerëz që kanë bërë vepra të mira, por për shkak të pakujdesisë, keqkuptimit, ambicies apo bindjes se e drejta u është mohuar, janë larguar. Kjo është një rrëshqitje, një çarje e vogël nga rruga e drejtë, por shumë e rrezikshme. Edhe pse e vogël në fillim, ajo hapet dhe bëhet më e madhe sa më shumë që njeriu ecën në atë drejtim.

Disa prej tyre përfunduan duke bërë veprime kundër Islamit dhe Revolucionit Islamik, ndonëse dikur ishin shërbyes të përkushtuar të Islamit dhe revolucionit.

Kush e ka fajin?

Disa mendojnë se revolucioni është ai që duhet fajësuar, pse nuk arriti t'i ruajë këta njerëz. Jo! Çështja nuk është kështu. **“Mos më fajësoni mua, por fajësoni veten tuaj!”**⁴³ Nuk ka asnjë të drejtë krenarie për atë që e pranon Islamin, ashtu siç nuk ka të drejtë krenarie për revolucionarin që i bashkohet revolucionit. Allahu i Madhëruar i thotë të Dërguarit të Tij: **“Ata ta përmendin si nder që kanë pranuar Islamin. Thuaj: ‘Mos ma përmendni mua si nder Islamin tuaj. Është Allahu që ju ka bërë nder duke ju udhëzuar drejt besimit’”**.⁴⁴ Pra, është Allahu që na ka bërë të gjithëve nder, duke na udhëzuar.

⁴² Sure “Er Rrum”, ajeti 10.

⁴³ Sure “Ibrahim”, ajeti 22.

⁴⁴ Sure “El Huxhurat”, ajeti 17.

Sa të shumtë janë të humburit dhe robërit e egos në botën tonë sot! Sa të rinj, në këtë botë të ashtuquajtur të civilizuar, u ngjajnë kafshëve, duke mos ditur asgjë përveç nevojave të tyre materiale dhe të ulëta! Kafsha nuk e kalon dot këtë kufi, por njeriu është ai që e kupton qëllimin e ekzistencës së tij përmes logjikës, mendjes dhe ndjenjave të pastra, dhe më pas lëviz, me gjithë qenien e tij, drejt atij qëllimi, duke kapërcyer pengesat që i dalin përpara. Amerika, Evropa dhe vendet nën shtypje janë plot me të rinj të tillë.

Duhet ta ruajmë Islamin

Duhet ta falënderoni Allahun, që ju udhëzoi drejt besimit të pastër dhe te monoteizmi i vërtetë. Ai na dha personalitet dhe pavarësi. Forcat që sot udhëheqin botën, nuk i binden Allahut. Ato e shohin njeriun si skllav të vetin dhe njerëzit, fatkeqësisht, e kanë pranuar këtë gjendje. Ato nuk i frikësohen askujt përveç atij që nuk u nënshtrohet atyre, pa marrë parasysh koston. Por ju nuk ishit të tillë. Është Islami që ju bëri të tillë dhe për këtë duhet t'ia njihni vlerën e Islamit. Prandaj, mos mendoni se ajo që kemi arritur, do të qëndrojë vetvetiu. Jo! Duhet ta ruajmë me përkushtim.

Sot do të dëshiroja t'ju lexoj disa pjesë nga libri *"El Luhuf"* i Ibn Tavusit. Ky është një libër shumë i vlerësuar, autori i tij është një dijetar, jurist dhe njohës i besueshëm, Ali ibn Tavusi, i cili ka qenë një figurë me ndikim të madh, poet dhe njeri me personalitet

të theksuar. Libri i tij është i pari libër për martirizimin e Imam Hysenit (mektel). Edhe pse para tij janë shkruar libra të shumtë mbi martirizimin e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), madje edhe mësuesi i tij, Ibn Nema, ka pasur një të tillë, po ashtu edhe Shejkh Tusi, por “El-Luhuf”, për shkak të vlerës dhe saktësisë së shprehjeve, i ka tejkaluar të gjitha.

Dalja në fushëbetejë e Kasemit, i biri i Hasanit

Një prej skenave që ai përshkruan, është dalja e Kasemit, i biri i Hasanit, në fushën e betejës, një skenë tejet prekëse dhe e jashtëzakonshme. Kasemi ishte një djalosh që ende nuk kishte arritur moshën e pjekurisë. Natën e dhjetë Muharrem, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) i njoftoi shokët e tij se beteja ishte e pashmangshme dhe të gjithë do të martirizoheshin. Ai u dha leje të largoheshin, por ata e refuzuan këtë. Ky djalosh, që ishte rreth 13 ose 14 vjeç, e pyeti xhaxhain e tij, Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*): “A do të martirizohem edhe unë në fushë?” Hyseni deshi ta sprovtojë, sipas shprehjes sonë dhe i tha: “Si e sheh vdekjen?” Ai u përgjigj: “Më të ëmbël se mjalti”.

Shikoni çfarë vlere kishin njerëzit e Ehli Bejtit dhe ata që ishin rritur nën kujdesin e tyre! Ky djalosh ishte rritur që në vogëli nga Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), pasi babai i tij ishte martirizuar, kur ai ishte vetëm 3-4 vjeç. Ditën e dhjetë Muharrem, ai qëndroi pranë xhaxhait të tij. Autori i librit “El Mektel” shkruan: “Doli një djalosh, fytyra e të cilit shkëlqente si hënë. Nisi të luftonte”.

Historianët kanë regjistruar ngjarjet e asaj dite me hollësi: kush goditi, kush u godit, kush e bëri goditjen e parë, kush grabiti e kush vodhi. Madje, e kanë përmendur edhe emrin e atij që vodhi jorganin e Ebu Abdullahut dhe ai përjetësisht u quajt “vjedhësi i jorganit”. Kjo tregon se Ehli Bejti dhe dashamirët e tyre nuk e lanë këtë ngjarje të humbiste në errësirën e historisë.

Tregohet se Ibn Fudajl El Ezdi e goditi Kasemin në kokë dhe ia çau atë. Djaloshi u rrëzua përmbys dhe bërtiti: “O xhaxha!” Imam Hyseni u turr drejt tij si një shqiponjë dhe e goditi vrasësin e tij me shpatë, duke e vrrarë. Kur kufovarët e Kufës tentuan të ndërhynin, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) luftoi kundër tyre.

Një betejë e ashpër shpërtheu rreth trupit të Kasemit. Ajo pamje e tronditi thellësisht Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*).

Tregohet: “Kur u shpërnda pluhuri, e panë Hysenin duke qëndruar pranë kokës së djaloshit, i cili rrihte këmbët e tij në agoni. Hyseni tha: “*Qoftë larg mëshira nga ai popull që të vrau!*”

Është një skenë që copëton zemrën e çdo njeriu, një pamje që tregon butësinë e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe dashurinë e tij për këtë djalosh, nga njëra anë dhe sakrificën e atij djaloshi nga ana tjetër, si dhe ashpërsinë e armiqve që vepruan me aq egërsi ndaj tij.

Dalja e Ali el Ekberit në fushën e betejës

Një tjetër skenë tronditëse është dalja e Aliut të madh në luftë. Një moment vërtet prekës në çdo aspekt. Është prekës për

Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), për vetë këtë djalosh, gjithashtu, për gratë, veçanërisht për hallën e tij, Zejneben. Thuhet se Ali ek Ekber ishte diku mes tetëmbëdhjetë dhe njëzet e pesë vjeç.

Tregohet: “Doli Ali ibn Hyseni, që ishte njeriu më i bukur në pamje dhe në krijim. Ai kërkoi leje nga babai për të luftuar. Hyseni ia dha menjëherë”. Tregimet thonë se, kur Kasemi, i biri i Hasanit, kërkoi leje për të hyrë në betejë, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ia dha menjëherë, vetëm pas këmbënguljes së tij. Por meqë Ali el Ekber ishte djali i tij, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) i dha leje menjëherë. “Pastaj e shikoi me një vështrim të dhimbshëm, uli sytë dhe qau”.

Është një nga ato momente emocionale që e përshkojnë thellë ndjenjën islame, ku lotët nuk janë shenjë dobësie, por shprehje e thellësisë shpirtërore dhe ndjeshmërisë njerëzore. Islami e zhvillon dhe e forcon këtë ndjeshmëri tek njeriu.

Pastaj Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “O Zot, dëshmo! Doli përballë tyre një djalosh që i ngjante më shumë se kushdo tjetër të Dërguarit tënd në pamje, sjellje, në mënyrën e të folurit”.

Këtu dua të ndalem për të sqaruar diçka: Hyseni, kur ishte fëmijë, ishte i dashur për të Dërguarin e Allahut dhe ai vetë e donte shumë Profetin. Kur Profeti ndërroi jetë, Hyseni ishte vetëm 6 ose 7 vjeç, por figura e tij mbeti e gjallë në zemrën e tij dhe dashuria për të ishte e ngulitur thellë. Më vonë, Allahu e bekoi me një djalë, Ali el Ekber. Kur ai u rrit, u bë shumë i ngjante shumë

Profetit Muhamed: në pamje, në sjellje, në zë, në të folur dhe në moral. Ai kishte të njëjtin bujari dhe fisnikëri gjaku.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) thoshte: *“Kur na merrte malli për të Dërguarin tënd, shikonim këtë djalosh”. Pastaj bërtiti drejt Ibn Sadit: “O biri i Sadi, Allahu e preftë mëshirën prej familjes sate, ashtu siç ti e preve nga unë!”*

Ali el Ekberi përparoi drejt ushtrisë armike dhe luftoi me guxim të madh, duke vrrarë shumë prej tyre. Pastaj u kthye te babai i tij dhe tha:

- *O babai im, etja po më vret dhe pesha e armaturës po më lodh, a ka ndonjë mundësi për një pikë ujë?*
- *O bir, lufto pak më shumë, se shpejt do të takosh gjyshin tënd, Muhamedin, i cili do të të japë të pish nga kupa e tij e përjetshme. Vetëm një gllënjë do të pish dhe nuk do të ndjesh më kurrë etje.*

Ali el Ekberi u kthye sërish në fushën e betejës, luftoi me heroizëm të pashoq, derisa u godit. Në çastet e fundit, ai thirri: *“O babai im, paqja qoftë mbi ty! Ja, gjyshi im po të përshëndet dhe po të thotë: ‘Nxito drejt nesh!’”*

Lëvizja e Hysenit, shpëtim për historinë

Këto pamje janë tronditëse dhe ndodhën në një ditë nga ajo ngjarje e pavdekshme. Dita e njëmbëdhjetë Muharrem, e cila është si dita e Zejnebes së Madhe (*Paqja qoftë mbi të!*), është një ditë me tragjedi rrëqethëse. Që nga çasti kur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u martirizua, ajo mori mbi vete barrën e amanetit dhe e përmbushi me guxim dhe vendosmëri të plotë, ashtu siç i takon bijës së Imamit Aliut (*Paqja qoftë mbi të*). Të gjithë ndoqën këtë rrugë dhe arritën të përjetësojnë Islamin dhe t'i ruajnë shtyllat e fesë.

Ngjarja e Qerbelasë nuk ishte vetëm një përpjekje për të shpëtuar jetën e një populli apo një kombi, por ishte shpëtim për të gjithë historinë. Imam Hyseni, motra e tij Zejneb, familja dhe shokët e tij shpëtuan historinë me qëndrimin e tyre heroik.

Paqja mbi ty, o Ebu Abdullah dhe mbi shpirtrat që u ndalën në oborrin tënd!
Prej meje qofsh përherë i përshëndetur me paqen e Allahut, për sa kohë që të ekzistoj dhe sa të ekzistojë nata dhe dita! Mos e bëftë Allahu, që kjo të jetë përshëndetja e fundit prej meje për ty! Paqja qoftë mbi Hysenin, mbi Aliun, birin e Hysenit, mbi fëmijët e Hysenit dhe mbi shokët e Hysenit!

O Allah, të betohemi për hir të Muhamedit dhe familjes së Muhamedit, që të na forcosh në fenë Tënde dhe në atë që ka sjellë Libri Yt!

O Allah, bëje shoqërinë tonë një shoqëri islame!

O Allah, mos na ndaj nga Islami!

O Allah, ndihmoje Islamin dhe myslimanët në çdo cep të botës dhe poshtëroji armiqtë e Islamit!

O Allah, përhap mes nesh vlerat islame, lidhjet e vëllazërisë, të dashurisë, të përkushtimit ndaj Teje dhe drejtësisë së gjithanshme!

O Allah, përjashto nga mëshira Jote çdo armik që përpiket ta shkëpusë shoqërinë tonë nga Islami!

O Allah, bëje të kënaqur zemrën e Imamit të Kohës (Imam Mehdiu), shpirtrat tanë u flijofshin për të, me kënaqësi ndaj nesh dhe bëna prej ndihmuesve dhe mbështetësve të tij! Pranoje lutjen e tij për popullin tonë!

O Allah, bëhu i mëshirshëm me dëshmorët tanë të dashur, me imamin e dëshmorëve dhe me të gjithë ata që sakrifikuan për Ty!

PËRMBAJTJA

DY FJALË	5
Parathënie.....	9
Çdo ditë është Ashure dhe çdo tokë është Qerbala	9
KAPITULLI I PARË	22
PERSONALITETI I IMAM HYSENIT DHE NGJARJA E ASHURES.....	22
Imam Hyseni, magnet i zemrave.....	23
Imam Hyseni, emri dhe ndikimi.....	23
Imam Hyseni, shembull për të gjithë njerëzit	25
Përballja me shtrebbërimin	28
Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja	29
Sulmi ndaj armikut është ndër veprat më të mëdha	30
Duhet të përballemi me armikun.....	32
Hyseni përballat me të gjithë botën.....	33

KAPITULLI I DYTË	37
MËSIME NGA NGJARJET E ASHURES	37
Qëllimi i Hysenit: Ringjallja e sistemit dhe e shoqërisë islame .	38
Më shumë se njëqind mësimë nga një lëvizje që zgjati vetëm disa muaj	38
Mësimi kryesor... Pse u ngrit Hyseni?	39
A u ngrit Hyseni për të themeluar një qeveri?	40
A u ngrit Hyseni për të rënë dëshmor?	41
Qeveria dhe martirizimi janë dy rezultate dhe jo dy qëllime	41
Qëllimi i përmbushjes së detyrës së paplotësuar	42
Në kohën e Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të!) u krijua terreni për përmbushjen e kësaj detyre.....	43
Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) erdhi me mësimë islame	44
Cila është detyra, nëse shoqëria islame largohet nga rruga e duhur?.....	46
Detyra është e qartë, por kushtet për zbatimin nuk ishin të përgatitura.....	46
Domosdoshmëria e rikthimit në rrugën e drejtë e shoqërisë së larguar.....	48
Shmangia ndodhi në kohën e Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të!) dhe u krijua terreni i përshtatshëm për revolucion.....	49
Pozita e imamëve është e njëjtë	50

Përmbushja e këtij detyrimi është e rrezikshme.....	51
Qëllimi ishte, rikthimi i shoqërisë islame në rrugën e drejtë.....	52
Imam Hyseni (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) ishte i pari që përmbushi këtë detyrë	54
Rreziku që i kanosej Islamit në kohën e Jezidit	55
Pse duhet të ringjallet përkujtimi i Imam Hysenit (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) dhe i Qerbelasë?	61
Imami Hyseni (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) e sqaroi detyrën	62
Dallimi i detyrës kryesore nga detyrat dytësore	63
Të qenit përpara dhe përcaktimi i detyrës kryesore	63
Të prapambeturit nga detyra e vërtetë	64
Njohja e detyrës themelore në jetën e shoqërisë.....	65
Detyra më e rëndësishme: Përballja me tiranët	66
Imam Hyseni (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) e përcakttoi me qartësi detyrën e tij.....	66
Detyra është ndërrimi i sundimit të padrejtësisë dhe tiranisë	67
Nuk lejohet të gabojmë në identifikimin e armikut dhe drejtimit të duhur	67
Imperializmi botëror, rreziku më i madh për Islamin.....	68
Zgjimi islam dhe burimi i armiqësisë amerikane	69
Mësimi i Arbaenit.....	71

Gjallërimi i kujtimit dhe realitetit të dëshmisë	71
Përjetësimi i ngjarjes së Ashures	71
Mësimi i Erbainit	73
Filozofia e lëvizjes së Ashures	75
Kush është ai që mund të shpëtojë njerëzimin?	75
Kush është i aftë ta ndihmojë njerëzimin?	76
Dielli i përjetshëm i Ashures	77
Imami frymëzohet nga Ashurja	79
Ne jemi ruajtësit e amanetit të Ashures	80
Problemet e qytetërimit perëndimor bashkëkohor	81
Njohja e Ashures, maja e njohurive islame	83
Përballja me shtrembërimet e Ashures	83
A e patë se çfarë bëri një njeri i brumosur me idetë e Hysenit dhe të Qerbelasë?	85
Shpalosja e të vërtetave të Islamit gjatë muajit Muharrem	87
Flijimi për ruajtjen e fesë	88
Drita e ndërgegjësimit është thelbësore në mbrojtjen e fesë ..	88
Qëndrueshmëria e Hysenit dhe qëndrueshmëria e Khomeinit	89
Ngjashmëritë midis lëvizjes së Imam Khomeinit dhe lëvizjes së Imam Hysenit	89
Qëndrueshmëria përballë vështirësive	90

Justifikimet e ligjshme e pengojnë njeriun	91
Qëndrueshmëria përballë justifikimeve të ligjshme	93
Imam Khomeini e vazhdoi rrugën e Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të!)	94
Qëndrueshmëria e Imam Khomeinit përballë sulmeve të armiqve.....	96
Armiku ushtronte presion për të lëkundur Imam Khomeinin	98
KAPITULLI I TRETË	100
MËSIMET E ASHURES.....	100
Umeti i Profetit Muhamed (a.s) vret djalin e Profetit të tij.....	101
Mësimet vlejné për epokën e sundimit islam	101
Madhështia e ngjarjes së Qerbelasë.....	104
Imami Hyseni (Paqja qoftë mbi të!) në fëmijërinë e tij.....	105
Imami Hyseni (Paqja qoftë mbi të!) në ditët e rinisë së tij....	107
Izolimi i Ehli Bejtit.....	108
Bota islame dhe dashuria për Ehli Bejtin (<i>Paqja qoftë mbi ta!</i>) ..	110
Shtyllat themelore të strukturës së sistemit profetik	111
1- Njohuria e saktë dhe e qartë.....	111
2- Drejtësia absolute dhe e paanshme	112
3- Adhurimi i pastër vetëm për Allahun	112

4. Dashuria e thellë dhe ndjenja e fortë emocionale.....	113
Ndryshimi i shoqërisë paraislame (xhahilite).....	114
Uilajeti, vazhdimi i rrugës edukative që nisi Profeti Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!</i>).....	115
Rruga e atyre që Ti i ke mirësuar.....	117
Gjendja e elitës pas largimit nga jeta e Profetit Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!</i>).....	119
Talha ibn Abdullahu.....	121
Ebu Musa el Esh'ari	122
Sad ibn ebu Vekasi.....	123
Mervan ibn Hakemi.....	124
El Uelid ibn Ukbetu	125
Udhëheqja (el uilajetu) është një qeverisje e mbushur me dashuri për njerëzit dhe lidhje me ta.....	126
Një hebre që flet në emër të Islamit.....	128
Tregime për njerëzit e thjeshtë	129
Amar ibn Jasiri, njeriu i vlerave	129
Devotshmëri do të thotë vetëvëzhgim dhe përgjegjësi ndaj të tjerëve.....	130
Reji, çmimi për vrasjen e të dashurit të Zehrasë.....	132
Analizë e ngjarjes së Ashures	133
Ashurja, fushë mësimi dhe reflektimi.....	134

Mësimi i parë	135
Sëmundja e shoqërisë islame	136
Shkaqet kryesore të humbjes	137
Epidemia e rrezikshme është humbja e parimeve	139
Kur përmbysen vlerat.....	140
Për të kujdesshmit, nuk lejohet përmbysja e vlerave.....	141
Bota e sotme dhe mbizotërimi i materializmit.....	142
Revolucioni islam dhe frymëzimi nga Ashurja	142
Kujdes nga dobësimi i shpirtit të revolucionit dhe nga izolimi i bijve të tij	143
Çfarë ndodhi, që shkoi situata deri te ngjarja e Qerbelasë?	144
Mikrobi që e ndoti trupin e shoqërisë	144
Çfarë ndodhi në të vërtetë, është një mësim!	146
Faktori kryesor: Përhapja e dashurisë për dynjanë, korrupsioni dhe imoraliteti	147
Kujdes nga stuhitë e korrupsionit	148
Faktori tjetër: Indiferentizmi i ndjekjes së të vërtetës dhe fatit të Islamit	149
Sekreti i vërtetë i vazhdimësisë së dijeve të profetëve	150
Frymëzimi i Imamit Khomeinit nga përvoja e Qerbelasë	151
Pozicioni ynë në këtë ngjarje	153

Përmes Ashures.....	153
Pse u godit umeti islam me harresë dhe dobësi?	155
Të veçantët (el khauas) dhe të zakonshmit (el auam) në shoqëri	157
Cilët janë të veçantët (el khauas)? A janë një klasë e caktuar shoqërore?	157
Tiparet e të veçantëve (el khauas).....	159
Varësia e të zakonshmëve nga rrethanat	159
Të veçantët (el khauas) në frontin e të drejtës dhe të së kotës	160
Të veçantët nga mbështetësit e të drejtës.....	161
Kujdes, mos u bëni nga masa e zakonshme!.....	163
Të veçantët (elita) që mbështesin të vërtetën dhe lidhja e tyre me dynjanë	164
Shndërrimi i shoqërisë islame në një shoqëri monarkike	165
Mallkimi i atij që mbolli farën e parë	166
Përfitimet materiale – pika e nisjes së rrëshqitjes së elitës që mbështet të drejtën.....	168
Shkaqet e problemeve në kohën e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>)	169
Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu dhe Imami Hyseni (<i>Paqja qoftë mbi ta!</i>) nuk i përtypin hidhërimet që vijnë nga të veçantët (el khauasu)	170

Imami Hasani (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) dhe zgjedhja më e vështirë	172
Roli vendimtar i të veçantëve (<i>elita</i>)	173
Madhështia e Imam Hysenit (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>)	174
Lëvizja e masave ndjek lëvizjen e elitës	175
Të vetëdijshmit dhe madhështia e kësaj lëvizjeje	176
Masat lëvizin pa analizë	177
Përtesa e elitës që përkrahte të vërtetën	179
Ndikimi i “të penduarve” në histori	182
Përtesa e elitës për të mbështetur Muslim ibn Akilin	183
Imami dhe vendimi i tij vendimtar	184
Ku jeni ju? A jeni nga elita apo nga masa?	185
Elita, elita, shtresa e veçantë	186
Ngjarjet historike janë të përsëritshme në çdo kohë	187
Dallimi midis të drejtës dhe të padrejtës – një detyrë e vështirë në jetën e njerëzimit	189
Standardi për të njohur të drejtën dhe të padrejtën	190
Ngurtësimi dhe gabimet e rënda të khauarixhëve	191
Kuptimi i khauarixhëve dhe gabimi i elitës	191
Besimi, vetëdija dhe shpata e Aliut	192
Elita e Imam Aliut nuk gaboji kurrë	194
Arsyet e forcës në frontin e të pavërtetës	195

Thelbi i adhurimit është shkatërrimi i idhullit të brendshëm .	196
Pakujdesia dhe ngatërresa shkatërrojnë veprat e mira	197
Sekreti në veprën e Imami Khomeinit	197
Veprat e këqija shkatërrojnë besimin	198
Kush e ka fajin?.....	199
Duhet ta ruajmë Islamin.....	200
Dalja në fushëbetejë e Kasemit, i biri i Hasanit.....	201
Dalja e Ali el Ekberit në fushën e betejës	202
Lëvizja e Hysenit, shpëtim për historinë	205
PËRMBAJTJA	207

اسم الكتاب: عاشوراء في فكر الإمام الخامني

مترجم: الشيخ ولنت (عباس) مريا

التصحيح الادبي: بيردا كولا

التصحيح اللغوي: اسراء مريا

الإخراج النهائي: صبريه فزا

الغلاف: صبريه فزا

الناشر: جمعية نسيم

تيرانا: 2025